



Funded by
the European Union



KosEd

"Përkrahje për arsimin fillor dhe të mesëm të lartë"
"Support to basic and upper secondary education"

Përmirësimi i arsimit:

Raport mbi rishikimin e teksteve shkollore për arsimin e obligueshëm (Faza 1)

Prishtina, 2024

Përmirësimi i arsimit:

Raport mbi rishikimin e teksteve shkollore për arsimin e obligueshëm (Faza 1)



Autorët

Florence Mihaela Singer, Ph.D

Fadil Latifi, Ph.D

Armend Shabani, Ph.D.

Osman Buleskhaj, Ph.D

Andi Smart

FALËNDERIMET

Ne do të donim ta shprehim mirënjohjen dhe falënderimin tonë ndaj individëve dhe organizatave që e mundësuan realizimin e këtij raporti dhe të tërë procesit të rishikimit të teksteve shkollore profesionale.

Falënderim të veçantë shprehim ndaj Arbërie Nagavcit, Ministre e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), për iniciativën e saj që ta lansojë këtë projekt si pikënisje për përmirësimin e mësim-nxënies së nxënësve në Kosovë. Po ashtu, e falënderojmë Bora Shpuzën, shefe e kabinetit të MASHTI-t, për përkushtimin e saj në zgjidhjen e çështjeve të vështira dhe për ndihmën e saj kompetente gjatë finalizimit të procesit të rishikimit.

E falënderojmë Anne-Sophie Houee, Lucia Parducci dhe Stergios Tragoudas nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë (ZBEK) për mbështetjen e tyre dhe inkurajimin. Po ashtu, e falënderojmë Isabel Naylor dhe Isaline Ameryckx nga DAI, për udhëzimet e tyre të vazhdueshme, përkushtim e tyre ndaj arsimit me fokus në cilësi. Pa këtë mbështetje të vazhdueshme nuk do të mund të realizohej kjo punë.

Falënderimi ynë i dedikohet ekipit të përhershëm të projektit KosEd, duke përfshirë Alexis De Roquefeuil, Robert Blease, Yllka Mehulli dhe Liridon Zeka, për bashkëpunimin e tyre dhe shkëmbimin miqësor të ideve gjatë këtij rrugëtimi kompleks të formësimit të procesit të rishikimit të teksteve shkollore dhe produkteve, si dhe Rinor Qehaja, udhëheqës i Institutit EdGuard, për kontributin dhe udhëzimet e çmuara për aspekte të ndryshme të sistemit arsimor në Kosovë.

Falënderim të veçantë shprehim ndaj Dije Shatri, e cila ka kontribuar shumë në programin e trajnimit duke sjellë entuziazmin dhe profesionalizmin e saj në tërë këtë proces.

Vlerësimi dhe falënderimet tona shkojnë edhe për ekipin e mrekullueshëm të recensentëve: Bjeshkë Alia, Mevlude Aliu-Gashi, Shpetim Azemi, Luljeta Bajrami-Shala, Besa Beqiri-Zejnullahu, Florentina Dedushaj, Salihe Gajtani-Osmankaq, Servete Gashi, Edita Haxhijaha, Hazbije Haxhiu, Shemsi Haziri, Gentiana Imeraj, Vullnet Kabashi, Fjolla Kaçamaku, Selim Mehmeti, Arbneshë Mexhuani, Qendresa Morina, Bekim Morina, Valbone Nika, Senad Orhani, Murteza Osdautaj, Besmir Ponik, Ismet Potera, Murtez Shala, Lindita Tahiri, and Vjollca Zejnullahu-Gashi.

Angazhimi dhe përkushtimi i tyre në zhvillimin e raporteve konsistente të rishikimit të teksteve shkollore kanë luajtur një rol kyç në përmbylljen me sukses të këtij raporti

hulumtues, si dhe të fazës së parë të procesit të rishikimit të teksteve shkollore në Kosovë.

Ne e shprehim mirënjohjen tonë të sinqertë ndaj të gjithë individëve dhe organizatave të cekura më lart për mbështetjen, udhëzimet dhe kontributin e tyre të palëkundur gjatë tërë këtij procesi.

Përveç kësaj, ne do të donim ta shprehim falënderimin tonë ndaj të gjithë individëve që kanë ofruar ndihmën, udhëzimet dhe kontributin e tyre, të cilët nuk po i përmendim në mënyrë eksplicite.

Kontributi i tyre ka qenë i vlefshëm, dhe ne e vlerësojmë lartë.

Për fund, do të donim ta shprehim mirënjohjen tonë kolektive ndaj individëve të panumërt të cilët kanë qenë të përfshirë në hulumtim dhe zhvillim të materialeve dhe resurseve mësimore në Kosovë gjatë vitit të kaluar.

Shpresojmë që të gjitha këto mund të krijojnë parakushte të mira për përmirësimin e cilësisë së arsimit në vend në të ardhmen.

Përmbajtja

1. Hyrje: tekstet shkollore dhe cilësia e të nxënit

- 1.1. Cilësia e të nxënit dhe raporti i tij me tekstet shkollore
- 1.2. Arsyeshmëria për rishikimin e teksteve shkollore
- 1.3. Metodatat dhe Strategjia e zbatimit të procesit të rishikimit të teksteve shkollore

2. Prezantim i shkurtër i rezultateve kryesore të procesit të rishikimit të teksteve shkollore

2.1. Përparësitë dhe mangësitë në tekstet shkollore të gjuhës shqipe në arsimin e obligueshëm

2.1.1 Përparësitë në tekstet e gjuhës shqipe

2.1.1.1. Bashkërendimi i kurrikulës

2.1.1.2. Saktësia e përmbajtjes

2.1.1.3. Efektiviteti i strategjive të të nxënit

2.1.1.4. Saktësia dhe qasja e gjuhës

2.1.1.5. Cilësia e paraqitjes dhe dizajnit

2.1.2 Mangësitë në tekstet shkollore të gjuhës shqipe

2.1.2.1. Bashkërendimi i kurrikulës

2.1.2.2. Saktësia e përmbajtjes

2.1.2.4. Saktësia dhe qasja e gjuhës

2.1.1.5. Cilësia e paraqitjes dhe dizajnit

2.1.2 Mangësitë në tekstet shkollore të gjuhës shqipe

2.1.2.1. Bashkërendimi i kurrikulës

2.1.2.2. Saktësia e përmbajtjes

2.1.2.3. Efektiviteti i strategjive të të nxënit

2.1.2.4. Saktësia dhe qasja e gjuhës

2.1.1.5. Cilësia e paraqitjes dhe dizajnit

2.2. Përparësitë dhe mangësitë në tekstet shkollore të matematikës në arsimin e obligueshëm

2.2.1 Përparësitë në tekstet shkollore të matematikës

2.2.1.1. Bashkërendimi i kurrikulës

2.2.1.2. Saktësia e përmbajtjes

2.2.1.3. Efektiviteti i strategjive të të nxënit

2.2.1.4. Saktësia dhe qasja e gjuhës

2.2.1.5. Cilësia e paraqitjes dhe dizajnit

2.2.2 Mangësitë në tekstet shkollore të matematikës

2.2.2.1. Bashkërendimi i kurrikulës

2.2.2.2. Saktësia e përmbajtjes

2.2.2.3. Efektiviteti i strategjive të të nxënit

2.2.2.4. Saktësia dhe qasja e gjuhës

2.2.2.5. Cilësia e paraqitjes dhe dizajnit

3. Rekomandimet e politikave

3.1. Fushat për përmirësim në përmbajtjen e teksteve shkollore

3.2. Rekomandime për rishikim dhe recensim të teksteve shkollore në të ardhmen

3.3. Implikimet për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës

3.3.1 Njohuritë e pasqyruara në tekstet shkollore

3.3.2. Nga dokumentet e kurrikulës tek zbatimi i kurrikulës

3.4. Implikimet për trajnimin e mësimeve

3.5. Implikimet për zbatimin e kurrikulës dhe vlerësimin

1. Hyrje: tekstet shkollore dhe cilësia e të nxënit

Në botën e sotme që po evoluon në mënyrë të shpejtë, cilësia e arsimit luan një rol vendimtar në pajisjen e nxënësve me njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e nevojshme për një karrierë të suksesshme. Në këtë rrugëtim shkollimi janë të rëndësishme tekstet shkollore që shërbejnë si burime kryesore të nxënies për nxënësit në të gjitha lëndët shkollore dhe nivelet e klasave.

Ky raport synon ta adresoj një pyetje thelbësore lidhur me këtë fakt: Si mund të përmirësohen tekstet shkollore për t'i përbushur më mirë nevojat arsimore të nxënësve në arsimin e obligueshëm? Duke i analizuar sfidat dhe mundësitë aktuale në përmbajtjet dhe hartimin e teksteve shkollore, ky raport synon të ofrojë rekomandime të bazuara në dëshmi për politikë-bërësit, edukatorët dhe botuesit e teksteve shkollore.

Raporti është i ndarë në tri pjesë, të cilat përfshijnë një prezantim të shkurtër të procesit të rishikimit të teksteve të gjuhës shqipe dhe matematikës në arsimin e obligueshëm nga ekipet e ekspertëve, një analizë të gjendjes aktuale të këtyre teksteve shkollore, dhe një varg rekomandimesh që kanë dalë nga tërë ky proces.

Shpresojmë që politikë-bërësit, edukatorët dhe palët e interesit të angazhohen në mënyrë aktive për sa i përket të gjeturave të këtij raporti dhe t'i përdorin ato si një katalizator për ndryshime pozitive. Nëpërmjet përpjekjeve të përbashkëta, ne mund ta shtrojmë rrugën për një të ardhme më të ndritshme, ku tekstet shkollore nuk janë thjesht mjete mësimore, por burime të çmueshme që frymëzojnë, sfidojnë dhe ushqejnë mendjet e gjeneratës së ardhshme.

1.1. Cilësia e të nxënit dhe raporti i tij me tekstet shkollore

Edhe pse nuk ka ndonjë përkufizim të pranuar botërisht lidhur me cilësinë e arsimit, shpesh ekzistojnë disa emërues të përbashkët. Sipas 2005 EFA Global Monitoring Report t, emëruesi i parë i referohet zhvillimit të aftësive kognitive të nxënësve si objektivi kryesor dhe i qartë i të gjitha sistemeve arsimore. Prandaj, suksesi me të cilin sistemet arsimore e arrijnë këtë është tregues i cilësisë së tyre. Emëruesi i dytë e thekson rolin e arsimit në promovimin e vlerave dhe qëndrimeve të qytetarisë së përgjegjshme dhe në kultivimin e zhvillimit krijues dhe emocional.

Çështja e të nxënit cilësor vlen për të gjitha aspektet dhe dimensionet e arsimit, përkatësisht:

► Cilësia e inputeve (siç janë mësimdhënësit, kurrikulat, tekstet shkollore, mjedisi shkollor dhe sistemet e vlerësimit)

► Cilësia e proceseve (siç janë proceset e mësimdhënies dhe të të nxënit, dhe proceset e zhvillimit të kurrikulave dhe teksteve shkollore)

► Cilësia e rezultateve (p.sh. rezultatet e të nxënit/kompetencat e nxënësve, ndikimi më i gjerë i arsimit në zhvillimin individual dhe social).

Siç mund ta shohim, tekstet shkollore janë të përfshira, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në të gjitha këto dimensione. Tekstet shkollore vazhdojnë të kenë një rol të rëndësishëm në mësimdhënie dhe mësim-nxënie në të gjithë botën, duke u ofruar mësimdhënësve dhe nxënësve njohuritë zyrtare të lëndëve shkollore, si dhe vlerat, qëndrimet, shkathtësitë dhe sjelljet e preferuara të ekspertëve/autorëve në ato fusha.

Siç thekson Shannon (2010), tekstet shkollore janë mallra, objekte politike dhe përfaqësime kulturore dhe, për rrjedhojë, janë vendi dhe rezultat i përpjekjeve dhe kompromisit për të përcaktuar se si dhe nga kush do të prodhohen, si dhe nga kush do të përzgjidhen përmbajtjet e tyre, si dhe kujt do t'i shpërndahen dhe si do t'i shfrytëzojnë ato mësimdhënësit dhe nxënësit.

Siç mund ta shohim, tekstet shkollore janë të përfshira, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në të gjitha këto dimensione. Tekstet shkollore vazhdojnë të kenë një rol të rëndësishëm në mësimdhënie dhe mësim-nxënie në të gjithë botën, duke u ofruar mësimdhënësve dhe nxënësve njohuritë zyrtare të lëndëve shkollore, si dhe vlerat, qëndrimet, shkathtësitë dhe sjelljet e preferuara të ekspertëve/autorëve në ato fusha. Siç thekson Shannon (2010), tekstet shkollore janë mallra, objekte politike dhe përfaqësime kulturore dhe, për rrjedhojë, janë vendi dhe rezultat i përpjekjeve dhe kompromisit për të përcaktuar se si dhe nga kush do të prodhohen, si dhe nga kush do të përzgjidhen përmbajtjet e tyre, si dhe kujt do t'i shpërndahen dhe si do t'i shfrytëzojnë ato mësimdhënësit dhe nxënësit.

Çështja e teksteve shkollore është me interes të madh në Kosovë, krahasuar me shumë vende të tjera evropiane. Kjo shpjegohet pjesërisht nga mësimdhënësit që mbështeten në tekstet shkollore që shihen si një burim universal për të nxënit dhe mësimdhënien. Për shkak të ndikimit të tyre të madh në një popullsi prej më shumë se 230,000 nxënësish dhe mësimdhënësish në arsimin e obligueshëm, pa përfshirë prindërit, tekstet shkollore përfaqësojnë një çështje të rëndësishme debati në mesin e politikanëve, sindikatave dhe publikut të gjerë.

Në sferën publike, ekziston një shqetësim të vazhdueshëm për sa i përket cilësisë së teksteve shkollore. Edhe pse diskutimet joformale lidhur me cilësinë e këtyre teksteve janë të shpeshta, analizat profesionale mbi cilësinë e teksteve shkollore janë relativisht të pakta.

1.2. Arsyeshmëria për rishikimin e teksteve shkollore

Qëllimi i MASHTI-t është që ta përmirësojë sistemin e arsimit dhe aftësisht të bazuar në cilësi, llogaridhënie, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare në fushën e arsimit. Për të arritur këtë qëllim, MASHTI i ka filluar proceset e recensimit dhe rishikimit të teksteve shkollore.

Legjislacioni aktual e parasheh recensimin dhe rishikimin e vazhdueshëm të teksteve aktuale shkollore. Megjithatë, procesi i vlerësimit të teksteve ishte sporadik, në baza të rastësishme dhe me një ndikim mjaft sipërfaqësor.

Kështu, për shembull, Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës e ka analizuar rishikimin e teksteve ekzistuese, i cili ishte bërë në vitin 2015 . Një pasqyrë e shkurtër e këtij raporti tregon se ndër aspekte të tjera:

- Sugjerimet që janë dhënë nga mësime dhënësit theksojnë gabime gramatikore në tekste ose tekstet shkollore në përgjithësi ishin tepër teorike dhe të vështira për t'u kuptuar. Pavarësisht kësaj, autorët përkatës të teksteve shkollore kanë bërë shumë pak analiza të tyre për të përcaktuar se çfarë përmirësimesh shtesë duhet t'u bëhen teksteve të tyre shkollore. Përveç kësaj, sipas anëtarëve të Këshillit të Teksteve Shkollore, rezultatet e pyetësorëve që janë plotësuar nga mësime dhënësit nuk i kanë përmbushur pritjet e tyre, pasi që nuk i kanë adresuar nevojat reale dhe nuk kanë sugjeruar përmirësime domethënëse në tekstet shkollore.
- Përqindja mesatare e ndryshimeve që ishin bërë në tekstet shkollore të tri shtëpive botuese ishte 8%. Gjatë auditimit, vlerësuesit kishin konstatuar se në tekstet e caktuara ishin rishikuar vetëm disa fjalë dhe ishin bërë vetëm disa korrigjime drejtshkrimore.
- Përbërja dhe kualifikimet e anëtarëve që i kishin rishikuar tekstet shkollore, veçanërisht ato për lëndët shkencore, nuk ishin plotësisht adekuate, për shkak të konflikteve të intereseve që ishin identifikuar.

Si rrjedhojë, ky proces rishikimi nuk ka rezultuar në eliminimin e mangësive thelbësore të teksteve shkollore, por vetëm të atyre teknike, dhe nuk ka arritur t'i adresojë problemet e thella dhe thelbësore.

Një analizë tjetër ishte bërë në vitin 2018 ku theksohen mangësitë e mëposhtme në tekstet shkollore bazuar në mbledhjen e të dhënave nga fokus grupet me mësime dhënësit: mungesa e relevancës dhe pajtueshmërisë me kurrikulën e re; mbingarkesë (me tema, tekst, fakte, formula); përmbajtja e fakteve të pasakta dhe koncepteve jo të definuara mirë; mungesa e ekuilibrit në gjerësinë dhe thellësinë e shpjegimit të temave; mungesa e perspektivës së shumëfishtë në shpjegimin e temave; struktura joadekuate dhe jo-konsistente e përmbajtjes; mungesa e referencës në burime shtesë për informata shtesë; mospërputhja me nivelin kognitiv të nxënësve;

Zyra Kombëtare e Auditimit, Kosovë (2016). Raporti i auditimit. Dokumenti nr: 214.9-2015/16-08 Procesi i rishikimit të teksteve shkollore, Prishtinë.

Boshtrakaj, L., Rraci, E., Bajrami, K. (2018). Cilësia e teksteve shkollore në Kosovë. KEEN.

Gjuha diskriminuese në tekstet shkollore-Analizë e teksteve shkollore të nivelit të mesëm të lartë, YIHR, Prishtinë, 2017.

KEC (2021). Vlerësimi i zbatimit të Planit Strategjik të Arsimit në Republikën e Kosovës (2017 - 2021. Arritje e pamjaftueshme.

mungesa e referencës/ndërlidhjes me informatat dhe përvojën e mëparshme të nxënësve; mungesa e korrelacionit ndër-kurrikular; mungesa e rezultateve të pritshme në fillim të çdo njësie/lëndë dhe kriteret e suksesit në fund të çdo njësie; pamundësia për ta përdorur tekstin në mënyrë fleksibile sipas aftësive dhe stileve të ndryshme të të nxënësve; fokusi në informata/fakte dhe riprodhimin e tyre; ilustrime joadekuata, jofunksionale dhe jo tërheqëse për nxënësin.

Ky raport mund të përbëjë një burim informatash për analiza të mëtejshme të teksteve shkollore.

Disa raporte janë fokusuar në aspektet gjinore të pasqyruara në tekstet shkollore.

Kështu, sipas analizës së bërë për tekstet e shkollave të mesme nga ana e Nismës Rinore për të Drejtat e Njeriut (YIHR) në vitin 2017, u identifikuan mbi 100 formulime të gjuhës diskriminuese dhe përjashtuese. Një studim tjetër, i zhvilluar nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) në vitin 2021, në kuadër të një projekti evropian konkludon, ndër aspekte të tjera, se analiza e teksteve shkollore për sa i përket gjinisë ka identifikuar stereotipizim të roleve gjinore.

Prandaj, ekziston nevoja për analiza më të thella, të cilat pasqyrojnë deri në çfarë mase tekstet shkollore i evitojnë paragjykimet e të gjitha llojeve, si ato të identifikuar nga Blumberg (2007, f. 52-54):

- Padukshmëria (përjashtim i plotë ose relativ nga një grup)
- Stereotipizimi (caktimi i padrejtë i karakteristikave për një grup, në llogari të attributeve dhe dallimeve individuale)
- Mosbalancimi dhe selektiviteti (paraqitja e vetëm një interpretimi të një çështjeje, situatë ose grupi të njerëzve)
- Jo-realiteti (injorimi i aspekteve të pakëndshme në favor të atyre lajkatare)
- Fragmentimi dhe izolimi (paraqitja e grupeve jo dominuese si anëtarë periferikë të shoqërisë)
- Paragjykimi kozmetik (gjërat dukej se ishin 'korrigjuar'/'përmirësuar' në libra, por paragjykimi vazhdon të qëndrojë në mënyra të ndryshme; paragjykimet kozmetike reflektojnë në fakt ndryshimet sipërfaqësore, si në rastin e teksteve shkollore që duket se adresojnë pjesëmarrjen e grave në, dhe kontributi i tyre në shoqëri, por duke i lidhur ato thjesht me role dytësore ose mbështetëse).

Hulumtimi më i fundit (2022) i kryer nga Instituti Pedagogjik i Kosovës i evidenton opinionet e mësimdhënësve të klasës së tretë dhe të klasës së tetë lidhur me cilësinë e teksteve shkollore nga fokus grupet me mësimdhënësit e tri shkollave në tri komuna të Kosovës.

Blumberg, Rae Lesser. 2007. 'Gender bias in textbooks: A hidden obstacle on the road to gender equality in education'. UNESCO EFA-GMR. (Background paper prepared for the Education for All Global Monitoring Report 2008: Education for All by 2015: Will we make it?).

Arbnesha Mexhuani, Bekim Morina (2021). Opinionet e mësimdhënësve për tekstet e reja shkollore (klasat e iii-ta dhe klasat e viii-ta), IPK.

Përtej perceptimit përgjithësisht pozitiv për tekstet e reja shkollore, ka shumë kritika, veçanërisht për sa i përket çështjeve të mëposhtme: fotografitë dhe grafikët nuk përputhen me moshën e nxënësve të cilëve u adresohen; ka shumë pak ose mungojnë lidhjet ndërmjet kapitujve; mungojnë detyrat që kërkojnë të menduar të nivelit më të lartë; shumica e detyrave janë të njëanshme dhe kërkojnë përsëritje; shpesh, kompleksiteti i prezantimit është shumë më i madh se moshja e nxënësve, ndërkohë që nuk ka detyra që kërkojnë aftësi të larta të të menduarit; ka paragrafë apo edhe njësi të tëra mësimore që përsëriten në klasa të ndryshme, si dhe shumë mangësi tjera .

Mësimdhënësit janë të thirrur t'i shprehin opinionet e tyre për tekstet shkollore, meqenëse ata punojnë me këto burime në klasë. Megjithatë, nevojitet një proces më i përpunuar i analizës për t'i përfshirë opinionet e mësimdhënësve në një mekanizëm koherent për rishikimin dhe recensimin e teksteve shkollore.

Legjislacioni aktual e parasheh recensimin dhe rishikimin e vazhdueshëm të teksteve aktuale shkollore. Mungesa e teksteve adekuate shkollore për zbatimin e kurrikulës së re vazhdon të jetë një nga sfidat kryesore në arsimin e Kosovës. Mangësitë e supozuara dhe aspektet tjera duhet të hulumtohen në mënyrë profesionale për ta hapur perspektivën për burime të reja mësimore të përmirësuara.

Duke i marrë parasysh të dhënat e mbledhura që tregojnë disa nga mangësitë e teksteve shkollore që janë në përdorim, MASHTI ka vendosur ta përdorë një mekanizëm vlerësimi të bazuar në kritere dhe përshkrues që do të mundësojnë, nga njëra anë, një analizë më profesionale dhe nga ana tjetër, do të sjellin zgjidhje konkrete për përmirësimin e cilësisë së këtyre teksteve shkollore.

Në fund të vitit shkollor 2022-2023, MASHTI e ka nisur procesin e rishikimit profesional të teksteve ekzistuese shkollore. Ky proces kishte për qëllim mbledhjen e të dhënave specifike lidhur me cilësinë aktuale të teksteve shkollore, identifikimin e fushave për përmirësim dhe ofrimin e rekomandimeve për intervenime të synuara për ta ngritur cilësinë e teksteve shkollore dhe për të krijuar mekanizma të aftë që garantojnë qëndrueshmëri.

Me mbështetjen e projektit KosEd, është zhvilluar procesi i përmirësimit të cilësisë së teksteve shkollore duke e adresuar ngritjen e kapaciteteve të recensentëve të teksteve shkollore (Ekipet e rishikimit), bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare, si dhe modele të aplikueshme në kontekstin e Kosovës.

Detyra e ekipeve të recensentëve përfshin kontributin e tyre në përmirësimin e cilësisë së teksteve aktuale shkollore duke ofruar një analizë profesionale të këtyre teksteve shkollore duke u bazuar në kritere. Faza e parë e këtij procesi të filluar - faza pilot ka pasur për qëllim që ta përmirësojë cilësinë e teksteve shkollore të gjuhës shqipe dhe matematikës për klasat 1 deri në 9. Projekti KosEd ka ofruar mbështetje në aspektin e ngritjes së kapaciteteve të ekipeve për recensim në mënyrë që të ofrojnë analiza të bazuara në kritere dhe rekomandime për përmirësimin e teksteve të analizuar.

Këto procese kanë pasur për qëllim mbledhjen e të dhënave specifike lidhur me cilësinë e teksteve ekzistuese shkollore, identifikimin e fushave që kërkojnë përmirësime dhe ofrimin e rekomandimeve për intervenime të fokusuara në tekstet ekzistuese shkollore me qëllim

që të përmirësohen ato, në mënyrë që nxënësit të pajisen me tekste shkollore më cilësore në një afat sa më të shkurtër. Ky ushtrimi do të krijojë premisa për intervenime të përmirësuar në fazat e ardhshme të proceseve të rishikimit dhe recensimit të teksteve shkollore, në baza profesionale, në planin afatmesëm dhe afatgjatë.

Kjo fazë pilot duhet të përsëritet në vitet e ardhshme për lëndët tjera, në mënyrë që tekstet aktuale në treg të ofrojnë një përvojë më të mirë mësimore për nxënësit dhe një udhëzim më koherent për mesimdhënësit. Në periudha afatgjate, metodologjia e nisur në kuadër të këtij hulumtimi mund të përbëjë thelbin për programet e ngritjes së kapaciteteve të ekipeve të recensentëve të cilët do ta vlerësojnë cilësinë e gjeneratave të reja të teksteve shkollore.

1.3. Metodatat dhe Strategjia e zbatimit të procesit të rishikimit të teksteve shkollore

Janë ndërmarrë këto aktivitete:

► KosEd i ka zhvilluar dokumentet e mëposhtme:

- Draftin e TeR për rishikimin e teksteve shkollore dhe ekipet e recensentëve. Bazuar në TeR, MASHTI e ka nxjerrë vendimin për iniciimin e procesit.

- Kriteret dhe përshkruesit për rishikimin e teksteve shkollore. U ra dakord që shablloni i propozuar nga projekti KosEd është i përshtatshëm për nevojat aktuale të MASHTI-t lidhur me rishikimin e teksteve shkollore.

- Metodologjia e procesit të rishikimit, e cila përfshinte arsyeshmërinë e këtij intervenimi në sistemin arsimor dhe procedurat që do të përdoren.

- Kriteret specifike për ekspertët – anëtarët në ekipet e rishikimit, të përfshirë në TeR për përzgjedhjen e këtyre ekspertëve. Këto janë bazuar në UA 18/2018 dhe Thirrjen për shprehje të interesit për recensentët e teksteve që e ka shpallur MASHTI.

► Instrumenti i rishikimit të teksteve shkollore dhe metodologjia e rishikimit të teksteve janë prezantuar në Këshillin e Teksteve Shkollore dhe janë miratuar nga Këshilli.

► U vendos që në kuadër të kësaj faze pilot të bëhet rishikimi për tekstet shkollore të gjuhës shqipe dhe matematikës, klasat 1 deri 9. Arsyeshmëria për të filluar me këto lëndë ishte se këto janë lëndët ku nxënësit kosovarë kanë arritur rezultatet më të ulëta në testet PISA.

► Në fillim të procesit është nisur një fushatë vetëdijesimi për ta shpjeguar publikisht rëndësinë e teksteve shkollore me cilësi të lartë, për të ndërtuar perceptimin publik se përmirësimi i teksteve shkollore është një ndërhyrje kyçe në përmirësimin e cilësisë së arsimit, për të gjeneruar qëndrime pozitive dhe proaktive ndërmjet palëve të përfshira të

interesit, dhe, së fundi, por jo më pak e rëndësishme, për ta zgjeruar bazën e përzgjedhjes për recensentët e mirë potencial.

► MASHTI dhe projekti KosEd punuan bashkërisht që t'i identifikojnë dhe angazhojnë anëtarët e ekipeve të recensentëve për ta realizuar procesin e rishikimit, bazuar në TeR të ofruara dhe rekomandimet e bëra nga Këshilli i Teksteve Shkollore. Komision i përbërë nga ekspertë të KosEd dhe përfaqësues zyrtarë të MASHTI-t i kanë përzgjedhur 26 ekspertë nga 100 aplikime.

Numri dhe përbërja e këtyre ekipeve janë paraqitur më poshtë. Bazuar në shkallët kurrikulare (ShK) për klasat 1 deri në 9, janë përzgjedhur dhe organizuar tetë ekipe vlerësuese, si më poshtë:

Ekipi për klasat 1-2 (ShK1) Gjuhë shqipe
Ekipi për klasat 3-5 (ShK2) Gjuhë shqipe
Ekipi për klasat 6-7 (ShK3) Gjuhë shqipe
Ekipi për klasat 8-9 (ShK4) Gjuhë shqipe
Ekipi për klasat 1-2 (ShK1) Matematikë
Ekipi për klasat 3-5 (ShK2) Matematikë
Ekipi për klasat 6-7 (ShK3) Matematikë
Ekipi për klasat 8-9 (ShK4) Matematikë

Çdo ekip i recensentëve përbëhej nga një profesor universiteti ose një hulumtues me përvojë, një mësimdhënës dhe një specialist në pedagogji ose psikologji. Përveç kësaj, u zgjodhën edhe dy specialistë për çështjet gjinore për ta mbështetur punën e të gjitha ekipeve të recensentëve. Në secilin ekip, njëri nga anëtarët u emërua si Sekretar shkencor, me detyrë që ta hartojë raportin e rishikimit në emër të dhe në marrëveshje të plotë me ekipin e recensentëve, për të siguruar koherencën e intervenimeve të të gjithë anëtarëve të grupit në raport.

Detyra e ekipeve të recensentëve ishte që të ofrojnë një analizë profesionale të bazuar në kriteret e teksteve shkollore për gjuhë shqipe dhe matematikë që aktualisht përdoren në shkollat e arsimit të obligueshëm. Ekipet e recensentëve janë pajisur me: Kornizën e Kurrikulës së Kosovës, Kurrikulën Bërthamë, Kurrikulën e lëndëve për gjuhë shqipe dhe matematikë, dhe dokumentacionin lidhur me rishikimet e mëparshme dhe analizat e teksteve shkollore.

► Ngritja e kapaciteteve për ekipet e recensentëve

Ekipi i projektit KosEd e ka përgatitur dhe e ka ofruar një program për ngritjen e kapaciteteve të recensentëve, si dhe ka ofruar trajnim dhe mentorim gjatë procesit të rishikimit për ta siguruar cilësinë.

“Programi për ngritjen e kapaciteteve të recensentëve të teksteve shkollore” u organizua në maj - qershor 2023, dhe përbëhej nga një trajnim intensiv 5-ditorë duke e përcjellë me një aktivitet monitorues të rishikimit të teksteve shkollore.

	ShK	ShK1				ShK2						ShK3				ShK4			
		Shq		Mat		Shq			Mat			Shq		Mat		Shq		Mat	
	Notat	K1	K2	K1	K2	K3	K4	K5	K3	K4	K5		K7	K6	K7	K8	K9	K8	K9
Shtëpia botuese	Dukagjini	1	1	1	1	1	1	1		1	1	1	1	1	1		1	1	1
	Libri shkollor	1			1							1							
	Albas	1	1		1	1				1	1					1	1	1	
	Luarasi				1				1										
	Magjia e librit	1																	
	Pegi					1						1					1		1
	Berati									1									
	DUKAGJINI DHE PEGI	1																	
Gjithsej		5	2	1	4	3	2	1	1	3	2	3	1	1	1	1	3	2	2
		7		5		6			6			4		2		4		4	

Tabela 1: Lista dhe numri i teksteve shkollore që janë rishikuar sipas katalogut të MASHTI-t në dispozicion në qershor të vitit 2023

Programi u fokusua në:

- Fuqizimin e kapaciteteve të pjesëmarrësve për të mbledhur të dhëna specifike për cilësinë e teksteve aktuale shkollore.
- Zhvillimin e kompetencave të pjesëmarrësve në identifikimin e fushave të teksteve shkollore që kërkojnë përmirësim.
- Ngritjen e kompetencave të pjesëmarrësve dhe angazhimin për të ofruar rekomandime për intervenime të fokusuara që kanë për qëllim përmirësimin e teksteve ekzistuese shkollore.

Programi i ngritjes së kapaciteteve për recensentëve vazhdimisht synonte të përmirësonte tek recensentët:

- Kapacitetin për të **përdorur kritere** dhe përshkrues për vlerësimin e teksteve shkollore.
 - Ta kuptojnë **lidhjen ndërmjet kurrikulës së bazuar në kompetenca dhe përmbajtjes** së një teksti shkollor.
 - Kapacitetin për të ofruar **raporte informuese, të bazuara në dëshmi** mbi cilësinë e një teksti shkollor; kapacitetin për të ofruar **rekomandime** të hollësishme për përmirësimin e teksteve shkollore.
- Ekipet e recensentëve e realizuan rishikimin e teksteve shkollore për gjuhë shqipe dhe matematikë. Numri i teksteve të identifikuara për rishikim nga secili ekip i recensentëve është paraqitur më poshtë.

Shpërndarja e numrit të teksteve për lëndë mësimore ishte si më poshtë: për gjuhën shqipe – 21 tekste dhe për matematikën – 17 tekste, ndërsa për shkallë kurrikulare shpërndarja ishte: ShK1 – 12, ShK2 – 12, ShK3 – 6, ShK4 – 8. Numri i teksteve shkollore për shtëpi botuese ishte si më poshtë: Albas – 11, Berati – 1, Dukagjini – 15, Dukagjini dhe Pegi -1, Libri shkollor – 3, Luarasi – 2, Magjia e librit – 1, Pegi – 5.

►Gjatë procesit të rishikimit, ekipi i trajnerëve të KosEd e ka monitoruar progresin e punës së ekipeve të recensentëve dhe ka ofruar informata kthyesë dhe mbështetje të vazhdueshme, për të siguruar konsistencë në raportet e rishikimit.

►Për secilin tekst të analizuar, ekipet e recensentëve kanë përpiluar raporte të detajuara që përmbajnë vëzhgime të bazuara në kritere dhe rekomandime për përmirësim. Rekomandimet supozohen se ishin faktike dhe të realizueshme, duke marrë parasysh afatin e shkurtër kohor për zbatimin e ndryshimeve dhe nevojën për të siguruar cilësi më të mirë të teksteve aktuale. Rekomandimet janë shoqëruar, për aq sa është e mundur, me shembuj konkretë dhe sugjerime për përmirësim.

Raportet e prodhuara nga recensentët ekspertë përbëhen nga katër pjesë thelbësore, ku secila kërkon lexim të kujdesshëm për të pasur një kuptim gjithëpërfshirës se si të përmirësohen tekstet ekzistuese shkollore:

Pjesa 1: Komente të shkurtra të përgjithshme rreth tekstit shkollor (struktura, përmbajtja e njësive të tekstit) ofron një pasqyrë të tekstit të rishikuar.

Pjesa 2: Përparësitë dhe mangësitë reflektojnë mbi pikat e forta (përparësitë) si dhe mangësitë e tekstit shkollor që është në rishikim.

Pjesa 3: Rishikimi i tekstit shkollor bazuar në kriteret e përcaktuara paraqet një tabelë që përbëhet nga 5 kritere dhe 25 përshkrues të pasur për një vlerësim të thellë të tekstit shkollor. Këtu jepen komente dhe shpjegime lidhur me masën në të cilën teksti i analizuar e plotëson çdo kriter dhe përshkrues. Pesë kriteret dhe përshkruesit përkatës shpjegohen shkurtimisht më poshtë.

►BASHKËRENDIMI I KURRIKULËS

d.m.th, Struktura e tekstit shkollor është në përputhje me kurrikulën e re të bazuar në kompetenca.

U adresuan përshkruesit e mëposhtëm:

- 1.1 E strukturuar në njësi mësimore të qarta dhe të balancuara
- 1.2 E fokusuar në zhvillimin e kompetencave
- 1.3 Mbulon njohuritë dhe aftësitë që kanë në themel kompetencat
- 1.4 I trajton qëndrimet dhe vlerat
- 1.5 Përfshin detyrat e vlerësimit në përputhje me kompetencat

►SAKTËSIA E PËRMBAJTJES

d.m.th, Përmbajtja e tekstit shkollor është e saktë, relevante, e përshtatshme dhe objektive.

U adresuan përshkruesit e mëposhtëm:

- 2.1 Pasqyron kulturën dhe traditat e Kosovës
- 2.2 Ka karakter etik, moral dhe jo-diskriminues
- 2.3 Bazohet në fakte dhe informacione të verifikuara
- 2.4 Është paraqitur në mënyrë koherente dhe logjike
- 2.5 Përmban temat e përcaktuara nga kurrikula
- 2.6 I përshtatet grup moshës
- 2.7 Përfshin detyrat e vlerësimit tradicional dhe alternativ

►EFEKTIVITETI I STRATEGJIVE TË TË NXËNIT

(Strategjitë e të nxënit të propozuara në tekstin shkollor janë efektive, dhe i ndjekin kërkesat e kurrikulës së bazuar në kompetenca).

U adresuan përshkruesit e mëposhtëm:

- 3.1 Është organizuar për ta promovuar përparimin nga e thjeshtë në atë komplekse
- 3.2 Përfshin ushtrime/detyra për zhvillimin e shkathtësive themelore
- 3.3 Motivon të nxënit dhe e stimulon kreativitetin
- 3.4 Stimulon të nxënit aktiv dhe të bazuar në kërkim
- 3.5 Ka ndërlidhje me botën reale
- 3.6 Promovon të nxënit e diferencuar
- 3.7 Inkurajon të menduarit e nivelit më të lartë
- 3.8 Përfshin vlerësimin formativ dhe atë sumativ
- 3.9 Është inter-disiplinare

►SAKTËSIA DHE QASJA E GJUHËS

(Gjuha e përdorur është e saktë dhe e qasshme):

U adresuan përshkruesit e mëposhtëm:

- 4.1 Saktësia e gjuhës; pa gabime tipografike
- 4.2 Lexueshmëria

►PARAQITJA DHE DIZAJNI

Cilësia e prezantimit të tekstit shkollor (faqet, fontet, titujt, imazhet, ngjyrat, etj.) mbështetshin zhvillimin intelektual të nxënësve

U adresuan përshkruesit e mëposhtëm:

- 5.1 Cilësia e formatit dhe e dizajnit
- 5.2 Cilësia e grafikës dhe ilustrimeve

Pjesa 4: Rekomandimet (Komente dhe korrigjime të hollësishme për secilën faqe të tekstit shkollor) Kjo pjesë ofron rekomandime të detajuara faqe për faqe për përmirësim që rrjedhin nga një proces gjithëpërfshirës i rishikimit të teksteve shkollore.

Procesi i rishikimit përfshiu të 38 tekstet shkollore të miratuara si tekste zyrtare dhe të listuara në katalogun e MASHTI-t për gjuhë shqipe dhe matematikë në arsimin e obligueshëm (klasat 1 deri në 9). Në shumicën e rasteve janë analizuar edhe burimet plotësuese që lidhen me tekstin kryesor (udhëzues për mësimdhënësit, fletore pune për nxënësin).

Me një sasi nga 8 deri në 23 faqe secili, 38 raportet e rishikimit mbulojnë më shumë se 600 faqe në total.

Ky raport është një sintezë e të gjeturave. Për të shmangur implikimet që rrjedhin nga një paraqitje jo e plotë e të dhënave e që është e pashmangshme për këtë raport sintetik, tekstet shkollore janë koduar. Gjatë prezantimit të gjetjeve, ne do t'u referohemi më tej këtyre kodeve.

Puna e ekipeve të recensentëve ka ofruar të dhëna për cilësinë e teksteve aktuale shkollore, duke identifikuar fushat që kërkojnë përmirësim dhe duke ofruar rekomandime për përmirësime në mënyrë që nxënësit të mund të pajisen me tekste më cilësore në një afat të shkurtër. Ky ushtrim synonte, po ashtu, të krijonte një bazë profesionale për përmirësime në fazat e ardhshme të rishikimit dhe vlerësimit të teksteve shkollore një periudhë afatmesme dhe afatgjatë.

2. Prezantim i shkurtër i rezultateve kryesore të procesit të rishikimit të teksteve shkollore

Në vijim do të paraqesim, në mënyrë të përqendruar, përparësitë kryesore dhe mangësitë e identifikuara në tekstet shkollore nga ekipet e recensentëve. Për të shmangur çdo interpretim subjektiv, referenca për çdo tekst shkollor është bërë përmes kodit të tij përkatës. Të gjeturat janë paraqitur sipas kriterëve të përdorura për analizimin e teksteve shkollore.

2.1. Përparësitë dhe mangësitë në tekstet shkollore të gjuhës shqipe në arsimin e obligueshëm

2.1.1 Përparësitë në tekstet e gjuhës shqipe

Analiza e teksteve shkollore të gjuhës shqipe i nxori në pah disa pika përparësi, të cilat po i përmendim shkurtimisht në vijim.

2.1.1.1. Bashkërendimi i kurrikulës

Lidhur me koherencën e strukturës së librit, janë evidentuar disa rezultate pozitive. Kështu, për shembull, struktura dhe përmbajtja e ShK1K1ShD nuk janë të mbingarkuara me informata të panevojshme dhe trajtojnë kompetenca specifike të bazuara në kurrikulën e gjuhës shqipe për klasën e parë. Teksti shkollor ShK2K2ShH ka një strukturë dhe organizim të qëndrueshëm të njësive mësimore brenda pesë kapitujve të saj.

Theksi në zhvillimin e kompetencave shihet si një përparësi e teksteve shkollore ShK1K1-ShA, ShK1K1ShG, dhe ShK2K3ShA. ShK1K1ShA është një libër shkollor i fokusuar që përputhet me kompetencat e përgjithshme të përshkruara në Kornizën e Kurrikulës së Kosovës. Të dyja ShK1K1ShG dhe ShK2K3ShA mbulojnë shkathtësitë dhe njohuritë që mbështesin kompetencat e rekomanduara me kurrikulë. Shumica e teksteve shkollore përmbajnë ushtrime/detyra të dizajnuara për t'i ushtruar shkathtësitë thelbësore, e që konsiderohet si përparësi në ShK1K1ShG, ShK2K2ShH, ShK2K4ShA, ShK2K5ShC, dhe ShK2K4ShC.

Këto tekste përfshijnë tekste të zgjedhura dhe një varg detyrash që ndihmojnë në zhvillimin e shkathtësive themelore të komunikimit.

Njësitë mësimore përfshijnë një gamë të gjerë tekstesh letrare dhe jo-letrare, materiale tërheqëse me fakte interesante, si dhe informata shkencore dhe logjike. Nëpërmjet këtyre teksteve nxënësit marrin edhe njohuri kulturore dhe elemente të sistemit gjuhësor. Përveç kësaj, teksti shkollor ShK3K6ShC përfshin një fletore pune me pyetje dhe ushtrime të shumta që u ndihmojnë nxënësve në zhvillimin e vazhdueshëm të shkathtësive.

Vetëm një libër shkollor është përmendur se ka përparësi sa i përket bashkërendimit të detyrave të vlerësimit me kompetencat - ShK2K3ShA. Ky tekst shkollor përfshin tekste të përzgjedhura dhe një varg detyrash e ushtrimesh që u ndihmojnë nxënësve t'i zhvillojnë shkathtësitë e komunikimit dhe të ofrojnë vlerësim për nivelin e arritjes së këtyre kompetencave.

Në mënyrë të ngjashme, detyrat për ShK4K9ShH fokusohen po ashtu në shkathtësitë e komunikimit, siç kërkohet me kurrikulë. Këto detyra mbulojnë të gjitha nivelet e taksonomisë së Bloom-it, duke mundësuar të nxëniet e diferencuar. Çdo njësi mësimore përfundon me detyra që nxisin jo vetëm shkathtësitë e të shkruarit kreativ, por edhe e stimulojnë të menduarit kritik.

Detyrat e tekstit shkollor ShK4K9ShA i synon shkathtësitë e komunikimit që kërkohen me kurrikulën e klasës së 9-të. Duke pasur parasysh fokusin e kurrikulës në komunikim, një pjesë e konsiderueshme e detyrave e trajtojnë këtë aspekt. Për shembull, në pjesët letrare ku personazhe janë mësimdhënësi dhe nxënësit, detyrat nxisin diskutime rreth dinamikës së marrëdhënies së tyre.

Në tekstin shkollor ShK2K4ShC, të gjitha njësitë mësimore ndërlidhen me shkathtësitë e komunikimit, të cilat theksohen në krye të faqeve në libër. Qasja për zhvillimin e shkathtësive të komunikimit është e integruar me radhë ku shkathtësitë trajtohen në njësitë përkatëse mësimore. Shkathtësitë e komunikimit që janë fokusi kryesor i një njësie mësimore dallohen nëpërmjet ngjyrave të ndryshme të përdorura në tekstin e gjuhës shqipe në të dyja pjesët e librit. Teksti shkollor ShK3K6ShH është i strukturuar mirë, koherent, i përpunuar me përpikëri dhe mbulon një gamë të gjerë temash letrare dhe jo-letrare. Ai përmban informata të përditësuara dhe është shkruar me saktësi të përpiktë shkencore.

Në tekstin shkollor ShK2K3ShA, qasja për zhvillimin e shkathtësive të komunikimit është evidente në çdo njësi mësimore. Çdo njësi fokusohet në një shkathtësi specifike komunikimi, e cila më pas lidhet me shkathtësitë tjera të komunikimit.

Shkathtësitë e veçanta të komunikimit që janë fokusi kryesor i një njësie nëpërmjet përdorimit të ngjyrave të ndryshme në tekstin e gjuhës shqipe. Këto njësi përmbajnë një gamë të gjerë të teksteve letrare dhe jo-letrare, të cilat jo vetëm që ofrojnë njohuri kulturore, por edhe elemente të sistemit gjuhësor në tekstin shkollor ShK2K3ShC.

Ato përfshijnë, po ashtu, një varg detyrash dhe ushtrimesh që u ndihmojnë nxënësve në zhvillimin e shkathtësive themelore të komunikimit, e që është një nga objektivat parësorë të kurrikulës së gjuhës shqipe për nxënësit e klasës së tretë. E njëjta qasje për zhvillimin e shkathtësive të komunikimit mund të vërehet në çdo njësi mësimore të tekstit shkollor ShK2K4ShA, ku çdo njësi nxjerr në pah një shkathtësi specifike të komunikimit që ndërlidhet me shkathtësitë tjera.

2.1.1.2. Saktësia e përmbajtjes

Gjuha e përdorur në tekstet shkollore ShK3K6ShC dhe ShK3K6ShE korrespondon me moshën e nxënësve dhe merret parasysh kompleksiteti i strukturës së fjalisë. Tekstet promovojnë në mënyrë aktive edukimin dhe përdorimin e përgjegjshëm të mediave, si dhe inkurajojnë hulumtime të pavarura duke i nxitur nxënësit të kërkojnë në internet dhe të krahasojnë burime të ndryshme. Përveç kësaj, gjuha e përdorur në librin ShK4K8ShA është përgjithësisht e drejtpërdrejtë dhe e përshtatshme për grup-moshën e synuar të nxënësve.

Përparësia e pasqyrimin të kulturës dhe traditave të Kosovës është përmendur në disa tekste shkollore. Pra, teksti shkollor ShK1K1ShE pasqyron në përgjithësi kulturën dhe traditën kosovare si përmes ilustrimeve ashtu edhe përmes terminologjisë së përdorur. Tekstet shkollore ShK1K1ShA dhe ShK1K2ShA po ashtu i shfaqin vlerat dhe traditat e Kosovës, me fokus të veçantë në tema nga jeta rurale, duke e bërë tekstin të ndërlidhur dhe të qasshëm për nxënësit e moshës përkatëse.

Përveç kësaj, teksti shkollor ShK2K4ShA përmban një gamë të larmishme tekstesh letrare dhe jo-letrare, duke përfshirë përmbajtje zbavitëse, fakte interesante dhe informata shkencore dhe logjike, të cilat u ndihmojnë nxënësve të përfitojnë njohuri kulturore dhe aftësi gjuhësore. Tekstet jo-letrare në ShK4K9ShH janë përzgjedhur me kujdes dhe kanë prioritet studimin e historisë kombëtare dhe të vlerave globale.

Njësitë mësimore të tekstit shkollor ShK2K3ShA mbulojnë temat kryesore dhe rezultatet e të nxënësve të përcaktuara me kurrikulë të klasës së tretë. Temat në tekstin shkollor (gjithsej 35) përbëhen nga një larmi tekstesh të ndryshme letrare dhe jo-letrare, tekste argëtuese, me kuriozitete dhe informata shkencore e logjike nëpërmjet të cilave mësohen edhe njohuritë kulturore dhe elementet e sistemit gjuhësor. Njësitë mësimore në të dyja pjesët e tekstit shkollor të gjuhës shqipe ShK2K3ShC kanë një strukturë të qëndrueshme, të qartë, si dhe dizajn të mirë. Ato mbulojnë temat kryesore dhe rezultatet e të nxënësve të përcaktuara me kurrikulë të klasës së tretë. Teksti shkollor ShK2K4ShC mbulon temat kryesore dhe rezultatet e të nxënësve të temave të përcaktuara me kurrikulë të lëndës së gjuhës shqipe të klasës së katërt. Ato paraprihen nga një njësi mësimore njoftuese që ndërlidhet me kthimin në shkollë dhe një njësi të veçantë lidhur me qëllimet mësimore që nxënësi ia

vendos vetes në fillim të vitit shkollor. Përmbajtja e tekstit shkollor të gjuhës shqipe ShK2K5ShC përfshin shumicën e temave mësimore dhe rezultatet e të nxëniet që rekomandohen nga dokumentet e kurrikulës. Teksti shkollor ShK3K6ShE (2021) është organizuar në njësi mësimore të definuara mirë dhe ofron shpjegime të qarta për tërë përmbajtjen.

Një libër i vetëm është përmendur se ka përparësi për sa i përket përfshirjes së detyrave të vlerësimit tradicional dhe alternativ. Teksti shkollor ShK2K5ShC përpiket t'i integrojë vlerësimet alternative, duke përfshirë praktikën e vlerësimit të bazuar në projekt. Një shembull i mirë i vlerësimit të ndërsjellë është paraqitur në faqen 157, ku nga nxënësit kërkohet ta vlerësojnë punën e njërit-tjetrit, duke u bazuar në pikat e planit të vlerësimit për projektin "Gjërat e rëndësishme në jetë". Skema e notimit për vlerësim ndërlidhet me: a) përmbajtjen e posterit; b) tekstin e posterit; c) paraqitjen e posterit, ç) titullin dhe nënshkrimin e autorit të posterit; d) përzgjedhjen e materialeve fotografike; e) prezantimin; f) kohën e prezantimit; g) përfilljen e të gjitha udhëzimeve.

Kriteri i përshtatshmërisë së moshës është përmbushur fuqishëm nga disa tekste shkollore. Si rezultat, përmbajtja e ShK1K1ShA dhe ShK1K1ShE është lehtësisht e qasshme dhe e përshtatshme për nxënësit e klasës së parë. Përmbajtjet e shkruara dhe vizuale të tekstit shkollor ShK1K1ShC janë të përshtatshme për nxënësit e klasës së parë, pasi që ndërlidhen me botën e tyre reale, duke përfshirë familjen, shoqërinë dhe kafshët shtëpiake, domethënë me gjërat që i rrethojnë, dhe janë të lehta për t'u kuptuar. Gjuha e përdorur në tekstet e zgjedhura të ShK2K3ShA, ShK2K3ShC, dhe ShK2K2ShH është e qartë dhe e përshtatshme për moshën e nxënësve, është e thjeshtë dhe ka kuptim, duke e bërë të lehtë për t'u kuptuar dhe mësuar. Metodologjia e mësimit të gjuhës përgjithësisht është prezantuar mirë dhe është e kuptueshme për nxënësit në tekstin shkollor ShK2K4ShA.

Mënyra koherente dhe logjike e paraqitjes së përmbajtjes është konsideruar si një element i fortë në tri tekstet e mëposhtme shkollore: ShK1K1ShA, ShK1K2ShC, dhe ShK1K2ShA.

Përmbajtja e bazuar në fakte dhe informata të verifikuara shkencore është vlerësuar si përparësi vetëm në tri tekste shkollore: ShK1K1ShG, ShK1K2ShC, dhe ShK3K6ShH.

Tekstet e zgjedhura letrare dhe jo-letrare të teksteve shkollore ShK2K2ShH, ShK2K3ShC, dhe ShK2K4ShA janë jo-diskriminuese dhe pa paragjykime. Ato përpiqen për t'u ndërlidhur mirë me kulturën vendase, traditat dhe botën reale. Tekstet e përzgjedhura letrare dhe jo-letrare të tekstit shkollor ShK2K4ShC nuk janë diskriminuese dhe fokusohen në ndërlidhjen e mirë me kulturën, traditat kombëtare, si dhe me parimet dhe vlerat ndërkombëtare. Gjuha e përdorur në tekstet dhe aktivitetet e përzgjedhura me nxënës respekton parimet e diversitetit, duke siguruar mos-diskriminim në baza racore, etnike, gjuhësore, fetare, statusit social, besimeve, gjinisë, moshës, aftësisë së kufizuar ose përkatësisë në kategori të cënueshme. Teksti shkollor ShK3K6ShE nuk shfaq asnjë formë diskriminimi në baza gjinore, racore apo ndonjë aspekti tjetër. Ai i përfillë standardet etike, morale dhe jo-diskriminuese. Përveç kësaj, çdo njësi mësimore në këtë tekst shkollor e ka fjalorin e vet të veçantë.

Janë disa tekste shkollore ku theksohet si përparësi karakteri etik, moral dhe jo-diskriminues. Për shembull, teksti shkollor ShK1K1ShD tregon qasjen ndaj personave me nevoja të veçanta dhe përkujdesjen ndaj tyre në situata të ndryshme jetësore, duke e theksuar parimin e gjithë-përfshirjes që promovohet me kurrikulë të re.

Teksti shkollor ShK1K1ShE, në përgjithësi, bazohet në parimin e gjithë-përfshirjes dhe nuk vërehet asnjë koment diskriminues për sa i përket racës, kombësisë, përkatësisë etnike, gjuhës, fesë, statusit social, besimit, gjinisë, moshës, aftësisë së kufizuar apo përkatësisë në kategori të cenueshme. Në tekstet shkollore ShK1K1ShC, ShK1K2ShC nuk ka komente diskriminuese dhe ka një përfshirje të ekuilibruar të dy gjinive dhe ngjyrave. Gjuha e përdorur në tekstet e përzgjedhura dhe aktivitetet me nxënësit në ShK2K3ShA i respekton parimet e dallimit në aspektin e racës, kombësisë, etnisë, gjuhës, fesë, statusit social, besimit, gjinisë, moshës, aftësisë së kufizuar ose përkatësisë në kategori të cenueshme, etj.

2.1.1.3. Efektiviteti i strategjive të të nxënit

Në tekstin shkollor ShK3K6ShC disa njësi mësimore ofrojnë ndërlidhje me lëndë të tjera, duke u mundësuar nxënësve t'i shtojnë njohuritë e tyre në fusha të tjera. Në tekstin shkollor ShK3K6ShH ka njësi mësimore që përfshijnë edhe lëndë të ndryshme, duke i njohur nxënësit me figura kulturore (muzikë) dhe lokacione të ndryshme kulturore (Prizren, Berat, Pogradec, Liqeni i Ohrit) etj. Teksti shkollor për gjuhë shqipe 7 ShK3K7ShC mbulon tema që ndërlidhen me disa tema tjera sociale, duke përfshirë gazetarinë dhe komunikimin në përgjithësi. Në tekstin shkollor ShK4K8ShA, fuqia e tekstit qëndron në integrimin ndër-disiplinar, me lidhjet ndërmjet gjuhës dhe letërsisë, matematikës, gjuhëve të huaja, historisë dhe gjeografisë. Teksti shkollor ShK4K9ShA integrohet edhe me lëndë tjera, duke e tërhequr vëmendjen e nxënësve në fushën e etnografisë nëpërmjet letërsisë me elemente folklorike, duke i nxitur ata të bëjnë hulumtime në këtë fushë.

Të dyja pjesët e tekstit shkollor të gjuhës shqipe ShK2K3ShC kontribuojnë në të nxënit ndër-disiplinar duke përfshirë tekste të shkurtra dhe burime të tjera të informacionit. Ato u ofrojnë nxënësve lidhje më të ngushta me tri fusha kurrikulare: letërsinë, shkencat natyrore dhe shoqërinë dhe mjedisin. E njëjta gjë mund të thuhet për të dyja pjesët e tekstit shkollor të gjuhës shqipe 4A & gjuhës shqipe 4B ShK2K4ShC. Në këta libra, tekstet e përzgjedhura janë integruar me kujdes që të përkojnë me data me rëndësi të veçantë, si Dita Ndërkombëtare e Shkrim-leximit, Dita Ndërkombëtare e të Moshuarve dhe Dita Botërore e Ushqimit. Shumica e teksteve të përzgjedhura leximi janë të përshtatshme për nivelin e klasës dhe shoqërohen me ilustrime dhe shpjegime të fjalorit përkatës. Teksti shkollor ShK2K5ShC po ashtu shkëlqen në integrimin ndër-disiplinar, duke përfshirë fushat e letërsisë, shkencave natyrore, shoqërisë dhe mjedisit, jetës dhe punës, edukimit fizik dhe sportit. Ai po ashtu ndërlidhet me tema ndër-kurrikulare siç janë të drejtat e njeriut, shëndeti dhe mjedisi.

Ngjashëm me tekstet e mëparshme, tekstet e leximit që ofrohen janë të përshtatshme për nivelin e klasës dhe plotësohen me ilustrime dhe shpjegime të fjalorit në njësi të caktuara mësimore, si dhe me listë fjalori në fund të tekstit.

Hapja ndër-disiplinare është një aspekt dukshëm i fortë i tekstit shkollor ShK2K3ShA. Tekstet e përzgjedhura në njësitë mësimore janë përzgjedhur me kujdes për të lehtësuar ndërlidhjen dhe integrimin ndërmjet disiplinave. Kjo do të thotë se tekstet e përzgjedhura përfshijnë detyra, ushtrime dhe kërkesa të ndryshme që ndërlidhen me fusha të tilla siç janë artet, shkencat natyrore, shoqëria dhe mjedisi. Detyrat mbulojnë, po ashtu, çështje ndër-kurrikulare, duke përfshirë edukimin për zhvillim të qëndrueshëm, barazinë gjinore, të drejtat e njeriut, shëndetin, edukimin medial dhe shumë aspekte tjera. Ngjashëm, tekstet shkollore ShK1K1ShA dhe ShK1K2ShA synojnë, po ashtu, të integrojnë fusha tjera kurrikulare si shkencat natyrore, shkencat sociale, artet dhe matematika. Kjo qasje mundëson analizën e gjuhës shqipe nga këndvështrime të ndryshme dhe vendos një lidhje me kulturën e nxënësve.

Sa i përket mësimdhënies së diferencuar, ka shembuj të kufizuar në dispozicion. Vetëm një libër është identifikuar se e thekson fuqishëm këtë aspekt. Materialet dhe detyrat e parashtruara në tekstin e gjuhës shqipe ShK3K6ShC janë të përshtatshme për forma të ndryshme të të nxënësve social, duke përfshirë mësimin në klasë/frontal, punën në çift, punën në grupe dhe forma tjera të të nxënësve. Kjo i ofron disa udhëzime për përfshirjen e qasjeve të të nxënësve të diferencuar. Në tekstet shkollore ShK2K2ShH, ShK2K3ShA, dhe ShK4K8ShA, tekstet e përzgjedhura ndërlidhen me aspekte të ndryshme të jetës së përditshme. Këto përfshijnë tekste lidhur me pushimet, udhëtimet, ditëlindjet, pranverën, verën, festat, mjedisin, lulet, ujin, shëndetin, muzikën, teatrin, rregullat, lojërat, kohën e lirë, miqtë, etj. Përveç kësaj, në tekstin shkollor ShK1K2ShA ekziston një ndërlidhje mes autorëve për fëmijë nga tradita letrare e Kosovës dhe atyre nga mbarë bota. Duke i lexuar këto tregime, nxënësit zhvillojnë imagjinatën e tyre dhe krijojnë lidhje midis situatave të ndryshme dhe përvojave të jetës reale.

Disa tekste shkollore shërbejnë si burim i motivimit për të mësuar dhe për të stimuluar kreativitetin. Për shembull, në tekstin shkollor ShK2K2ShH, pjesë specifike si "lexo dhe kupto", "reflekto", "shkruaj", "fjalë të reja", "aktivitete për nxënësit", "mbajë mend", "kujdesi" dhe "pyetje ndihmëse" janë krijuar për ta nxitur zhvillimin e shkathtësive të komunikimit. Aktivitetet e drejtuara nga nxënësit janë përgjithësisht krijuese dhe inkurajojnë punën e pavarur, si p.sh. projekti i përgatitjes së një kalendarit për ditëlindje për shokët e klasës. ShK1K2ShC dhe ShK4K9ShH përmbajnë, po ashtu, detyra që nxisin të nxënësit aktiv dhe të bazuar në kërkim. ShK2K2ShH ofron shembuj të mirë të nxitjes së të menduarit kritik, veçanërisht në pjesët ku nxënësve u kërkohet të shkruajnë. Disa tekste shkollore, si p.sh. ShK1K1ShE, krijojnë ndërlidhje me botën reale. Ky libër ofron lidhje ndërmjet gjuhës dhe leximit letrar përmes teksteve të shkruara nga autorë shqiptarë dhe të huaj, duke përfshirë poezi, përralla dhe tregime që përcjellin mesazhe të rëndësishme për realitetin e fëmijës.

Në disa pjesë të teksteve shkollore ShK2K3ShA dhe ShK2K4ShA, nxënësit inkurajohen të punojnë në mënyrë të pavarur. Disa tekste shkollore, si p.sh. ShK1K1ShE, ofrojnë detyra të shumta që ndihmojnë në zhvillimin e shkathtësive themelore të leximit dhe shkrimit. ShK1K1ShG ofron një përmbajtje të pasur të njësisve mësimore letrare dhe jo-letrare, duke krijuar lidhje logjike që u ndihmojnë mësimdhënësve ta shpjegojnë përmbajtjen në atë mënyrë që ta mbajnë të gjallë interesimin dhe kureshtjen e nxënësve.

Kur flitet për kompleksitetin e strukturës së fjalisë, gjuha e përdorur në tekstet e përzgjedhura ndërlihet edhe me moshën e nxënësve në tekstet shkollore ShK3K6ShC dhe ShK3K6ShE. Tekstet e përzgjedhura të ShK4K8ShA promovojnë drejtpërdrejt edukimin dhe përdorimin e përgjegjshëm të mediave, si dhe inkurajojnë hulumtime të pavarura duke i nxitur nxënësit të kërkojnë në internet dhe të krahasojnë burime të ndryshme. Përveç kësaj, gjuha e përdorur në librin ShK4K8ShA është përgjithësisht e drejtpërdrejtë dhe e përshtatshme për grup-moshën e synuar të nxënësve.

2.1.1.4. Saktësia dhe qasja e gjuhës

Sa i përket saktësisë së gjuhës dhe qasshmërisë, disa libra janë identifikuar se kanë merita të forta. Për shembull, teksti ShK1K1ShA përdor gjuhë që është e përshtatshme dhe lehtësisht e kuptueshme; çdo modul mësimor përfshin një fjalor që sqaron kuptimet e fjalëve të reja dhe të panjohura për nxënësit. Përveç kësaj, modulet mësimore që fokusohen në njohuritë gjuhësore ofrojnë përkufizime të qarta, të drejtpërdrejta dhe rregulla gramatiko-re. Gjuha e përdorur në tekstin shkollor ShK1K1AC i përmbahet rregullave të gramatikës së gjuhës shqipe, ndërsa stili i të shkruarit dhe sintaksa e saj janë lehtësisht të kuptueshme për nxënësit.

2.1.1.5. Cilësia e paraqitjes dhe dizajnit

Lidhur me cilësinë e prezantimit dhe dizajnit, teksti shkollor i gjuhës shqipe ShK2K3ShC shfaq një format të qëndrueshëm, të strukturuar mirë, të shoqëruar me ilustrime estetike të këndshme dhe të përshtatura me kujdes me tekstet e përzgjedhura dhe mesazhet e tyre të synuara.

Të dyja pjesët e tekstit të gjuhës shqipe ShK2K3ShC janë tërheqëse në aspektin vizual dhe të dizajnuara me përpikëri. Tekstet e gjuhës shqipe ShK2K4ShA dhe ShK2K4ShC kanë, po ashtu, një strukturë të qëndrueshme, të qartë, me një dizajn të fuqishëm, ilustrime tërheqëse dhe përafrim të kujdesshëm me tekstet e përzgjedhura dhe mesazhet e tyre të synuara. Për më tepër, teksti shkollor ShK4K8ShA përmban ilustrime tërheqëse dhe të krijuara me kujdes.

Teksti shkollor ShK3K6ShE ka përmbajtje dhe fotografi që nxisin në aspektin vizual interesimin e nxënësve për t'i ruajtur informatat në kujtesën afatgjatë.

2.1.2 Mangësitë në tekstet shkollore të gjuhës shqipe

Në tekstet e gjuhës shqipe janë evidentuar disa mangësi. Ne do t'i analizojmë ato duke u bazuar në kriteret e rishikimit.

2.1.2.1. Bashkërendimi i kurrikulës

Problemi i parë i identifikuar ka të bëjë me strukturën të këtyre teksteve shkollore. Në mënyrë që nxënësit të kenë qasje kognitive në librat që janë destinuar për ta, këto tekste shkollore duhet të kenë një strukturë të qartë, e cila është e lehtë për t'u kuptuar dhe e shpjeguar në fillim të librit. Struktura e qartë duhet të ndiqet vazhdimisht në të gjitha faqet. Përveç kësaj, njësitë/kapitujt mësimorë duhet të jenë të balancuara për sa i përket përmbajtjes së mbuluar dhe rezultateve të të nxënësve.

Në vend të kësaj, më shumë se 60% e teksteve të analizuara të gjuhës shqipe shfaqin mungesë të strukturës së qartë dhe/ose mosbalancim të përmbajtjes së kapitujve/njësive mësimore. Për shembull, librat ShK1K1ShA, ShK1K1ShE, ShK2K5ShC, ShK3K7ShC nuk janë të strukturuar në kapituj dhe për rrjedhojë nuk kanë një model që e ndjekin për ta kuptuar përmbajtjen, gjë që e pengon pamjen e qartë të nxënësve për lëndën që mësohet.

Teksti shkollor ShK1K1ShC nuk i kushton vëmendje shpërndarjes së ekuilibruar të kapitujve; prandaj, disa njësi trajtohen në një numër të madh faqesh, ndërsa të tjerat kanë të ndarë shumë pak hapësirë. Përveç kësaj, tekstit shkollor ShK2K5ShC i mungon organizimi i bazuar në tema ose kapituj, nuk ka organizim sipas shkathtësive të komunikimit dhe nuk tregohet një ndarje e qartë tematike, madje të paktën me një ndryshim në grafikë ose ngjyrë që mund të tregojë një strukturë.

Teksti tjetër shkollor, ShK2K4ShC i ka organizuar kapitujt sipas muajve të vitit shkollor. Ndonëse kjo mund ta lehtësojë planifikimin e mësimdhënësve, një organizim i tillë paraqet rrezik real për theksimin e tepërt në kornizën procedurale për zhvillimin e njësive mësimore brenda muajit, gjë që mund ta minojë nevojën reale për të punuar me nxënësit në arritjen e rezultateve të të nxënësve.

Teksti shkollor ShK1K1ShG, edhe pse në përgjithësi ka përmbajtje të pasur mësimore dhe ofron ndërlidhje ndërmjet letërsisë dhe gramatikës, ai nuk është i strukturuar në kapituj; e njëjta gjë vlen edhe për ShK4K9ShC. Në tekstin shkollor ShK2K3ShC vërehet një shpërndarje jo-proporcionale të numrit të njësive mësimore në raport me kohën e mësimdhënies gjatë muajve të vitit shkollor.

Ne, po ashtu, kemi vërejtur se disa njësi mësimore dhe tekste letrare janë përsëritur nga teksti shkollor për klasën e parë (ShK1K1ShA) në tekstin shkollor për klasën e dytë (ShK1K2ShA) tek i njëjti botues.

Në tekste të caktuara, si p.sh ShK2K2ShH dhe ShK2K4ShA, formulimi i udhëzimeve, organizimi i kapitujve dhe emrat e temave mësimore u dedikohen mësimdhënësve e jo nxënësve. Megjithatë, teksti shkollor duhet t'u dedikohet nxënësve, pasi është ekonomikisht jopraktike të shtypet numri i njëjtë i kopjeve si për nxënësit ashtu edhe për mësimdhënësit. Kjo praktikë duhet të rishikohet në mënyrë që nxënësit të mund të navigojnë në mënyrë të pavarur nëpër tekstin shkollor.

Përveç kësaj, vërehen disa mangësi në mbulimin e kompetencave që rekomandohen me dokumentet e kurrikulës. Çështja kryesore buron nga fakti se qasja funksionale-komunikuese që promovohet nga Korniza e Kurrikulës së Kosovës dhe kurrikula bërthamë nuk është kuptuar mirë nga autorët e teksteve shkollore, duke rezultuar në pasqyrimin sporadik të kësaj qasjeje në tekstet shkollore. Prandaj, zhvillimi i shkathtësive themelore të komunikimit dhe rritja e rrjedhshmërisë në të kuptuarit e leximit në klasat fillore nuk ndiqen në mënyrë konsistente në disa libra, p.sh. ShK1K1ShA, ShK2K5ShC. Përveç kësaj, disa nga tekstet shkollore, p.sh. ShK2K5ShC, ShK3K6ShE, dhe ShK4K9ShC e mbajnë fokusin në komunikimin e ngurtë të rregullave gramatikore, me ushtrime të de-kontekstualizuara që nuk kontribuojnë në zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive komunikuese të nxënësve. Shumica e teksteve shkollore e kanë një ndarje të qartë ndërmjet pjesëve të letërsisë dhe gramatikës, gjë që sjell si pasojë që në pjesën e dytë temat të mos shtjellohen për të nxitur zhvillimin e shkathtësive komunikuese: të lexuarit, të dëgjuarit, të folurit dhe të shkruarit, siç është rasti me librin ShK4K8ShA, por edhe me libra të tjerë.

Shumica e teksteve shkollore nuk i ndërtojnë mjaftueshëm vlerat dhe qëndrimet e parapara në kurrikulë. Zhvillimin e vlerave dhe qëndrimeve duket se nuk trajtohet në disa tekste të gjuhës shqipe, për shembull në ShK1K1ShA, dhe ShK3K7ShC.

Teksti shkollor për gjuhën shqipe për klasën e 7-të (ShK3K7AC), i cili duket se është shkruar në një kohë shumë të shkurtër, nuk përputhet ngushtë me parimet dhe qëllimet e përgjithshme të kurrikulës. Atij i mungojnë rubrikat e pyetjeve, detyrave, ushtrimeve, detyrave të shtëpisë, si dhe fjalori.

2.1.2.2. Saktësia e përmbajtjes

Sa i përket mbulimit të balancuar të temave të përcaktuara me kurrikulë, janë evidentuar shumë mangësi. Kështu, njësitë mësimore nuk synojnë t'i arrijnë të gjitha rezultatet e kurrikulës në mënyrë të ekuilibruar dhe nuk përqendrohen shumë në zhvillimin e shkathtësive të folurit dhe të lexuarit, p.sh. ShK1K1ShC, edhe pse këto shkathtësi janë thelbësore për nxënësit e klasës së parë. Temat që ndërlidhen me komunikimin funksional siç janë: atributet personale (dëshirat, shqetësimet, ambiciet); të shkruarit e llojeve të ndryshme të letrave (ftesa, porosi, njoftime, etj.), dhe komunikimi nëpërmjet mediave: radio, TV, revista për fëmijë etj. Mungojnë në tekstet shkollore ShK2K4ShA, ShK2K2ShH, dhe ShK2K3ShA, ndërsa në disa tekste të tjera janë të përfshira në mënyrë të pamjaftueshme.

Disa rekomandime në lidhje me koherencën dhe logjikën e shpërndarjes së përmbajtjes referojuni kronologjisë së shkronjave për ShK1K1ShD ose rëndësisë së fjalorit për nevojat e nxënësve në ShK1K1ShD. Disa gabime shkencore janë identifikuar në tekstin shkollor ShK3K6ShC për sa i përket mbiemrave emërorë.

Sa i përket përmbajtjes së duhur, po ashtu janë evidentuar disa mangësi. Disa tekste të gjuhës shqipe p.sh. ShK1K1ShC, nuk e reflektojnë traditën dhe kulturën kosovare fare. Në tekstin e ilustruar, vetëm në dy raste përmendet emri i Kosovës në drejtshkrimin e emrave, por nuk paraqiten elemente të tjera kosovare. Lidhur me aspektet kulturore, recensentët, po ashtu, kanë theksuar se tekstet e shkruara nga ekipe të përziera nga Kosova dhe

Shqipëria i sjellin vlerë të shtuar tërë projektit, por këto tekste duhet ta adresojnë kohën e ngjarjeve dhe planifikimin sipas kalendarit shkollor në Kosovë, si dhe specifikat e gjuhës që flitet në Kosovë.

Në përgjithësi, tekstet shkollore kanë karakter etik, moral dhe jo-diskriminues. Megjithatë, kjo nuk ndodh me të gjitha tekstet shkollore. Kështu, në tekstin shkollor ShK3K6ShH, në disa tema, ka përmbajtje diskriminuese në shprehjet gjuhësore dhe në ilustrime të papërshtatshme. Në disa njësi mësimore të tekstit shkollor ShK3K6ShC vërehet se ka diskriminim gjinor, se të dyja gjinitë nuk paraqiten në mënyrë të barabartë dhe sidomos – paradoksalisht – në njësinë mësimore “Vajzat dhe djemtë”. Teksti shkollor ShK1K2ShA nuk paraqet raste të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe fëmijëve të racave dhe etnive të ndryshme nga e gjithë bota për ta integruar më tej parimin e përfshirjes siç përcaktohet në dokumentet e kurrikulës. Ka shembuj joadekuat, përmes të cilëve nxënësve mund t’u transmetohen mesazhe joadekuate në mënyrë indirekte, e që mund të interpretohen si diskriminuese varësisht nga qasja e mësimdhënësit në ShK4K8ShA.

Çështja e mbingarkesës është e lidhur ngushtë me qasjen didaktike që përdoret në tekstet shkollore. Sigurimi i përshtatshmërisë së moshës është vështirë të arrihet për disa tekste shkollore. Kështu, terminologjia e përdorur në disa njësi mësimore nuk përputhet me moshën e fëmijëve dhe shpjegimi i kuptimit të tyre nuk sqarohet, edhe kur përfshihen fjalorët, si p.sh. në ShK1K2ShC. Siç u përmend më herët, në disa raste, gjatësia e fjalisë e tejkalon standardin optimal për lexuesit e klasës së tretë, si p.sh. ShK2K3ShA, ose për nxënësit e klasës së katërt, si p.sh. ShK2K4ShC. Në tekstet shkollore të klasës 9 (ShK4K9ShC dhe ShK4K9ShH), niveli i gjuhës është shpesh i papërshtatshëm për grup-moshën përkatëse dhe terminologjia është më afër gjuhës që synon një audiencë studentësh të universitetit. Përveç kësaj, në njësitë mësimore ofrohet pak material shpjegues, kështu që temat e trajtuara mund të mos u janë shpjeguar mjaftueshëm nxënësve.

Një çështje madhore është vlerësimi. Shumë tekste shkollore dështojnë të përfshijnë detyrat e vlerësimit tradicional dhe alternativ dhe të ofrojnë vlerësim formativ dhe sumativ. Në shumicën dërrmuese të teksteve mungojnë detyrat alternative të vlerësimit, vlerësimi i bazuar në projekte dhe vlerësimet e bazuara në tekste të përzgjedhura për analizë në pamje të parë.

Disa tekste shkollore nuk përfshijnë as vlerësime tradicionale apo alternative, për shembull ShK3K7ShC. Në përgjithësi, vlerësimi kufizohet në memorizimin e fakteve dhe procedurave të tekstit që ndërlidhen me personazhet, strofat e poezive ose paragrafët e tregimeve, vendin, rregullat gramatikore etj. si p.sh. ShK1K1ShG, ShK2K3ShC, ShK2K4ShC, ShK2K5ShC, ShK2K4ShA. Shembujt e detyrave të vlerësimit në përgjithësi janë përsëritëse, fokusohen në shkathtësinë themelore dhe kërkojnë riprodhimin e njohurive, si p.sh. ShK1K1ShA, ShK1K1ShC, ShK2K2ShH, ShK1K2ShA, dhe ShK1K1ShD.

Po ashtu, teksti shkollor ShK3K7ShC nuk e përfshin vlerësimin formativ dhe sumativ, nuk e inkurajon të menduarit e nivelit më të lartë dhe nuk e stimulon të nxënësve aktiv dhe të bazuar në hulumtim.

2.1.2.3. Efektiviteti i strategjive të të nxënit

Kopertinat e disa teksteve shkollore të gjuhës shqipe, si p.sh ShK2K3ShA nuk janë të përshtatshme për moshën e nxënësve. Kopertinat e ShK3K6ShC nuk janë kreative, nuk i motivojnë nxënësit për të mësuar; shkrimi në kopertinë është në mospërputhje me përmbajtjen dhe ilustrimet, përmbajtja dhe ilustrimet janë për moshat më të reja, ndërsa kopertina është për moshat më të mëdha.

Hapja ndër-disiplinare dhe ndërlidhja me botën reale nuk shihen si relevante në disa tekste shkollore. Shumica e teksteve shkollore kanë mungesë të integritetit të TIK-ut në procesin mësimor; të udhëzimit të nxënësve për të kërkuar në internet për të gjetur informata të ndryshme arsimore, ose dhënia e udhëzimeve për të realizuar projekte duke përdorur TIK-un për nevoja arsimore është rrallë e pranishme në ShK3K7ShC ose ShK4K9ShC. Tekstet e klasës 9 në masë të madhe dështojnë të ndërlidhen me jetën e përditshme të nxënësve; përmbajtja multimediale nuk merret si përparësi për ta bërë përmbajtjen më interaktive dhe me nxënësin në qendër. Po ashtu, teksti shkollor ShK3K6ShE nuk u sugjeron nxënësve të kërkojnë/hulumtojnë në internet për materiale mësimore shtesë, duke e integruar TIK-un në mësimdhënie dhe nxënie.

Nuk ka shembuj të vlerësimit sumativ në ShK1K1ShA, ShK1K1ShE, ShK1K1ShG, ose ShK3K7ShC dhe kjo ndërlidhet me strukturën e librit dhe mungesën e ndarjes së njësive mësimore, sepse kapituj të veçantë do të çonin në realizimin e vlerësimit sumativ në fund. Recensentët nuk kanë identifikuar shembuj të vlerësimit sumativ që do t'u ndihmonin nxënësve në zhvillimin e njohurive në ShK1K1ShE, dhe ShK1K1ShE. Në tekstin shkollor ShK1K1ShG qasjet lidhur me vlerësimin e progresit të nxënësve reflektohen kryesisht në lidhje me njohuritë gjuhësore.

Kur janë të pranishme detyrat e vlerësimit formativ, ato përmbajnë, në një masë të konsiderueshme, më shumë shembuj të detyrave të vlerësimit tradicional sesa alternativ. Ka një tendencë që të shfaqen më shumë shembuj që kanë të bëjnë vetëm me memorizimin e fakteve dhe procedurave, si p.sh. në ShK3K7ShC.

Tekstet shkollore të analizuara gjuhës shqipe rrallë e promovojnë të nxënit e diferencuar. Nuk përfshihen mundësitë për angazhimin e nxënësve me nivele të ndryshme të shkathtësive. Aktivitetet e punës në grupe, bashkëpunimi i nxënësve në detyra dhe angazhimet në klasë nuk udhëhiqen mirë, ose thjesht nuk jepen udhëzimet e duhura. Kjo vërehet si mangësi në ShK1K1ShD, ShK2K3ShA, dhe ShK3K7ShC. Shumica e teksteve shkollore, për shembull, ShK3K6ShH dhe ShK3K7ShC nuk përmbajnë materiale dhe detyra të niveleve të ndryshme, për sa i përket kërkesave dhe vështirësive me të cilat përballen nxënësit. Disa tekste shkollore, si p.sh ShK2K4ShC, me gjithë përpjekjen për ta kapërcyer qasjen tradicionale, nuk e përcaktojnë qartë fokusin e punës së nxënësit dhe rendin logjik dhe përmbajtësor të asaj që synohet të arrihet brenda një kohe të caktuar mësimore. Teksti shkollor gjuha shqipe 7 ShK3K7ShC nuk është i përshtatshëm për përpunimin e të nxënit të diferencuar (të nxënit në klasë/frontal, punë në çifte, punë në grupe); ky tekst nuk e mundëson dhe nuk e nxit të nxënit e pavarur, për shkak të mungesës së detyrave, sugjerimeve dhe pyetjeve të niveleve të ndryshme.

Ka mungesë të pyetjeve dhe detyrave që nxisin të menduarit kritik, punën e pavarur të nxënësve, zhvillimin e aftësive të buta, etj. në ShK1K2ShC, kërkesave përtej përmbajtjes së mësimave, siç janë kërkesat që ndërlidhen me arsyetimin, të menduarit kritik të nxënësve, kërkesat për të nxitur reflektimin mbi të nxënit dhe të nxënit vetë-drejtues, etj.

Duket se vetëm disa tekste shkollore e kanë parasysh motivimin e të nxënit dhe stimulimin e kreativitetit. Po ashtu, sa i përket inkurajimit të menduarit të rendit më të lartë dhe stimulimit të mësuarit aktiv dhe të bazuar në kërkim, pak është bërë në tekstet shkollore aktuale. Një pjesë relativisht e madhe e kërkesave për nxënësit brenda rubrikave specifike (bisedo, mendimi i juaj, krijo dhe diskuto, mëso më shumë, ushtrimet, aktiviteti i juaj, etj.), janë të ndërlidhura me memorizimin e përmbajtjes në ShK2K5ShC. Paraqitja e detyrave në tekst nuk i stimulon ndjeshëm nxënësit që të bëhen nxënës të pavarur dhe të gjejnë burime të ndryshme informacioni në ShK3K6ShE.

Në përgjithësi, teksti përmban një numër të vogël detyrash që stimulojnë të menduarit kritik dhe krijues të nxënësve. Në një masë të madhe, në ShK1K1ShA detyrat fokusohen në zhvillimin e shkathtësive themelore të nxënësit dhe nuk përfshijnë shembuj të detyrave të të menduarit kritik ose përparimit drejt kompleksitetit. Formulimi i pyetjeve dhe detyrave në tekstin shkollore ShK3K6ShE nuk u ndihmon shumë nxënësve ta zhvillojnë shprehinë e të menduarit dhe kreativitetit të nivelit më të lartë. Janë të rralla ushtrimet dhe detyrat që nxisin mendimin kritik dhe punën e pavarur të nxënësve në ShK4K8ShA; interpretimi i letërsisë është një rast ideal për inkurajimin e të menduarit kritik dhe pranimin e këndvështrimeve të ndryshme, por fatkeqësisht, ka raste kur krijimtaria mbytet dhe përforcohet toni moralizues në këtë libër.

Rubrikat e pjesës kryesore të aparatit didaktik (lexo dhe kupto, reflekto, shkruaj, fjalë të reja, aktivitet për nxënësit, mbaj mend, etj.) të përdorura në ShK1K1ShD mund të ishin një mundësi e mirë për të parë sesi nxënësit reagojnë ndaj këtyre rubrikave në pjesën e vlerësimit. Megjithatë, përsëritja e pyetjeve me të njëjtën qasje jo kreative (p.sh. listoni fjali përmbledhëse, shkruani pesë fjali, shkruani dy cilësi, etj.) e redukton në masë të madhe hapësirën për ta stimuluar iniciativën, mendimet, krijimet, ndërtimin e pyetjeve nga vetë nxënësit, etj. Në tekstet shkollore ShK1K1ShG, ShK2K2ShH dhe ShK2K4ShC mungojnë kërkesat që inkurajojnë të menduarit kritik dhe punën e pavarur të nxënësve, kërkesat që ndërlidhen me arsyetimin, si dhe kërkesat për të nxënit vetë-drejtues. Kërkesat përtej përmbajtjes së njësive mësimore rrallë janë të përfshira, nuk ka kërkesa që ndërlidhen me arsyetimin dhe mendimin kritik të nxënësve, si dhe kërkesat për ta nxitur reflektimin mbi të nxënit dhe të nxënit vetë-drejtues.

Në shumë tekste shkollore, njësitë mësimore vazhdojnë me të njëjtën filozofi të përmbajtjes së thatë teorike pa shembuj të gjallë për ta rritur të kuptuarit e nxënësve dhe ndjeshmërinë e tyre ndaj letërsisë, si në ShK3K7ShC. Teksti, në thelb, nuk përcjell emocione dhe ndjeshmëri tek nxënësit ShK1K1ShD. Nxënësit nuk arrijnë të kuptojnë se narratori dhe folësi lirik janë konstruksione fiktive brenda tekstit letrar dhe ngatërrimi me autorin dhe qëllimet e tij/saj mund t'i shtyjë nxënësit ta lexojnë letërsinë si predikim ideologjik. Ngjashëm, në pjesën e gjuhës, koncepti i stilit trajtohet në një mënyrë të ngurtë dhe memorizuese, si p.sh. në ShK3K6ShH ose ShK4K8ShA. Teksti shpjegues dominon në krahasim me fragmentet nga letërsia apo ilustrimet dhe përmbajtjet multimediale, gjë që e bën tekstin shumë teorik dhe ndonjëherë të pa qasshëm për nxënësit, si p.sh. në disa pjesë të ShK4K9ShC. Rrëfimet dhe rrëfimet personale nuk janë të pranishme për ta nxitur kureshtjen e nxënësve kërkues. Në të dy tekstet shkollore të klasës së 9-të ShK4K9ShC dhe ShK4K9ShH, disa koncepte elementare të studimit letrar e nxisin mësimin mekanik dhe nuk e mundësojnë kreativitetin e interpretimit letrar. E njëjta gjë ndodh edhe për disa tekste shkollore të klasave të ulëta. Përderisa kurrikula lëndore e klasës së dytë parasheh arritjen e rezultatit të synuar "të dallojë leximin-të kuptuarit nga leximi mekanik", tekstet vazhdojnë t'i udhëzojnë nxënësit të mësojnë përmendsh në një masë të madhe, p.sh. në ShK1K1ShA, ShK1K2ShA. Shumica dërrmuese e detyrave janë përsëritëse dhe i trajtojnë vetëm nivelet themelore të njohjes së koncepteve dhe praktikimit të ushtrimeve standarde, dhe rrallë përfshijnë shembuj që nxisin të menduarit kritik tek nxënësit.

Materiali për lexim që ofrohet në ShK1K1ShD, i përshtatur dhe i përkthyer nga autorë të huaj, përfshin disa tekste që u japin nxënësve fakte dhe informata, por nuk ngjallin emocione dhe kureshtje, dhe disa prej tyre nuk përçojnë një mesazh qartësisht të identifikueshëm për nxënësit.

Një çështje tjetër me rëndësi është mbingarkesa në tekstet shkollore. Disa tekste shkollore përmbajnë sasi të madhe të informatave, duke e bërë sfiduese për nxënësit që t'i kuptojnë dhe t'i ruajnë shkathtësitë gjuhësore që mësohen, gjë që mund të jetë e dëmshme për të nxënësit efektiv. Ngarkesa në këto tekste shkollore i referohet vëllimit dhe kompleksitetit të materialit që nxënësit duhet ta mësojnë dhe zotërojnë. Për shembull, ka një disproporcion midis numrit të koncepteve/detyrave/faqeve dhe kohës së mësimdhënies në dispozicion për lëndën e gjuhës shqipe në klasën e 4-të ShK2K4ShC, përkatësisht në klasën 5-të ShK2K5ShC. Çështja e mbingarkesës duhet të trajtohet, veçanërisht pasi barra mbi nxënësit vjen nga përsëritja e shpeshtë e disa detyrave të punës. Në një numër të konsiderueshëm të njësive mësimore, ka shumë pyetje, detyra, fragmente leximi, pyetje të të kuptuarit, rregulla gramatikore, lista të fjalorit, ushtrime me shkrim dhe aktivitete tjera që synojnë zhvillimin e shkathtësive gjuhësore, të cilat nuk janë të përshtatshme për kohën e të nxënësit. Barra mbështetet me shumë në detyrat që ndërlidhen me sistemin gjuhësor, ku nxënësve u kërkohet të mësojnë përmendësh rregullat dhe procedurat pa e vendosur gramatikën në kontekste komunikimi të jetës reale. Fjalitë e gjata, të ndërtuara me më shumë se 20 fjalë deri në 60 fjalë krijojnë vështirësi për të kuptuarit logjik të nxënësve në tekstin e klasës së 4-të ShK2K4ShC, por edhe në tekstet tjera shkollore. Mbingarkesa e përmbajtjes mbi moshën e nxënësve është evidentuar veçanërisht në temat që lidhen me morfologjinë dhe sintaksën, për shembull, për nxënësit e klasës së gjashtë, si në rastin e tekstit shkollor ShK3K6ShH. Mbingarkesa e nxënësve krijohet nga ushtrimet e përsëritura ose të njëjtat pyetje rreth teksteve të përzgjedhura, si në rastin e ShK2K3ShA.

2.1.2.4. Saktësia dhe qasja e gjuhës

Shumë tekste shkollore kanë telashe me saktësinë dhe qasjen e gjuhës. Për shembull, ShK1K2MF përmban gabime drejtshkimore, zgjedhje të gabuara të foljeve, përdorim të fjalëve jo standarde dhe gabime të tjera. Përveç kësaj, ka edhe gabime tipografike. Në tekstin shkollor ShK2K4MB, numri i faqeve në tabelën e përmbajtjes nuk përputhet me numrin aktual të faqeve në libër. Për më tepër, ka gabime teknike në shumë detyra, si dhe gabime drejtshkimore dhe tipografike në ShK2K4MB. Teksti shkollor ShK2K4MC ka një numër të konsiderueshëm gabimesh, potencialisht të natyrës teknike, të cilat duhet të korrigjohen gjatë procesit të rishikimit. Për fund, përdorimi i fjalorit shpjegues dhe elementeve grafike për të ndihmuar të kuptuarit është i kufizuar në ShK1K2MC. Fjalori në librin ShK4K8MA vuan nga disa mangësi dhe pasaktësi sa i përket koncepteve që synon t'i sqarojë ose t'i përcaktojë. Ne do të rekomandonim rishikimin e tij bazuar në përkufizimet ose sqarimet origjinale nga burime të besueshme.

2.1.1.5. Cilësia e paraqitjes dhe dizajnit

Shumë tekste shkollore i paraqesin në mënyrë jo adekuate, jo-funksionale dhe jo tërheqëse ilustrimet për nxënësit. Në ShK3K7MC, disa shembuj, foto dhe vizatime nuk përputhen me temat e diskutuara (veçanërisht kopertinat e kapitujve) dhe u mungon cilësia e lartë, gjë që nuk u ndihmon nxënësve ta kuptojnë më mirë përmbajtjen. ShK2K5MC përmban një numër adekuat të ilustrimeve grafike brenda tekstit, por mungojnë fotografitë origjinale që ndërlidhen me detyrat, të cilat duhet të jenë më të gjera duke marrë parasysh moshën e nxënësve.

Përveç kësaj, ilustrimet e paraqitura në hyrjet e shumicës së kapitujve nuk ndërlidhen drejtpërdrejt me përmbajtjen që do të diskutohet në ShK4K8MC. Për më tepër, në disa njësi mësimore, figurat nuk janë paraqitur qartë, me vija shumë të holla, veçanërisht në kapitullin Trekëndëshi dhe Katërkëndëshi. Kjo e bën të vështirë për nxënësit t'i kuptojnë konceptet, e lëre më të angazhohen në zgjidhjen e detyrave.

Gjithashtu, në disa njësi të ShK3K6MC, dizajni është i papërshtatshëm pasi që madhësia e shkronjave është shumë e vogël në shembuj të caktuar. Përveç kësaj, disa nga ilustrimet dhe fotot nuk janë mjaftueshëm të ndërlidhura me tekstin, duke ua bërë të vështirë nxënësve ta kuptojnë përmbajtjen. Mungojnë ilustrimet në të gjithë tekstin, si dhe mungojnë fotografitë origjinale në lidhje me detyrat, të cilat duhet të jenë më të bollshme duke marrë parasysh moshën e nxënësve, si në ShK2K4MB.

2.2. Përparësitë dhe mangësitë në tekstet shkollore të matematikës në arsimin e obligueshëm

2.2.1 Përparësitë në tekstet shkollore të matematikës

Analiza e teksteve shkollore të matematikës ka nxjerrë në pah edhe disa pika të forta, të cilat shkurtimisht përmendën në vijim, duke u bazuar në kriteret e vlerësimit.

2.2.1.1. Bashkërendimi i kurrikulës

Recensentët teksteve të matematikës i kanë identifikuar një varg përparësish në këto tekste shkollore. Disa nga këto përparësi kanë të bëjnë me strukturën e teksteve shkollore. Teksti shkollor ShK1K2MF është organizuar në njësi të qarta mësimore dhe të balancuara. Në këtë tekst shkollor, përmbajtja mësimore klasifikohet në: kujto, mëso, praktikë, eksploro, zgjidh probleme dhe argëtohu. Në fund të disa kapitujve ose temave mësimore, teksti ofron projekte shtesë për të nxitur kreativitetin dhe zbatimin praktik të njohurive të fituara. Përveç kësaj, ky tekst shkollor adopton qasjen konkrete-vizuale-abstrakte, e cila gjendet në tekstet shkollore të Singaporit, një vend që shquhet në testet PISA dhe TIMSS.

Njësitë mësimore e ruajnë konsistencën në strukturë dhe dizajn në ShK2K3MF, si dhe i adresojnë kompetencat specifike që përcaktohen në kurrikulën e klasës së tretë të matematikës. Tekstet shkollore të klasës së tetë ShK4K8MA dhe ShK4K8MA janë, po ashtu, të qëndrueshme në strukturë dhe dizajn. Teksti shkollor ShK3K7MC ndahet në dhjetë kapituj/tema dhe njësitë mësimore rrjedhin nga çdo temë sipas shtrirjes logjike të tyre. Shpërndarja e përmbajtjes mësimore përputhet me qëllimin e çdo njësie mësimore në ShK4K9MH dhe ShK4K9MC.

Disa tekste shkollore janë identifikuar se kanë një fokus të fuqishëm në zhvillimin e kompetencave që rekomandohen me kurrikulë. Për shembull, në të dy tekstet shkollore ShK2K4MA dhe ShK2K5MA, njësitë mësimore përqendrohen në zhvillimin e kompetencave specifike të cekura në kurrikulën bërthamë dhe në kurrikulën e lëndës, të cilat janë të shpërndara në mënyrë të balancuar. Njësitë mësimore në ShK4K8MC synojnë në mënyrë konsistente arritjen e kompetencave specifike që adresohen në kurrikulën e lëndës së matematikës për klasën e tetë.

Përmbajtjet e tekstit shkollor të matematikës për klasën e 8-të ShK4K8MA përputhen plotësisht me kurrikulën dhe shpërndarja e përmbajtjes mësimore korrespondon me fokusin specifik të rezultateve të të nxënësve. Tekstet shkollore të matematikës ShK4K9MC dhe ShK4K9MH në përgjithësi janë të organizuara mirë dhe u ndihmojnë nxënësve t'i konsolidojnë konceptet bazë të matematikës. Përmbajtja e tyre është në përputhje me përmbajtjet e paraqitura në kurrikulën e lëndës. Megjithatë, ka disa ndryshime, krahasuar me kurrikulën e lëndës, në emërtimin e titujve të njësive mësimore në ShK4K9MH, por ato nuk ndikojnë në përmbajtje; përkundrazi, i shtojnë më shumë koherencë konstruktiv didaktik. Në tekstet shkollore ShK1K2MC dhe ShK2K4MC, njësitë mësimore fokusohen mjaftueshëm në zhvillimin e kompetencave specifike që përmenden në kurrikulën bërthamë dhe atë lëndore.

2.2.1.2. Saktësia e përmbajtjes

Tekstet shkollore ShK1K2MA, ShK2K3MF, ShK2K4MB, ShK2K5MA, ShK3K6MC, ShK3K7MC dhe ShK4K9MC, të gjitha, i kanë përparësitë për të siguruar përshtatshmërinë e moshës. Këto tekste shkollore paraqesin njohuritë në një nivel të përshtatshëm të të kuptuarit të nxënësve dhe gjuha e përdorur është përgjithësisht e qartë dhe e zgjedhur mirë për grup-moshën përkatëse. Gjuha në ShK2K5MC është e qartë dhe e përshtatshme për moshën e nxënësve. Gjuha e përdorur në ShK4K8MC, ShK4K8MA dhe ShK4K9MH është e thjeshtë dhe e përshtatshme për grup-moshën përkatëse dhe nuk ka asnjë paragjykim. Disa tekste shkollore janë vlerësuar për pikat e tyre të forta në koherencë dhe paraqitje logjike të përmbajtjes. Prandaj, njësitë mësimore në ShK2K4MA janë të lidhura logjikisht me njëra-tjetrën dhe përmbajtja brenda secilës njësi është koherente, duke mundësuar shtjellimin e vazhdueshëm me shembuj, detyra dhe ushtrime. Një rrjedhë logjike është gjithashtu e dukshme në ShK3K6MC e krijuar ndërmjet njësive mësimore dhe njohurive të mëparshme të nxënësve. Njësitë mësimore në ShK3K6MC, ShK3K7MC dhe ShK4K8MC përfshijnë një varg ushtrimesh dhe detyrash, duke u mundësuar nxënësve t'i praktikojnë shkathtësitë thelbësore, t'i konsolidojnë shkathtësitë themelore dhe të sigurojnë zhvillimin intelektual. Detyrat e paraqitura përfshijnë sugjerime për zgjidhje që e lehtësojnë të kuptuarit e nxënësve. Disa tekste shkollore, si p.sh. ShK1K2MC dhe ShK1K2MF, dallohen për ofrimin e një kapitulli hyrës të qëndrueshëm në fillim të librit, duke siguruar që nxënësve të mund t'i kujtojnë njohuritë e tyre të mëparshme. Kapituj të tillë lehtësojnë tranzicionin e nxënësve drejt njohurive të reja. Një nga përparësitë e tekstit shkollor ShK3K7MC është se shpesh i referohet njohurive matematikore nga klasa e mëparshme, duke ndihmuar në qëndrueshmërinë e njohurive matematikore dhe duke e lidhur atë me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Që në fillim, në hyrje të tekstit shkollor ShK4K9MH, janë paraqitur rubrikat e librit, të cilat ofrojnë udhëzime për qasje në materialet mësimore. Kjo e lehtëson punën e nxënësve duke i orientuar drejt arritjes së objektivave të njësive mësimore. Tekstet shkollore ShK1K2MC, ShK1K2MA dhe ShK1K2MF demonstrojnë saktësi në përmbajtjen e tyre shkencore.

Një pikë e fortë është identifikuar në librat ShK2K3MF, ShK2K5MA, ShK2K5MC për sa i përket mënyrës se si ato e portretizojnë kulturën dhe traditat vendore në Kosovë.

Tekstet shkollore ShK1K2MC, ShK2K5MA, ShK3K6MC, ShK3K7MC, ShK2K5MC, ShK4K8MC dhe ShK4K9MC nuk përmbajnë asnjë vërejtje diskriminuese në baza gjinore, racore, fetare ose status social.

2.2.1.3. Efektiviteti i strategjive të të nxënit

Disa tekste shkëlqejnë në përfshirjen e qasjeve ndër-disiplinare. Një shembull i tillë është teksti shkollor ShK1K2MA, i cili përfshin elemente nga fusha të ndryshme, duke lidhur matematikën me aplikimet e botës reale. Tekstet shkollore ShK2K4MA dhe ShK2K4MB po ashtu përfshijnë perspektiva ndër-disiplinare në një numër të madh njësish mësimore. Përveç kësaj, tekstet shkollore ShK2K5MA dhe ShK2K5MC u ofrojnë nxënësve burime të ndryshme informatash në lidhje me temat matematikore. Për më tepër, teksti shkollor ShK4K9MH e nxitë motivimin e nxënësve duke e filluar çdo njësi mësimore me fjalë kyçe dhe një ngjarje të rëndësishme historike ose komente të tjera përkatëse, duke i inkurajuar nxënësit që të hulumtojnë më tutje në burime të tjera. Në tekstin shkollor ShK4K9MH, duke ndjekur sekuencën "Përsëritje", ofrohet një detyrë hulumtuese që ndërlidhet drejtpërdrejt me përvojat reale të nxënësve. Këto detyra hulumtuese, të cilat mund të përfshijnë punën në projekt, shqyrtojnë temat e mësuara si dhe çështjet në mjedisin e nxënësve siç janë ndotja dhe siguria. Njësitë mësimore të ShK2K5MA, ShK2K4MB dhe ShK2K5MC inkorporojnë strategji të vlerësimit që fokusohen në kompetencat e rekomanduara. Këto tekste shkollore përmblyen me një numër të konsiderueshëm ushtrimesh, duke përfshirë pyetje dhe aktivitete për zgjidhjen e problemeve, në mënyrë që të arrihen këto kompetenca. Tekstet shkollore ShK3K6MC dhe ShK3K7MC promovojnë pavarësinë e nxënësve duke ofruar ushtrime të shumta, ku çdo njësi mësimore përfundon me detyra të pavarura. Përveç kësaj, libri i punës që i shoqëron këto tekste shkollore përfshin teste për t'u ndihmuar nxënësve ta vlerësojnë të kuptuarit e tyre për njësitë e kaluara dhe t'i identifikojnë fushat për përmirësim.

Edhe pse ekziston një numër të konsiderueshëm i ushtrimeve dhe detyrave në fund të çdo njësie mësimore, ende ka hapësirë për përmirësime në ShK2K4MB. Teksti shkollor ShK2K4MC përfshin edhe ushtrime të kontrollit të matematikës 4, të cilat nuk u jepen nxënësve drejtpërdrejt, por përdoren për ta vlerësuar të kuptuarit e tyre pas çdo njësie mësimore, duke e lehtësuar kështu vlerësimin e nxënësve.

Përveç kësaj, teksti shkollor ShK4K9MC përfshin detyra për punë të pavarur në fund të çdo njësie mësimore. Këto detyra mund të përdoren nga mësimdhënësi për të krijuar një mikro-test për vlerësim tematik. Ngjashëm, teksti shkollor ShK4K9MH përmban një pjesë të quajtur "Çfarë mësuam" në fund të çdo njësie mësimore. Kjo pjesë përmban një përmbledhje të rezultateve të të nxënit, si dhe një komponent vlerësimi ose testi.

Tekste të caktuara të matematikës, si p.sh. ShK1K2MA dhe ShK1K2MF, e inkurajojnë zhvillimin e kreativitetit, të menduarit kritik dhe shkathtësive të arsyetimit logjik. Këto tekste shkollore synojnë t'i angazhojnë nxënësit në këto procese të rëndësishme kognitive. Kështu, teksti shkollor ShK3K7MC e promovon pavarësinë e nxënësve duke ofruar një varg detyrash për punë të pavarur. Këto detyra u ndihmojnë nxënësve ta përforcojnë të kuptuarit e tyre për materialin që e kanë mësuar dhe t'i identifikojnë fushat ku nevojitet punë e mëtejshme.

Në tekstin shkollor ShK2K5MA, përfshirja e rubrikave, siç janë "Detyrë për ty", "Hapësirë për ty", "Përpiku ta krijosh një detyrë të ngjashme me shokun/shokët" dhe "A e keni ditur se" i inkurajon nxënësit të përfshihen në të menduarit e nivelit më të lartë. Ngjashëm, teksti shkollor ShK2K5MC përfshin pjesë të titulluara "Sfiduese" dhe "Të menduarit kritik" për t'i inkurajuar nxënësit të mendojnë në një nivel më të lartë, megjithëse në masë të kufizuar. Për sa i përket efektivitetit të strategjive të të nxënës, disa nga tekstet shkollore janë të organizuara mirë për ta promovuar përparimin nga e thjeshta në komplekse. Kështu, detyrat mësimore në të dyja pjesët e ShK2K4MC ndjekin kryesisht karakteristikat e të nxënës racional dhe logjik. Zakonisht fillon me shpjegime përshkruese, duke filluar me shembuj më të thjeshtë dhe duke kaluar në detyra më të vështira.

Libri ShK2K4MA është i strukturuar me pjesë të ndryshme që ia shtojnë aktraktivitetin dhe praktikitetin e tij. Detyrat janë të grupuar nën emra, siç janë "Detyrë" dhe "Pyetje", "Jep përgjigje", "Punoni së bashku", "Testoni veten", të cilat jo vetëm që e bëjnë librin më interesant, por edhe më të lehtë për t'u përdorur. Përveç kësaj, në libër është përfshirë një pjesë "Diskutim", i cili është pritur pozitivisht, megjithëse sugjerohet që më shumë pjesë të këtilla të përfshihen në këtë libër.

Përdorimi i rubrikave të ndryshme, siç janë: mëso, ushtro, argëtohu, përsërit, apliko dhe vlerëso, së bashku me ilustrime unike me ngjyra, ndihmon në të kuptuarit e përmbajtjes, tërheq vëmendjen e nxënësve dhe ofron një përvojë të larmishme mësimore në ShK1K2MC. Në tekstin shkollor ShK2K4MB, detyrat hartohen në përputhje me parimet e të mësuarit racional dhe logjik. Materiali fillon me shpjegime përshkruese dhe kalon nga shembujt më të thjeshtë në më të vështirë, me theks në elementët kyçe të njësive mësimore.

Disa tekste shkollore shkëlqejnë në krijimin e lidhjeve me botën reale. Për shembull, ShK1K2MC përfshin elemente ndër-disiplinare dhe situata të jetës reale, duke e nxitur integrimin e matematikës me fushat tjera dhe jetën e përditshme. ShK1K2MA fokusohet në zhvillimin e strategjive për zgjidhjen e problemeve kontekstuale, duke siguruar një lidhje me botën e jashtme. Ndërlidhja me botën reale përfaqëson një element të fortë për ShK2K5MA, veçanërisht në disa detyra, të cilat shoqërohen me ilustrime dhe fotografi nga bota reale.

Teksti shkollor i klasës së katërt, ShK2K4MC, është identifikuar si veçanërisht efektiv në promovimin e të nxënës të diferencuar, që është një gjë e rrallë. Në kuadër të këtij teksti shkollor, detyrat mësimore të ofruara e lehtësojnë shumë të nxënës të diferencuar.

2.2.1.4. Saktësia dhe qasja e gjuhës

Disa tekste shkollore të matematikës janë shquar për saktësinë dhe qasjen e gjuhës. Prandaj, teksti ShK1K2MC është shkruar në një mënyrë që është e përshtatshme për nxënësit e klasës së dytë. Tekstet shkollore ShK2K4MA dhe ShK2K5MA janë të shkruara në gjuhë të saktë shqipe, duke iu përmbajtur standardeve të gjuhës shqipe pa asnjë gabim shtypi apo gabim gjuhësor. Ka shumë pak gabime gjuhësore, tipografike ose në aspekte të tjera gjuhësore në ShK2K4MC. Stili dhe sintaksa në ShK3K6MC dhe ShK3K7MC janë të përshtatshme.

2.2.1.5. Cilësia e paraqitjes dhe dizajnit

Kur bëhet fjalë për cilësinë e prezantimit dhe dizajnit, të dy tekstet shkollore (3A, 3B) të ShK2K3MF janë të organizuara mirë, tërheqëse në aspektin vizual dhe të dizajnuara me kujdes. Teksti ShK2K5MA është organizuar mirë në aspektin vizual, gjithëpërfshirës dhe i dizajnuar me kujdes. Dizajni i librit ShK4K8MC përfshin një veçori unike - kapitujt shfaqen me ngjyra të ndryshme. Kjo e mundëson navigimin dhe orientimin më të lehtë për nxënësit dhe mësime të tjerë kur u referohen kapitujve dhe njësive të veçanta mësimore. Tekstet shkollore A dhe B të CShK2K5MC janë të organizuara mirë, tërheqëse në aspektin vizual dhe të dizajnuara me kujdes. Të gjitha ilustrimet, figurat dhe grafika në ShK1K2MF janë krijime origjinale. Në ShK4K9MC, veçanërisht në pjesën e gjeometrisë, ilustrimet shfaqen me ngjyra të gjalla që janë të dukshme dhe të lehta për t'u kuptuar. Ngjashëm, kapitujt në ShK4K9MC janë paraqitur, po ashtu, me ngjyra të ndryshme, duke ndihmuar në identifikimin dhe vendndodhjen e temave specifike. Për më tepër, teksti shkollor ShK4K9MH përmban ilustrime me ngjyra të qarta dhe lehtësisht të lexueshme.

2.2.2 Mangësitë në tekstet shkollore të matematikës

Megjithatë, ka mjaft mangësi të identifikuar në tekstet e matematikës. Më poshtë do t'i shqyrtojmë ato në kuadër të një sintezë të shkurtër, duke bazuar edhe në kriteret e rishikimit të teksteve shkollore.

2.2.2.1. Bashkërendimi i kurrikulës

Ka disa probleme me strukturën e disa teksteve shkollore. Për shembull, në tekstet shkollore ShK1K1MC dhe ShK1K2MC ka një çekuilibër në thellësinë dhe gjerësinë e shpjegimit të temës. Secilës njësi mësimore i mungojnë rezultatet e pritura në fillim dhe kriteret e suksesit në fund. Struktura e këtyre librave është e paqëndrueshme, që çon në një çekuilibër në përmbajtje dhe mungesë koherence në mësime të tjerë të temave.

Në ShK2K4MC, ka një strukturë të saktë përgjatë gjithë librit, por është e ngurtë me pjesët "Përsërit", "Ushtro" dhe "Mëso". Ka mungesë të vazhdimësisë që i ndan temat ose kapitujt dhe hyrje shtesë përshkruese, motivuese dhe sfiduese për nxënësit. Në tekstin shkollor ShK1K2ME, emrat e njësive mësimore nuk janë gjithmonë të ndërlidhura ose relevante me përmbajtjen e tyre.

Sa i përket mbulimit të kompetencave që konsiderohet si integrim i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve, vërehen shumë mangësi. Pra, ka disa devijime nga kurrikula për sa i përket koncepteve që duhet të mësohen në një klasë të caktuar. Për shembull, teksti shkollor ShK2K4MC mbulon kryesisht temat e përcaktuara me kurrikulë, megjithatë mungojnë rezultatet e të nxënësve për "Numrat natyrorë" dhe "Figurat gjeometrike". Përveç kësaj, ka kapituj që nuk përputhen me përmbajtjen dhe rezultatet e të nxënësve në një numër të konsiderueshëm të rasteve në ShK1K2MA dhe ShK2K4MB. Disa tema të përcaktuara me kurrikulë nuk janë të përfshira në tekstin shkollor ShK3K6MC. Në anën tjetër, në këtë tekst shkollor janë përfshirë edhe rezultate të të nxënësve që nuk pritet të mësohen në klasën e gjashtë. E njëjta çështje vazhdon të jetë e pranishme edhe në tekstin shkollor të klasës së shtatë ShK3K7MC.

Përmbajtja e tekstit shkollor ShK4K9MC, veçanërisht qasja didaktike e përdorur në tekst nuk e stimulon në mënyrë adekuate zhvillimin e shkathtësive themelore që kërkohen nga Korniza e Kurrikulës, kurrikula bërthamë dhe kurrikula lëndore. Në ShK2K4MA, ka mungesë të punës praktike, aktivitete të kufizuara të punës në grup dhe mungesë shembujsh që kërkojnë materiale të ndryshme për t'i praktikuar shkathtësitë thelbësore.

Recensentët e vunë re mungesën e temës "shprehje fjalë për fjalë" në ShK1K1MC. Megjithatë, mund të debatohet lidhur me kurrikulën e lëndës nëse puna me shkronja është e përshtatshme për nxënësit e klasës së parë. Disa tema tjera që mungojnë, si p. sh. "Sipërfaqja", "Modelet" dhe "Puna me të dhëna" janë regjistruar për tekstet shkollore ShK1K1MC dhe ShK2K4MB.

Tekstet shkollore ShK1K1MC dhe ShK2K4MB, si dhe tekstet tjera të matematikës, nuk i mbulojnë kompetencat personale dhe qytetare. Në përgjithësi tekstet shkollore të matematikës nuk i adresojnë qëndrimet dhe vlerat. Ngjashëm, kur bëhet fjalë për pasqyrimin e kulturës dhe traditave të Kosovës, pothuajse nuk ka asnjë referencë në tekstet shkollore ShK2K4MA, ShK2K4MB, ShK2K4MC, ShK3K6MC, ShK3K7MC dhe ShK4K8MC. Në këto tekste shkollore mungojnë shembuj, fotografi dhe ilustrime që përshkruajnë kulturën dhe traditat kombëtare të Kosovës. Përveç kësaj, në këto tekste shkollore nuk ka referenca për kulturën ndërkombëtare.

2.2.2.2. Saktësia e përmbajtjes

Ashtu si në rastin e teksteve të gjuhës shqipe, fenomeni i mbingarkesë vërehet edhe në tekstet shkollore të matematikës. Kështu, tekstet shkollore ShK1K2ME, ShK1K2MC, ShK2K3MF dhe ShK4K9MH shfaqin tepërcë temash, tekstesh, faktesh dhe formulash me fokus në informata/fakte dhe reproduktim. Njësitë mësimore nuk janë gjithmonë të balancuara dhe përmbajnë informata të mbingarkuar, gjë që në mënyrë paradoksale çon në mungesën e mbulimit të rezultateve të të nxënësve. Kjo ndodh edhe me tekstet shkollore ShK2K5MC dhe ShK3K7MC. Ngarkesa e panevojshme me shumë tekst i bën këto libra të vështirë për t'u lexuar, pa hapësirë të mjaftueshme për t'i dalluar shembujt dhe kundër-shembujt, dhe pa hapësirë për detyra kreative.

Ekziston edhe një mbingarkesë me detyra të papërshtatshme për moshën. Për shembull, në ShK2K5MA dhe ShK2K5MC ka sekuenca të detyrave të operacioneve me kllapa të mesme të cilat janë shumë të gjata, duke përfshirë katër operacione matematikore në renditje komplekse, të cilat mund të jenë të vështira për shumicën e nxënësve të klasës së pestë. Shumë detyra që kërkojnë praktikë të madhe matematikore me probleme sfiduese janë të përfshira në ShK2K5MC, gjë që mund t'i demotivojë nxënësit e rregullt të cilët mund ta kenë të pamundur ta arrijnë atë nivel të të kuptuarit teorik. Në ShK2K4MC vërehet një theks i fuqishëm në rrjedhshmërinë procedurale, me një numër të madh ushtrimesh që, për shkak të rigorozitetit dhe kompleksitetit të tyre, i zvogëlojnë aspektet motivuese dhe të këndshme të temave dhe detyrave për shumicën e nxënësve.

Teksti shkollor ShK1K2MC po ashtu nuk përputhet me nivelin kognitiv të nxënësve, por, siç e kemi parë tashmë, ky nuk është një fenomen i izoluar.

Sa i përket koherencës dhe rrjedhës logjike, shumë tekste shkollore nuk bëjnë referenca ose nuk i ndërlidhin informatat e mëhershme me përvojat e nxënësve. Kjo krijon mungesë konsistence dhe ndërprerje në rrjedhën logjike të përmbajtjes. Për shembull, në tekstin shkollor ShK1K2MA, ka mungesë të ndjekjes së vazhdueshme të një strukture konceptuale, që çon në çekuilibër të përmbajtjes dhe ndërprerje të rrjedhës logjike.

2.2.2.3. Efektiviteti i strategjive të të nxënësve

Motivimi i të nxënësve dhe nxitja e kreativitetit duket se nuk janë qëllimi i shumë teksteve shkollore të matematikës. Për shembull, ShK2K5MA fokusohet më shumë në procedura sesa në të kuptuarit konceptual, i cili e pengon zhvillimin e shkathtësive të të menduarit kritik dhe kreativ. Përveç kësaj, ka shumë pak ushtrime dhe aktivitete në ShK1K2ME dhe ShK3K7MC për t'i angazhuar në mënyrë aktive nxënësit dhe për ta ngjallur interesimin e tyre për matematikën.

Detyrat dhe temat e paraqitura në ShK2K4MA nuk janë mjaftueshëm të ndërlidhura me rezultatet e kompetencës së të menduarit kreativ. Mungojnë aktivitetet që përfshijnë hulumtimin, reflektimin, diskutimin dhe prezantimin verbal nga nxënësit për ta stimuluar aftësinë e tyre për t'i mbrojtur idetë e tyre përmes argumentimit logjik.

Në përgjithësi, teksti shkollor ShK2K4MB e ndjek të njëjtën logjikë për sa i përket shembujve dhe detyrave nga fillimi në fund. Njësitë nuk paraqesin tema tërheqëse, por më tepër detyra rutinore që kërkojnë memorizimin e hapave dhe fakteve. Kjo tregon një tendencë në drejtim të ShK2K4MC. Detyrat në ShK4K8MC përfshijnë në masë të vogël të menduarit kritik dhe janë më të fokusuar në të mësuarit përmendësh. Nuk përfshihen kuizet, projektet ose detyra hulumtuese në internet. Njësitë mësimore në ShK2K3MF, ShK3K6MC dhe ShK04K8MC nuk e nxisin zhvillimin e shkathtësive të të menduarit kritik dhe kreativ.

Për fund, në tekstin shkollor ShK4K8MC, mungojnë shembujt dhe detyrat krijuese që nxisin kureshtjen e nxënësve për të mësuar dhe për të marrë pjesë aktive në zgjidhjen e problemeve matematikore. Mungesa e pranisë së problemeve sfiduese, kërkesave të qarta dhe gjuhës që inkurajon hulumtimin, analizën dhe diskutimin e zvogëlon edhe më tej motivimin e nxënësve për ta arritur nivelin e dëshiruar.

Mungesa e qasjeve krijuese është e ndërlidhur ngushtë me fokusin në të mësuarit përmendësh dhe memorizim. Në ShK4K8MA, njësitë mësimore kryesisht i theksojnë procedurat e jo të kuptuarit dhe zotërimin e konceptit dhe zbatimin e tij. Inkuadrimi i përkufizimit, shënimit ose sqarimit i mundëson mësimdhënësit që ta kërkojë memorizimin e atij rregulli ose shënimi. Përkufizimet e dhëna janë tepër teknike dhe me fjalë të panevojshme. Ekziston një tendencë për të përfshirë ushtrime të shumta dhe të ngjashme që fokusohen në memorizimin e fakteve matematikore në ShK4K8MC, veçanërisht kur përcaktohen koncepte ose rregulla. Kjo tregon se si për nxënësit ashtu edhe për mësimdhënësit pritët memorizimi. Libri ShK2K3MF është mjaft i rëndë për sa i përket njësive dhe përmban shumë ushtrime të ngjashme që fokusohen në memorizimin e fakteve matematikore.

Fokusi në të mësuarit përmendësh theksohet qartë në ShK4K8MA, ku nga 85 rezultate të të nxënësve dominojnë foljet e mëposhtme: Përcakto (19 herë), dallo (11), zbato (9) dhe numëro (9). Në anën tjetër, foljet krahaso (1), vlerëso (0) dhe analizo (0) janë më pak të spikatura. Në ShK4K9MH, ka shumë më tepër detyra rutinore apo procedurale në krahasim me detyrat jo rutinore, të cilat kërkojnë kreativitet dhe mendim kritik tek nxënësit.

Përveç kësaj, lidhja me botën reale duket se mungon si objektiv në shumë tekste të matematikës. Njësitë mësimore zakonisht nuk përfshijnë detyra që kanë një lidhje të qartë me jetën e përditshme. Kjo mungesë e kontekstit të jetës reale nuk arrin të tërheqë interesimin e nxënësve për të mësuar dhe për t'u angazhuar në zgjidhjen e problemeve të jetës reale në ShK3K6MC. Teksti shkollor ShK3K7MC në përgjithësi nuk i trajton detyrat që ndërlidhen me jetën e përditshme dhe aktivitetet krijuese që mund ta tërheqin vëmendjen e lexuesit dhe ta inkurajojnë të nxënësve dhe zgjidhjen e problemeve.

Ne hasëm në disa raste në ShK4K8MA ku problemet matematikore lidheshin me punën e nxënësve, situatat e jetës reale ose mjedisin e tyre. Megjithatë, këto duken më shumë si një koleksion detyrash sesa një burim mësimor gjithëpërfshirës për nxënësit.

Një kufizim i tekstit shkollor ShK4K9MC është mungesa e lidhjeve me përvojat reale të nxënësve. Përveç kësaj, ka mungesë të udhëzimeve se si të përvetësohen dhe zbatohen njohuritë në kontekste përtej mjedisit shkollor. Teksti shkollor nuk i adreson në mënyrë adekuate aktivitetet jashtëshkollore, shkathtësitë e jetës dhe të punës, rritjen personale ose orientimin në karrierë për nxënësit.

Sa i përket hapjes ndër-disiplinare, janë evidentuar shumë mospërputhje. Në ShK2K4MA, njësitë nuk mbështeten në teknologjinë mësimore ose mjetet tjera që mund t'u ndihmojnë nxënësve në vizualizimin e koncepteve gjithnjë e më komplekse në këtë moshë. Mungojnë edhe këndvështrimet e ndryshme në shpjegimin e temave. Mungon korrelacioni ndër-kurrikular në ShK2K5MA, ShK2K5MC. Projektet, hulumtimi dhe puna në internet nuk përfshihen në këto njësi. Përdorimi i teknologjisë dhe kompetenca digjitale nuk promovohen në këto libra.

Nuk kemi hasur në asnjë shembull të inkurajimit të përdorimit të teknologjisë në ShK4K9MC. Për shembull, edhe kur është e nevojshme për rezultatet e të nxënësve të kurrikulës, si për shembull në statistika, nuk kërkohet përdorimi i programeve aplikative për përpunimin e të dhënave. Megjithatë, shembujt e paraqitur në libër, siç janë grafikët e përpunuar, janë krijuar duke përdorur programe kompjuterike si Excel ose SPSS. Edhe kur mund të përdoret teknologjia për t'i demonstruar problemet në gjeometri, theksi vihet në punën me laps dhe letër në vend që të përdoret teknologjia për mësim ose mjetet tjera për t'i vizualizuar konceptet komplekse, për t'i nxjerrë dhe analizuar informatat dhe për të gjetur zgjidhje.

Ka disa shembuj në ShK4K9MH që e nxisin përdorimin e teknologjisë në mësim. Megjithatë, është e rëndësishme të përfshihen detyra që u mundësojnë nxënësve ta përdorin teknologjinë, si në klasë ashtu edhe për detyra hulumtimi në shtëpi.

Mësimi i diferencuar promovohet rrallë në tekstet e matematikës. Pamundësia për ta përdorur në mënyrë fleksibile tekstin sipas aftësive dhe stileve të ndryshme të të nxënësve është e evidente në tekstet shkollore ShK1K2ME, ShK3K6MC dhe ShK3K7MC. Përveç kësaj, teksti shkollor ShK3K7MC nuk ofron materiale për aktivitete përmirësuese. Mungon gjithashtu puna praktike, puna në grupe dhe shembuj që kërkojnë materiale të ndryshme për t'i ushtruar detyrat në ShK2K4MB.

Teksti shkollor ShK4K8MC nuk arrin ta paraqesë një ekuilibër proporcional ndërmjet zhvillimit të shkathtësive të të kuptuarit konceptual dhe proceseve matematikore që trajtohen gjatë njësive mësimore, duke i munguar kështu të nxënësve të diferencuar. Aparati didaktik nuk e lehtëson diferencimin e të nxënësve apo përshtatjen me kapacitetet mendore të nxënësve të caktuar, duke përfshirë ata me vështirësi në të nxënë, në ShK4K8MC.

Sa i përket vlerësimit, ka mangësi në shumë tekste shkollore. Nuk ka pjesë që i dedikohen vlerësimit të të kuptuarit si në tekstin shkollor ShK1K2ME dhe detyrat e vlerësimit janë të pamjaftueshme për t'i matur arritjet e nxënësve. Vlerësimi sumativ mungon në ShK1K2MA, ShK2K5MA dhe ShK4K8MA. Në tekstin shkollor ShK4K9MH, detyrat hulumtuese jepen në fund të pjesës "Çfarë mësuam", por mungesa e udhëzimeve apo sqarimeve e bën të papërdorshëm këtë kriter vlerësimi.

2.2.2.4. Saktësia dhe qasja e gjuhës

Shumë tekste shkollore kanë telashe me saktësinë dhe qasjen e gjuhës. Për shembull, ShK1K2MF përmban gabime drejtshkrimore, zgjedhje të gabuara të foljeve, përdorim të fjalëve jo standarde dhe gabime të tjera. Përveç kësaj, ka edhe gabime tipografike. Në tekstin shkollor ShK2K4MB, numri i faqeve në tabelën e përmbajtjes nuk përputhet me numrin aktual të faqeve në libër. Për më tepër, ka gabime teknike në shumë detyra, si dhe gabime drejtshkrimore dhe tipografike në ShK2K4MB. Teksti shkollor ShK2K4MC ka një numër të konsiderueshëm gabimesh, potencialisht të natyrës teknike, të cilat duhet të korrigjohen gjatë procesit të rishikimit. Për fund, përdorimi i fjalorit shpjegues dhe elementeve grafike për të ndihmuar të kuptuarit është i kufizuar në ShK1K2MC. Fjalori në librin ShK4K8MA vuan nga disa mangësi dhe pasaktësi sa i përket koncepteve që synon t'i sqarojë ose t'i përcaktojë. Ne do të rekomandonim rishikimin e tij bazuar në përkufizimet ose sqarimet origjinale nga burime të besueshme.

2.2.2.5. Cilësia e paraqitjes dhe dizajnit

Shumë tekste shkollore i paraqesin në mënyrë jo adekuate, jo-funksionale dhe jo tërheqëse ilustrimet për nxënësit. Në ShK3K7MC, disa shembuj, foto dhe vizatime nuk përputhen me temat e diskutuara (veçanërisht kopertinat e kapitujve) dhe u mungon cilësia e lartë, gjë që nuk u ndihmon nxënësve ta kuptojnë më mirë përmbajtjen. ShK2K5MC përmban një numër adekuat të ilustrimeve grafike brenda tekstit, por mungojnë fotografitë origjinale që ndërlidhen me detyrat, të cilat duhet të jenë më të gjera duke marrë parasysh moshën e nxënësve.

Përveç kësaj, ilustrimet e paraqitura në hyrjet e shumicës së kapitujve nuk ndërlidhen drejtpërdrejt me përmbajtjen që do të diskutohet në ShK4K8MC. Për më tepër, në disa njësi mësimore, figurat nuk janë paraqitur qartë, me vija shumë të holla, veçanërisht në kapitullin Trekëndëshi dhe Katërkëndëshi. Kjo e bën të vështirë për nxënësit t'i kuptojnë konceptet, e lëre më të angazhohen në zgjidhjen e detyrave.

Gjithashtu, në disa njësi të ShK3K6MC, dizajni është i papërshtatshëm pasi që madhësia e shkronjave është shumë e vogël në shembuj të caktuar. Përveç kësaj, disa nga ilustrimet dhe fotot nuk janë mjaftueshëm të ndërlidhura me tekstin, duke ua bërë të vështirë nxënësve ta kuptojnë përmbajtjen. Mungojnë ilustrimet në të gjithë tekstin, si dhe mungojnë fotografitë origjinale në lidhje me detyrat, të cilat duhet të jenë më të bollshme duke marrë parasysh moshën e nxënësve, si në ShK2K4MB.

3. Rekomandimet e politikave

Ky pjesë sjell në vëmendje disa zgjidhje për përmirësimin e sistemit arsimor në Kosovë, zgjidhje që dalin nga analiza e teksteve shkollore, por edhe duke e marrë parasysh kontekstin më të gjerë që i ka gjeneruar këto tekste shkollore dhe filozofinë e tyre të të nxënësve, mësimdhënies dhe praktikave të vlerësimit.

3.1. Fushat për përmirësim në përmbajtjen e teksteve shkollore

Për shkak se i gjithë procesi i kushtua përmirësimit të cilësisë së teksteve shkollore, ne po e fillojmë këtë pjesë të raportit me sugjerime për përmirësimin e përmbajtjes së teksteve aktuale. 38 raportet e rishikimit të teksteve shkollore ofrojnë rekomandime specifike dhe të detajuara për secilin tekst. Gjithashtu, pikat e forta të teksteve shkollore të theksuara në pjesën 2 të këtij raporti nxjerrin në pah praktikatat e mira në lidhje me kriteret, të cilat mund të shihen si rekomandime.

Në këto kushte, rekomandimet e mëposhtme fokusohen më së shumti në disa aspekte që kanë të bëjnë me mekanizmat e të nxënësve efikas duke sjellë këndvështrime nga hulumtimet e fundit në shkencën kognitive. Këto rekomandime i kanë parasysh, po ashtu, gjeneratat e reja të teksteve shkollore të zhvilluara nga autorë të cilët janë të vetëdijshëm për kërkesat e reja të kurrikulës të bazuar në kompetenca dhe mund t'i zhvillojnë njohuritë e duhura të nxënësve për një botë dinamike dhe me ndryshime të shpejta.

• *Konteksti ka rëndësi!* Analiza e teksteve shkollore ka zbuluar se shumica e njësive mësimore ofrojnë mësim të de-kontekstualizuar. Ekziston një filozofi që matematika është universale, prandaj konteksti nuk ka rëndësi. Gjithashtu, e njëjta filozofi konsideron se rregullat gjuhësore dhe shkathtësitë e komunikimit duhet të përvetësohen pa marrë parasysh kontekstin. Megjithatë, shkenca kognitive ka demonstruar qartë se të nxënësve duhet të kontekstualizohet për të qenë efektiv, sepse të nxënësve duhet të jetë kuptimplotë për nxënësve.

Të nxënësve kontekstual në tekstet shkollore u ndihmon nxënësve t'i kuptojnë konceptet komplekse duke i lidhur ato me situatat e tyre tashmë të eksperimentuara. Një kontekst i njohur që prezanton njohuri të reja e rrit të kuptuarit. Prandaj, duke ofruar shembuj dhe raste studimore relevante, tekstet shkollore ua lehtësojnë nxënësve që ta kuptojnë thelbin e lëndës. Një rol tjetër i kontekstit është nxitja e shkathtësive të transferueshme. Duke e kontekstualizuar të nxënësve, tekstet shkollore mund të nxisin zhvillimin e shkathtësive që mund të zbatohen në disiplina të ndryshme dhe në situata të jetës reale. Këto shkathtësi përfshijnë të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve, komunikimin dhe bashkëpunimin.

Konkretisht, rekomandohet që nxënësit mësimore në një tekst shkollor të fillojnë me shembuj ose situata problemore që nxënësit mund t'i hasin në mjedisin e tyre të ngushtë shoqëror/natyror, në mënyrë që të bëhet lidhja ndërmjet lëndës dhe nivelit të të kuptuarit të nxënësve. Këta shembuj duhet ta nxisin zhvillimin e shkathtësive të nxënësve për zgjidhjen e problemeve në jetën e tyre të përditshme, si dhe të ndihmojnë në zhvillimin e të menduarit kritik dhe krijues dhe ta rrisin interesimin për ta mësuar lëndën. Prandaj, tekstet shkollore për çdo klasë duhet të paraqesin më shumë kontekste kuptimplota për nxënësit e asaj moshe përkatëse, të cilat synojnë t'i inkurajojnë ata t'i zhvillojnë shkathtësitë për zgjidhjen e problemeve në situata të jetës së përditshme, duke e rritur të kuptuarit dhe transferimin e të nxënit.

· *Situatat e jetës reale duhet t'i përshkojnë tekstet shkollore.* Shumë nga tekstet e analizuara nxjerrin në pah një pikëpamje akademike, abstrakte-teorike të lëndës. Kjo krijon një reagim refuzues tek nxënësit, të cilët sot mund të marrin informata nga burime tjera të ndryshme që hyjnë pashmangshëm në konkurrencë me tekstet shkollore.

Situatat e jetës reale u ofrojnë nxënësve mundësinë për t'i zbatuar konceptet teorike në skenarë praktikë. Duke paraqitur shembuj dhe tregime autentike, tekstet shkollore e bëjnë të nxënit relevant, të ndërlidhur dhe të zbatueshëm në botën reale. Kjo i inkurajon nxënësit të mendojnë në mënyrë kritike, t'i analizojnë problemet dhe t'i zhvillojnë shkathtësitë për zgjidhjen e problemeve. Gjithashtu, duke i ndërlidhur konceptet me jetën dhe përvojat e tyre, nxënësit kanë më shumë gjasa të qëndrojnë të angazhuar me materialin dhe të ndihen të motivuar për të mësuar. Situatat e jetës reale mund ta nxisin edhe kureshtjen dhe dëshirën për të hulumtuar më tutje, duke e nxitur të kuptuarit më të thellë të lëndës. Konkretisht, si tekstet e gjuhës ashtu edhe ato të matematikës duhet të ofrojnë më shumë shembuj nga aktivitetet jashtëshkollore që ndërlidhen me sportin, shëndetin, mjedisin, etj. Gjithashtu, teksti duhet të përmbajë aktivitete që kërkojnë nga nxënësi të eksperimentojë, të bëjë disa kërkime në frymën e lëndës, të ofrojnë mundësi për punë fizike, punë në grup dhe ndër-veprim, për t'i motivuar nxënësit që të mësojnë.

· *Kujtesa dhe memorizimi janë të rëndësishme në të nxënit e qëndrueshëm, por ato duhet të shoqërohen dhe të balancohen nga zhvillimi i kreativitetit.* Shumë nga tekstet shkollore fokusohen në mësimin përmendsh, memorizimin e procedurave dhe praktikimin e detyrave rutinore të de-kontekstualizuara.

Të mësuarit përmendësh përfshin memorizimin e fakteve, koncepteve ose formulave pa i kuptuar domosdoshmërisht parimet themelore. Përderisa të mësuarit përmendësh mund të jetë i dobishëm në situata të caktuara, ai nuk është i mjaftueshëm për të kuptuar thellë dhe për të menduarit kritik. Ngjashëm, procedurat e memorizimit mund të jenë të dobishme për kryerjen e detyrave specifike ose ndjekjen e metodologjive të caktuara. Megjithatë, është thelbësore të balancohet memorizimi me të kuptuarit e koncepteve që qëndrojnë pas procedurave për t'i promovuar shkathtësitë e nivelit më të lartë të të menduarit. Përderisa tekstet shkollore shpesh e përdorin mësimin përmendsh dhe memorizimin si hapa fillestarë drejt të nxënit, në mënyrë ideale ata do të duhej ta inkurajonin edhe të menduarit kritik, analizën dhe zbatimin e njohurive.

Rekomandohet që teksti shpjegues i shkruar të jetë më i shkurtër, të zvogëlohet edhe numri i detyrave rutinore që u paraqiten nxënësve për t'i zgjidhur, ndërsa në libra të paraqiten më shumë detyra që kërkojnë arsyetimin, analizimin, interpretimin ose vlerësimin e nxënësit. Një tekst shkollor i suksesshëm tërheq vëmendjen dhe angazhon nxënësit në procesin e të nxënit duke përfshirë aktivitete ndërvepruese, pyetje që nxisin mendimin dhe shembuj të jetës reale që mund ta ndezin kureshtjen, ta inkurajojnë të menduarit kritik dhe ta bëjnë përmbajtjen më të ndërlidhur dhe më kuptimplotë. Një tekst shkollor gjithëpërfshirës duhet të ofrojë shpjegime të koncepteve dhe procedurave (duke iu përgjigjur pyetjes “pse?”), shembuj të zbatimit në jetën reale dhe mundësi për nxënësit që ta zbatojnë të kuptuarit e tyre në skenarë praktikë ose përmes situatave të zgjidhjes së problemeve.

Shqisat vizuale dhe ato të të prekurit kontribuojnë shumë në të nxënit efektiv. Shumë nga tekstet e analizuara shfaqin tekste të gjata me mjaft ilustrime, shpesh herë të parëndësishme për mesazhin që duan ta përcjellin.

Shqisat vizuale dhe ato të të prekurit luajnë rol në perceptimin dhe përpunimin e informatave, në formimin e lidhjeve dhe në rritjen e mbajtjes në mend. Pamjet, siç janë imazhet, diagramet, grafikët dhe videot, ofrojnë paraqitje të koncepteve dhe informatave komplekse. Të nxënit me anë të prekurit përfshin ndërveprimin fizik me objekte ose materiale, duke ofruar përvojë praktike. Të dy llojet u ndihmojnë nxënësve t'i kuptojnë dhe interpretojnë më lehtë informatat, duke u mundësuar atyre t'i kuptojnë tema abstrakte ose sfiduese. Prandaj, përvojat pamore dhe ato të të prekurit u ndihmojnë nxënësve ta zhvillojnë një kuptim më të thellë konceptual të lëndës. Kur ata mund t'i shohin dhe t'i prekin përfaqësimet e prekshme të ideve abstrakte, ata mund t'i përvetësojnë konceptet në mënyrë më efektive. Ky kuptim shkon përtej memorizimit përmendësh dhe u mundëson nxënësve t'i zbatojnë njohuritë në situata të jetës reale. Këto përvoja po ashtu kanë një ndikim të thellë në mbajtjen në mend. Studimet kanë treguar se përfshirja e pamjeve vizuale ose e aktiviteteve praktike mund të përmirësojë ndjeshëm kujtesën afatgjate.

Tekstet shkollore duhet të përfshijnë skema vizuale, tabela, lidhje me video edukative, etj. për ta përmirësuar kuptimin e konceptit. Për shembull, metoda e modelit të bllokut është një strategji vizuale e zhvilluar dhe e përdorur gjerësisht në tekstet shkollore dhe fletoret e lëndës së matematikës në Singapor. Kjo qasje ka ndikuar që nxënësit të kenë rezultate të shkëlqyeshme në testet e standardizuara ndërkombëtare si PISA ose TIMSS. Detyrat praktike të përfshira në tekstet e gjuhës, siç janë vizita në një ekspozitë arti ose në tekstet e matematikës, siç janë ndërtimi i modeleve të formave 2D dhe 3D në gjeometri, mund ta përforcojnë të kuptuarit dhe të ndihmojnë në krijimin e lidhjeve ndërmjet teorisë dhe praktikës. Aktivitetet me të prekur, siç janë enigmat, fjalëkryqet, ndërtimi i blloqeve ose manipulatorët, i inkurajojnë nxënësit të ndërveprojnë fizikisht me materiale, duke e nxitur ndjenjën e kureshtjes dhe motivimit.

Përfshirja sociale është një vektor i zhvillimit në komunitetet bashkëkohore. Përfshirja sociale mund të theksohet në tekstet shkollore përmes ofrimit të burimeve për mësim të diferencuar. Çështja e të nxënit të diferencuar trajtohet rrallë në tekstet e analizuara në këtë drejtim; në rastet më të mira, tekstet e matematikës ofrojnë detyra të niveleve të ndryshme të vështirësisë, por zakonisht, këto detyra fokusohen në aftësimin për performancë në matematikë, e më pak në sigurimin, për shembull, të të nxënit përmirësues.

Tekstet shkollore luajnë një rol thelbësor në formësimin e mendjeve të nxënësve dhe mund të ofrojnë mundësi për t'i bërë ata të mësojnë për dinamikën sociale, diversitetin dhe rëndësinë e të qenit gjithëpërfshirës. Duke e integruar përfshirjen sociale në tekstet shkollore, ne mund ta promovojmë vetëdijësimin, empatinë dhe pranimin në mesin e nxënësve. Kjo mund t'i ndihmojë ata ta kuptojnë vlerën e përfshirjes dhe pasojat negative të përjashtimit ose diskriminimit. Përveç kësaj, tekstet shkollore mund ta theksojnë rolin e përfshirjes sociale në arritjen e zhvillimit dhe përparimit në shoqëri. Ata mund të shpjegojnë se si komunitetet gjithëpërfshirëse kanë prirje të jenë më të barabarta, të qëndrueshme dhe të begata. Duke kuptuar këtë lidhje, nxënësit mund ta kuptojnë rëndësinë e nxitjes së përfshirjes sociale në jetën dhe komunitetet e tyre.

Ekziston një lidhje delikate ndërmjet përfshirjes sociale dhe të nxënësve të diferencuar, sepse ne duhet të supozojmë se njerëzit janë të ndryshëm dhe, në të njëjtën kohë, secili prej tyre duhet të kontribuojë në ndërtimin e njohurive dhe të kuptuarit në klasë, në komunitet dhe në shoqërinë në përgjithësi, duke i përdorur aftësitë personale.

Për ta përfshirë të nxënësve të diferencuar në një tekst shkollor mund të përdoren disa strategji, ndër të cilat:

- Ofrimi i llojllojshmërisë së opsioneve të përmbajtjes siç është ofrimi i niveleve të ndryshme të leximit, ofrimi i shembujve dhe këndvështrimeve të shumta dhe ofrimi i burimeve digjitale si video ose simulime interaktive.
 - Mundësia e fleksibilitetit në ritmin me të cilin nxënësit përparojnë përmes teksteve shkollore; më konkretisht, ofrimi i aktiviteteve shtesë për nxënësit e avancuar dhe përfshirja e rishikimit ose ushtrimeve përmirësuese për nxënësit që kanë vështirësi në mësim. Në këtë mënyrë, nxënësit mund të punojnë me ritmin e tyre dhe të mbeten të angazhuar me tekstin shkollor.
 - Përfshirja e metodave të ndryshme të vlerësimit për ta vlerësuar të kuptuarit dhe përparimin e nxënësve. Kjo mund të përfshijë vlerësimet me zgjedhje të shumëfishta, të hapura dhe të bazuara në projekte. Po ashtu, është e dobishme që të sigurohen rubrika dhe kritere të qarta për vlerësim. Përveç kësaj, në tekstet shkollore mund të ofrohen edhe mundësi për bashkëpunim dhe diskutim me bashkëmoshatarët për t'i inkurajuar nxënësit që të mësojnë dhe ta mbështesin njëri-tjetrin.
- *Vlerat dhe qëndrimet pozitive janë thelbësore në ndërtimin e një kombi.* Çuditërisht, referencat për kulturën dhe traditat vendore janë relativisht të pakta në tekstet e analizuara.

Tekstet shkollore të gjuhës dhe të matematikës duhet të përmbajnë elemente të kulturës dhe traditave të Kosovës për të kontribuar më mirë në synimet e arsimit para-universitar dhe kërkesat e kurrikulës. Megjithatë, kjo duhet bërë me kujdes për ta shmangur indoktrinimin duke përfshirë kulturën dhe traditat vendore në një tekst shkollor dhe duke i zhvilluar vlerat dhe qëndrimet e qytetarisë. Në këtë drejtim mund të merren parasysh disa sugjerime. Tekstet shkollore mund të ofrojnë këndvështrime të balancuara dhe të larmishme mbi ngjarjet historike, praktikat kulturore dhe vlerat, duke u mundësuar nxënësve të formojnë opinionet e tyre bazuar në të kuptuarit dhe arsyeshmërinë. Po ashtu, shembujt dhe situatat e paraqitura në libra duhet ta theksojnë rëndësinë e respektimit të kulturave, traditave dhe perspektivave të ndryshme dhe ta inkurajojnë multi-kulturalizmin.

- *Teknologjia është pjesë e jetës sonë sot.* Teknologjia është përfshirë shumë rrallë në tekstet e analizuara. Megjithatë, ajo përfaqëson një dimension thelbësor të jetës sonë sot. Një nga rezultatet e të nxënësve që promovohet në kurrikulat bërthamë është përdorimi i TIK-ut. Është e nevojshme që të promovohet përdorimi i teknologjisë për zgjidhjen e situatave matematikore, por edhe të aspekteve të tjera që ndërlidhen me gjuhët dhe jetën e njeriut në përgjithësi. Për të ndodhë kjo, është e dobishme që të demonstrohet se si teknologjia i lidh konceptet e teksteve shkollore me skenarët, industritë ose profesionet e jetës reale. Kjo mund t'u ndihmojë nxënësve që ta kuptojnë rëndësinë praktike dhe t'i motivojnë ata që t'i hulumtojnë ato lidhje më tej duke e përdorur teknologjinë. Po ashtu, duke e inkurajuar përdorimin e teknologjisë për të krijuar grupe ose komunitete ku nxënësit mund të bashkëpunojnë në detyra, t'i ndajnë shënimet dhe të diskutojnë tema nga teksti shkollor, do të mund të stimulohej pjesëmarrja aktive dhe angazhimi.

- *Vlerësimi dhe vetë-vlerësimi janë mjetet kyçe për përparimin e të nxënësve.* Një nga veçoritë e teksteve të analizuara është mungesa e vlerësimit ose përdorimi jo i duhur i metodave për vlerësimin aktual të nxënësve. Megjithatë, vlerësimi dhe vetë-vlerësimi janë komponentë thelbësorë të të nxënësve efektiv, për monitorimin dhe matjen e progresit të të nxënësve. Ato ofrojnë informata kthyesë të vlefshme për të kuptuarit, shkathtësitë dhe aftësitë e nxënësve, duke u mundësuar atyre që të bëjnë përmirësime dhe ta përcjellin zhvillimin e tyre me kalimin e kohës. Ato e lehtësojnë të nxënësve të personalizuar, promovojnë vetë-re-flektimin dhe nxisin një kulturë të të nxënësve gjatë tërë jetës.

Rekomandohet që të përfshihen, në çdo kapitull (ose njësi), detyra e vlerësimit të tipit tradicional (testi, kuizi, etj.) dhe të tipit alternativ (projektet, hulumtimi i vetë-vlerësimit, etj.) që synojnë t'i identifikojnë fushat ku nxënësit shkëlqejnë dhe fushat ku mund të kenë nevojë për mbështetje shtesë.

Megjithatë rezultatet e të nxënësve jepen për secilën temë, testet e shkurtra që jepen në fund të një njësie mësimore mund të verifikojnë nëse ato rezultate janë arritur apo jo. Nëpërmjet këtij vlerësimi të vazhdueshëm, do të ofrohet mundësia e diferencimit të niveleve të arritjeve për nxënësit me aftësi dhe mundësi të ndryshme, duke e mundësuar mbështetjen e duhur përpara se humbja e të nxënësve të grumbullohet në atë nivel që është vështirë të rikuperohet.

- *Korrektesia e gjuhës dhe saktësia shkencore ofrojnë një bazë solide.* Një kritikë e përgjithshme lidhur me shumicën e teksteve të analizuara është se janë vërejtur gabimet drejt-shkrimore, përkufizime konfuze dhe mungesë qartësie në ritmin e të nxënësve. Për të paraqitur informata të sakta dhe të përditësuara, autorët e teksteve shkollore duhet t'i marrin ato nga burime të besueshme siç janë revistat akademike, librat shkencorë, ueb-faqet me reputacion dhe mendimet e ekspertëve. Citimi i duhur i burimeve dhe autorëve është e rëndësishme për ta ruajtur integritetin akademik.

Gjithashtu, gjuha duhet të jetë e qartë, koncize dhe e qasshme për t'u kuptuar nga nxënësit. Konceptet komplekse duhet të shpjegohen në një mënyrë që të mund të për-punohen lehtësisht, duke përfshirë shembuj, analogji dhe pamje të përshtatshme. Sigurimi i qasjes në një tekst shkollor do të thotë ta bësh atë gjithëpërfshirës për të gjithë nxënësit. Kjo përfshin përdorimin e gjuhës së thjeshtë, shmangien e zhargonit dhe ofrimin e akomodimeve të përshtatshme për nxënësit me nevojë të veçanta.

Formatimi i tekstit, siç është përdorimi i fonteve të lexueshme dhe hapësira e përshtatshme, kontribuojnë po ashtu në qasje të tekstit.

Një korrektor gjuhësor duhet ta kontrollojë drejtshkrimin në bashkëpunim të ngushtë me autorët e teksteve shkollore për të siguruar shprehje të unifikuara gjuhësore në të gjithë tekstin. Ne e konsiderojmë po ashtu të nevojshme, kur një ekip i përzier autorësh nga Shqipëria dhe Kosova bashkëpunojnë (që është një gjë shumë e mirë) t'i kushtohet vëmendje unifikimit të terminologjisë që autorët e të dy vendeve e përdorin në tekst.

- *Motivimi e ndërton të ardhmen.* Shumë pak nga tekstet e analizuara mund të konsiderohen si motivues për nxënësit që ata të avancojnë në të nxënies së tyre. Megjithatë, motivimi është në thelb të çdo përpjekjeje njerëzore dhe ai duhet të promovohet në tekstet shkollore.

Për të zhvilluar një tekst motivues, mund të zhvillohen disa strategji si ato të paraqitura në vijim. Është me rëndësi që të përdoret një gjuhë koncize dhe e lehtë për t'u kuptuar. Prandaj, konceptet komplekse duhet të zbërthehen në pjesë më të thjeshta me shpjegime të qarta; shembuj, analogji dhe pamje që mund ta bëjnë përmbajtjen më të qartë dhe interesante për lexuesin. Përfshirja e diagrameve, skicave, grafikëve dhe mjeteve të tjera vizuale mund të ndihmojë në ilustrimin e koncepteve komplekse dhe ta bëjë përmbajtjen më tërheqëse dhe të qasshme nga ana vizuale.

Një zgjidhje tjetër e mirë është të ndahet teksti me nëntituj, pika të radhitura dhe citate përkatëse për ta bërë atë tërheqës në aspektin vizual dhe më të lehtë për të naviguar dhe ruajtur interesimin. Seksionet ose shembujt që tregojnë se si konceptet e mësuara në tekst janë të rëndësishme dhe të zbatueshme në situata të botës reale, mund t'u ndihmojnë nxënësve që ta shohin vlerën praktike të asaj që e mësojnë dhe mund t'i motivojnë ata të angazhohen më shumë me tekstin. Kurdoherë që është e mundur, ndërlihdja e përmbajtjes së tekstit shkollor me interesimet, hobit ose pasionet personale të nxënësve kanë më shumë gjasa ta rrisin motivimin për të mësuar dhe për t'i mbajtur në mend informatat. Duke përfshirë kuizet ose pyetjet e vetë-vlerësimit përgjatë tekstit shkollor, nxënësit mund të motivohen gjithashtu kur e shohin se njohuritë dhe shkathtësitë e tyre përmirësohen.

3.2. Rekomandime për rishikim dhe recensim të teksteve shkollore në të ardhmen

Procesi pilot që përbëhej nga një program për ngritjen e kapaciteteve dhe zbatimin e tij në rishikimin e teksteve shkollore, i cili u zhvillua në fund të vitit shkollor 2022-23, rezultoi efektiv për sa i përket kompetencës së fituar nga pjesëmarrësit e përfshirë dhe rezultateve që ata arritën në aspektin e rishikimit profesional të teksteve shkollore që i rishikuan. Rekomandimet e mëposhtme e detajojnë mënyrën se si të përdoren burimet e krijuara dhe si mund të vazhdohet dhe përmirësohet ky proces.

- MASHTI duhet ta krijojë një proces për rishikimin dhe recensimin e vazhdueshëm të teksteve shkollore. Ky do të shërbejë si një mekanizëm konsistent dhe i qëndrueshëm për të marrë të dhëna autentike nga përdoruesit e teksteve shkollore, duke u fokusuar në përmirësimin e vazhdueshëm të teksteve shkollore. Ky proces dhe mekanizmat përkatës kërkojnë një bazë të qartë ligjore në mënyrë që qasja ndaj rishikimit dhe recensimit të vazhdueshëm të njihet dhe të mbështetet nga MASHTI.
- Faza pilot e cila përfshinte trajnimin e 30 ekspertëve dhe rishikimin dhe recensimin e teksteve shkollore për gjuhë shqipe dhe matematikë në klasat 1 deri në 9 duhet të përsëritet në vitet e ardhshme për lëndë të tjera, në mënyrë që tekstet aktuale në treg të ofrojnë një përvojë më të mirë të të nxëniet për nxënësit dhe udhëzime më koherente për mësimdhënësit. Në një periudhë afatgjate, metodologjia e iniciuar në kuadër të këtij procesi duhet të shërbejë si bërthamë për programin e ngritjes së kapaciteteve të ekipeve të recensentëve të cilët do ta vlerësojnë cilësinë e gjeneratave të reja të teksteve shkollore, në të gjitha fushat e tjera kurrikulare dhe në secilën komunë të Kosovës.
- Programi për krye-trajnerë për ekipet e reja të recensentëve për tekstet aktuale të lëndëve tjera duhet të zhvillohet dhe akreditohet nga MASHTI. Programi për krye-trajnerë duhet t'i mbulojë aspekte siç janë: si të përzgjidhet një tekst shkollor i përshtatshëm për nevojat e nxënësve; si të bëhet zbatimi përkatës i kurrikulës së bazuar në kompetenca; si të zhvillohen burime për ta plotësuar përmbajtjen që mungon në një tekst të caktuar shkollor.
- Programi i ngritjes së kapaciteteve për ekipet e rishikimit duhet të bëhet trajnimi bazë për ekipet e ardhshme të recensentëve që do ta vlerësojnë cilësinë e gjeneratave të reja të teksteve shkollore pas miratimit të ligjit për tekstet shkollore. Programi mbulon qasjet teorike në mësimdhënie dhe mësim-nxënie, hulumtimet e fundit, dhe të dhënat për zbatimin e kurrikulës (lëndë të ndryshme) në Kosovë, kornizën e kurrikulës së Kosovës dhe Kurrikulat përkatëse Bërthamë, kurrikulat e lëndëve, perspektivat e zhvillimit dhe zbatimit të teksteve shkollore në vende të ndryshme, aspektet që ndërlidhur me ligjin e ri për tekstet shkollore në Kosovë, kriteret dhe përshkruesit për rishikimin e teksteve shkollore. Të gjitha këto tema janë kombinuar sistematikisht me aktivitete praktike për të siguruar përvetësim optimal të njohurive dhe shkathtësive që duhet të zhvillohen. Programi ka një fokus të dyfishtë, në ndërtimin e kompetencave funksionale të pjesëmarrësve për rishikimin e teksteve shkollore, si dhe rritjen e motivimit dhe angazhimit të tyre për të bërë një punë cilësore.
- Duke e pasur parasysh risinë dhe kompleksitetin e përmbajtjes së programit dhe rezultatet e mira që janë arritur, MASHTI dhe Fakulteti i Edukimit duhet ta konsiderojnë integrimin e tij në programin Master si temë për hulumtime dhe analiza të vazhdueshme. Kështu, qasjet ndaj rishikimit dhe recensimit të teksteve shkollore do të bëheshin fusha me interes për studentët aktualë dhe studentët e rinj të programit Master.

- Ekipi kryesor prej 30 ekspertësh vendorë të trajnuar nga projekti KosED përbën një burim shumë të rëndësishëm njerëzor kosovar në të ardhmen, për përmirësimin dhe zhvillimin e teksteve shkollore. Puna e ardhshme e këtij ekipi duhet të mbështetet në vazhdimësi nga MASHTI, dhe puna e tyre profesionale do të mund të menaxhohej nga një institucion qendror, siç është Instituti Pedagogjik i Kosovës. Duke pasur parasysh se janë rreth 200 kurrikula lëndore dhe të paktën 600 tituj librash, do të nevojiten të identifikohen dhe trajnohen të paktën 200 recensentë në vit për t'i adresuar kërkesat e ligjit të ri për tekstet shkollore. Personat e sipërpërmendur do të përfaqësojnë një burim njerëzor thelbësor për të gjitha proceset që ndërlidhen me zhvillimin dhe rishikimin e teksteve shkollore, dhe kapaciteti i tyre duhet të njihet dhe të kapitalizohet për veprimet/reformat e ardhshme. Kjo siguron qëndrueshmëri dhe vazhdimësi të procesit.
- Nevojitet një grup mësuesish dhe edukatorësh të trajnuar, që mbulojnë shtatë rajonet dhe DKA-të përkatëse. Ky trajnim do të kontribuojë në krijimin e ekipeve komunale për rishikim dhe recensim, të cilët vazhdimisht kontribuojnë në përmirësimin e teksteve duke ofruar të dhëna dhe informata kthyesë nga niveli i shkollës. Mësimdhënësit dhe edukatorët e trajnuar duhet të ndjekin programin e trajnimit të zhvilluar nga KosEd dhe Instituti Pedagogjik i Kosovës dhe të miratuar nga MASHTI.
- MASHTI duhet të krijojë një mekanizëm efektiv të komunikimit me autorët dhe botuesit. Kjo do të sigurojë që informatat kthyesë dhe të dhënat e përpiluara në raportet e rishikimit dhe recensimit nga ekipet e trajnuara, në nivel të DKA-ve dhe atë rajonal, të ndahen vazhdimisht duke e pasur parasysh përmirësimin e teksteve dhe materialeve mësimore aktuale dhe atyre të ardhshme. Një kalendar vjetor për rishikimin dhe recensimin e teksteve shkollore, i përgatitur nga MASHTI dhe i ndarë me të gjitha palët e interesit, mund të jetë një mjet efektiv i komunikimit. Kalandari vjetor mund të përfshijë: afatin kohor për trajnimin e recensentëve në nivel rajonal dhe atë të DKA-ve, kohëzgjatjen e procesit të rishikimit dhe recensimit që do të zhvillohet, udhëzimet e procesit për analizimin e raporteve në përpunim, procesin e komunikimit me botuesit dhe autorët, afatin kohor për redaktimin dhe përmirësimin e teksteve shkollore sipas të dhënave që merren, dhe prodhimin e teksteve të reja dhe të rishikuara për vitin pasues.
- Të gjeturat nga rishikimi dhe recensimi i teksteve shkollore mund të nënkuptojnë ndryshime të kurrikulës në përgjithësi dhe rishikime të kurrikulës lëndore në veçanti. Pra, MASHTI duhet ta krijojë një mekanizëm të qartë për t'i analizuar të dhënat nga rishikimi dhe ndryshimet e propozuara të kurrikulës/lëndëve. Udhëzimet (manualet) për përmirësimet e vazhdueshme të kurrikulës dhe fushës lëndore, të zhvilluara nga MASHTI, mund të jenë një qasje për përmirësim dhe avancim efektiv.

3.3. Implikimet për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës

Në kuadër të procesit të rishikimit të teksteve shkollore, janë identifikuar disa kufizime dhe mangësi për sa i përket zbatimit të kurrikulës së re. Ne do t'i përmendim ato për t'i formuluar rekomandimet për përmirësime konstruktive.

3.3.1 Njohuritë e pasqyruara në tekstet shkollore

Njohuritë e transmetuara në arsimin e obligueshëm të Kosovës ende paraqiten, në thelb, si produkt. Ofrohen produkte kognitive të para-fabrikuara dhe përmes ushtrimeve përkatëse stimulohen aftësitë riprodhuese të nxënësve. Për më tepër, njohuritë pritet të kthehet në zgjidhje të mirë vetvetiu, pasi që nuk janë hulumtuar aplikimet e tyre në jetën e përditshme ose në sferën prodhuese. Njohuritë si proces po promovohen në mënyrë diskrete nga disa tekste shkollore. Vetëm rreth 10 për qind e ushtrimeve kognitive që u propozohen nxënësve në të gjitha tekstet e analizuara kanë ndonjë lidhje me jetën praktike. Nxënësve nuk u mësohet se si të punojnë në projekte, të zgjidhin probleme të jetës reale ose të zbulojnë se si të hulumtojnë strategji alternative kur përballen me probleme.

Burimet mësimore ekzistuese janë teksti shkollor dhe fletorja. Ideja e burimeve alternative për të mësuar, d.m.th, hulumtimi dhe përdorimi i burimeve të njohurive, është ende larg për të pasur një rol efektiv në mësimdhënie dhe në të nxënësve.

Shumë pak vëmendje i kushtohet trajnimit të individëve në menaxhimin e mençur të jetës personale. Njohuritë e lëndës shikohen veçmas, me pak përpjekje për t'i stimuluar marrëdhëniet e ndërsjella.

Marrëdhëniet gjinore përfaqësohen kryesisht në mënyrë konservatore. Tekstet e matematikës, për shembull, pasqyrojnë një lloj verbërie për sa i përket problematikës gjinore dhe reduktohet në paraqitjen e një fotografie të djemve dhe vajzave së bashku, në rastin më të mirë. Zakonisht, djemtë janë ata që lidhen me matematikën, prandaj në këto libra janë më të shpeshta fotografitë me djem. Kjo flet më pak për diskriminimin, por flet shumë për një mentalitet të përgjithshëm.

Të gjitha këto dhe ndoshta problemet tjera të ngjashme kërkojnë një ndryshim rrënjësor në konceptet e pasqyruara në tekstet shkollore për njohuritë që u propozohen nxënësve t'i mësojnë. Një korrelacion i ri vlerash, njohurish dhe aplikimesh duhet të hulumtohet, të krijohet, të përfshihet në libra dhe të promovohet për të ndikuar në praktikën e mësimdhënësve në klasë.

Duke u larguar nga modeli i arsimit i orientuar në produkt, arsimi i obligueshëm mund të bëhet më efektiv në përgatitjen e nxënësve për sfidat e botës bashkëkohore. Kjo mund t'u ndihmojë atyre t'i zhvillojnë shkathtësitë e të nxënësve gjatë tërë jetës, përshtatshmërisë dhe shkathtësitë e të menduarit kritik, të cilat janë vendimtare për suksesin në shoqërinë e sotme që po ndryshon me shpejtësi.

3.3.2. Nga dokumentet e kurrikulës tek zbatimi i kurrikulës

Reforma e kurrikulës nuk nënkupton vetëm prodhimin e dokumenteve. Reforma është një proces i gjallë që përfshin të gjithë komponentët e infrastrukturës arsimore. Gjendja aktuale e arsimit të obligueshëm në Kosovë nxjerr në pah dikotominë e dy llojeve të performancës së nxënësve: tipin tradicional që ende e përfaqëson shumicën, të përqendruar në riprodhimin e informatave, dhe tipi emergjent, i propozuar nga kurrikula e re, i përqendruar në zhvillimin e aftësive intelektuale të nxënësve dhe kapacitetet e tij/saj për t'u integruar në shoqëri dhe familje.

Kjo dikotomi është e pranishme edhe përbrenda dokumenteve të kurrikulës; në shumë raste, kurrikula e lëndëve pasqyron atë prirje të fortë për të dhënë shumë informata, ndonjëherë mbi kapacitetin e nxënësve të sotëm për t'i përpunuar at në një moshë të caktuar, informata që shkaktojnë mbingarkesë të përmbajtjes, të dëmshme për përdorimin aktiv të këtyre informatave. Në mënyrë paradoksale, analiza e teksteve shkollore që synonte të kontrollonte përputhshmërinë e plotë me kurrikulën e lëndës, ka zbuluar se edhe kurrikulat e lëndëve duhet të rishikohen për t'i shërbyer më mirë objektivave të kornizës së kurrikulës dhe kurrikulës bërthamë.

Për ta zbatuar filozofinë e re që promovohet në kornizën e kurrikulës, nevojitet mbështetje e vazhdueshme, mentorim dhe ngritje të kapaciteteve për mësimdhënësit, drejtuesit e shkollave dhe anëtarët e komunitetit. Kjo mund të përfshijë trajnime shtesë, mundësi rrjetëzimi dhe burime për ta nxitur rritjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm.

3.4. Implikimet për trajnimin e mësimdhënësve

Vetë reforma kurrikulare ka çuar në zhvillimin e dikotomisë së cekur më lartë lidhur me arsimin e obligueshëm: njëra i përket botës së riprodhimit kognitiv dhe tjetra botës së orientimit formativ. Për të sjellë më shumë njerëz në atë botën e dytë, mund të ndërmerren disa veprime konkrete. Disa rekomandime, të cilat përfshijnë strukturat dhe metodologjitë e aftësimit të mësimdhënësve, si dhe lidhjen e fortë ndërmjet kurrikulës dhe vlerësimit, janë paraqitur më poshtë.

Korniza e Kurrikulës së Kosovës dhe Kurrikula bërthamë i përshkruajnë në mënyrë bujare vlerat, qëndrimet, aftësitë që duhen zhvilluar tek nxënësit. Tekstet shkollore janë të bazuara në lëndë, ndërsa trajnimi për zbatimin e kurrikulës së re ishte kryesisht i përgjithshëm, i fokusuar në mënyrë të pamjaftueshme në lëndë specifike e sidomos në implikimet didaktike që kanë dalur nga kurrikula e re. Prandaj, puna e vështirë e zbatimit të kurrikulës së re ra në masë të madhe (vetëm) në tekstet shkollore.

Institucionet përgjegjëse për aftësimin fillestar të mësimdhënësve, si dhe për aftësimin e tyre të vazhdueshëm duhet të fokusohen në mënyrë konsistente në analizë, diskutim dhe aplikim të opsioneve të reja kurrikulare. Është me rëndësi që institucionet e arsimit të lartë, në të cilat zhvillohet aftësimi fillestar i mësimdhënësve, ta marrin këtë detyrë me përgjegjësi të plotë.

Vlen të përmendet se në përgjithësi, universitetet dhe institucionet tjera të arsimit të lartë kanë një mision tjetër të orientuar drejt aftësimit të specialistëve në lëndë të diferencuara akademike dhe jo drejt aftësimit të mësimdhënësve për arsimin para-universitar.

Nga pikëpamja institucionale, potenciali për nxitjen e reformës kurrikulare zvogëlohet për sa kohë që sistemi i aftësimit fillestar dhe të mëtejshëm të mësimdhënësve mbahet në një pozicion dytësor ose në një pozicion të nënshtruar ndaj misionëve tjerë të arsimit të lartë. Në këto rrethana, Instituti Pedagogjik i Kosovës mund të bëhet një hallkë relevante për përmirësimin e situatës, në njërën anë për zhvillimin e aftësimin në-shërbim të mësimdhënësve, dhe në anën tjetër për mbështetjen e nevojave të mësimdhënësve për përvoja të reja mësimore me hulumtime autentike.

Për të ndryshuar qasjen nga shikimi i njohurive si produkt në shikimin e njohurive si një proces, programet e aftësimin të mësimdhënësve mund ta zbatojnë një listë të strategjive, e që janë:

- *Theksimi i pedagogjisë specifike të lëndës ndaj përmbajtjes.* Programet e aftësimin të mësimdhënësve duhet të fokusohen në pajisjen e edukatorëve të ardhshëm me strategji dhe metodologji efektive të mësimdhënies specifike për lëndën e caktuar, në vend që të përqendrohen vetëm në njohuritë e përmbajtjes. Ky ndryshim mund t'u ndihmojë mësimdhënësve ta kuptojnë rëndësinë e udhëzimit të nxënësve nëpërmjet procesit të të nxënës të një disipline të caktuar dhe jo vetëm në dhënien e informatave.

- *Promovimi i të nxënës të bazuar në kërkim në lëndë të ndryshme shkollore.* Programet e aftësimin të mësimdhënësve mund të përfshijnë mjedise praktike specifike për lëndët për ta theksuar rëndësinë e të nxënës të bazuar në kërkim, ku nxënës i eksplorojnë dhe hulumtojnë në mënyrë aktive konceptet e një disipline të caktuar e jo të marrin informata në mënyrë pasive. Kjo qasje e inkurajon të menduarit kritik, shkathtësitë për zgjidhjen e problemeve dhe një kuptim më të thellë të lëndës për mësimdhënësit dhe do të krijojë pre-misa të mira për ta transferuar këtë lloj mësimi tek nxënës.

- *Inkurajimi i bashkëpunimit dhe reflektimit gjatë mësimdhënies së lëndëve të ndryshme.* Programet e aftësimin të mësimdhënësve duhet të krijojnë mundësi për edukatorët që të bashkëpunojnë dhe të reflektojnë mbi praktikën e tyre të mësimdhënies. Duke i ndarë përvojat, duke i diskutuar sfidat dhe duke mësuar nga njëri-tjetri, mësimdhënësit mund ta zhvillojnë një qasje më të orientuar drejt procesit ndaj njohurive. Programet e tilla mund të jenë më efektive kur i bashkojnë mësimdhënësit nga e njëjta fushë kurrikulare ose nga fushat "e afërta" kurrikulare.

- *Përfshirja e integritit të teknologjisë.* Për t'u ofruar nxënësve mjete për hulumtime të pavarura, bashkëpunim dhe nxënie të vetë-drejtuar, mësimdhënësit duhet të ekspozohen ndaj këtyre llojeve të përvojave ndërsa përgatiten për profesionin. Prandaj, programet e aftësimin të mësuesve duhet t'i pajisin edukatorët me shkathtësi të nevojshme për ta integruar në mënyrë efektive teknologjinë në praktikën e tyre të mësimdhënies.

- *Ofrimi i programeve të mentorimit në nivel shkolle.* Duhet të krijohen programe të mento-imit, ku mësimdhënësit me përvojë i udhëheqin dhe i mbështesin edukatorët e rinj në kalimin e tyre nga një qasje e orientuar në produkt në një qasje të orientuar në proces. Ky udhëzim i personalizuar mund t'i ndihmojë mësimdhënësit t'i kuptojnë përfitimet dhe sfidat e adoptimit të një qasjeje të re dhe të ofrojnë strategji praktike për zbatim.

- *Angazhimi në hulumtime dhe inovacion.* Institucionet e aftësisimit të mësimdhënësve duhet të angazhohen aktivisht në hulumtim dhe inovacionin arsimor. Nëpërmjet hulumtimit, ata mund të zbulojnë praktika të bazuara në dëshmi që e mbështesin një qasje të orientuar në proces ndaj njohurive. Duke u përditësuar mbi të gjeturat e fundit të hulumtimeve dhe metodave inovative të mësimdhënies, institucionet mund t'i udhëheqin edukatorët në zbatimin e strategjive efektive.

- *Bashkëpunimi me shkollat dhe komunitetet.* Institucionet për aftësimin e mësimdhënësve duhet të bashkëpunojnë me shkollat dhe komunitetet për të krijuar një ekosistem mësimor mbështetës. Ky bashkëpunim mund të përfshijë partneritete me shkollat për të ofruar mundësi të aftësisimit praktik për edukatorët aspirues dhe për t'u angazhuar me komunitetet në mënyrë që të kuptohen nevojat e tyre arsimore. Këto partneritete mund të ndihmojnë po ashtu në nxitjen e një mjedisi që i vlerëson njohurinë si një proces.

Në përgjithësi, ndryshimi i qasjes nga shikimi i njohurive si produkt në ndërtimin e njohurive si proces kërkon një përpjekje gjithëpërfshirëse nga programet e aftësisimit të mësimdhënësve. Duke u fokusuar në pedagogjinë e bazuar në lëndë, të nxënësve të bazuar në hulumtime, bashkëpunimin, integrimin e teknologjisë, të nxënësve gjatë tërë jetës, mentorimin, hulumtimin dhe angazhimin e komunitetit, institucionet e përfshira në aftësimin e mësimdhënësve mund t'u ndihmojnë edukatorëve të adoptojnë një qasje të orientuar në proces ndaj njohurive, që çojnë në përvoja mësimore më efektive dhe kuptimplota për nxënësit. Të gjitha këto do të kenë një ndikim organik në strukturën dhe përmbajtjen e teksteve të ardhshme shkollare dhe burimeve tjera mësimore, pasi që tekstet alternative shërbejnë për ta sintetizuar tërë logjikën e re të mësimdhënies dhe përfaqësojnë rrugën kryesore për ta rritur fleksibilitetin dhe përshtatjen e proceseve didaktike ndaj veçorive specifike të klasave të ndryshme.

3.5. Implikimet për zbatimin e kurrikulës dhe vlerësimin

Për sa i përket pikës së lartpërmendur, duhet vënë në dukje tensionet ndërmjet reformës kurrikulare nga njëra anë që promovohet nga korniza e kurrikulës dhe kurrikula bërthamë, dhe nga ana tjetër praktikën e vlerësimit që pasqyrohet në tekstet shkollare dhe në klasë. E para synon të orientohet drejt arsimit formativ, ndërkohë që vlerësimi ka ende si një nga efektet e tij riprodhimin e formës klasike të arsimit ku informatat asimilohen dhe riprodhohen. Metodatat aktuale të vlerësimit nuk janë ende konvergjente me kërkesat e kurrikulës së re. Ato ende përpiqen ta ruajnë praktikën e vjetër të testimit të shkallës së riprodhimit të njohurive. Reforma e kurrikulës do të ketë efekte të papërfillshme vetëm nëse vlerësimet aktuale dhe provimet kombëtare vazhdojnë të jenë të orientuara drejt riprodhimit.

Për t'i vlerësuar në mënyrë efektive kompetencat e nxënësve dhe për të ofruar informata kthyesë të vlefshme për të nxënësit dhe zhvillimin e tyre, disa ndryshime të mëdha duhet të bëhen në strategjitë e vlerësimit. Disa propozime janë përmendur më poshtë.

- Emërimi i një strukture/departamenti/institucioni përgjegjës për reformimin e vlerësimit.
- Krijimi i grupeve punuese për lëndë specifike, të përbërë nga specialistë të kurrikulës, edukatorë, studiues dhe ekspertë të jashtëm për t'i zhvilluar, rishikuar dhe validuar rregullisht mjetet e vlerësimit.

Kjo strukturë dhe grupet punuese përcjellëse duhet të kenë parasysh:

► Zhvillimi i hartave të përparimit. Hartimi, për çdo lëndë mësimore, i matricave të kompetencave që tregojnë përparimin në kompleksitetin e kompetencave përgjatë klasave në shkollë, të cilat përfshijnë njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet që nxënësit pritët t'i përvetësojnë në çdo klasë. Këto harta të përparimit do të kontribuojnë gjithashtu në ekuilibrimin e shpërndarjes së përmbajtjes përgjatë klasave, duke mundësuar një rishikim të pa penguar të kurrikulës së lëndëve.

► Trajnime dhe udhëzime për mësimdhënësit. Programet dhe burimet për zhvillimin profesional të mësimdhënësve, të organizuara sipas lëndëve ose fushave kurrikulare (për të dhënë shumë shembuj konkretë), duhet t'u ndihmojnë atyre të familjarizohen me:

- strategjitë për hartimin dhe zbatimin e vlerësimeve që matin me saktësi përparimin e kompetencave të nxënësve
- përdorimin efektiv të strategjive të vlerësimit formativ dhe sumativ të lëndëve specifike për ta mbështetur të nxënit e nxënësve.
- integrimin e metodave të ndryshme të vlerësimit, si testet praktike, projektet, portfoliot dhe prezantimet me gojë, për ta vlerësuar në mënyrë efektive kompetencën e nxënësve.
- mekanizmat e dhënies së informatave kthyesë për të ofruar informata kthyesë informuese dhe në kohë për nxënësit lidhur me performancën e tyre dhe fushat për përmirësim.
- fleksibilitetin dhe diferencimin në nivel klase, duke i njohur stilet dhe aftësitë e ndryshme të të nxënit të nxënësve, duke mundësuar vlerësime të diferencuara, duke i akomoduar nevojat dhe preferencat individuale dhe duke ofruar metoda alternative të vlerësimit dhe akomodime për nxënësit me aftësi të kufizuara ose nevoja të veçanta arsimore.
- strategjitë për ta nxitur një dialog të vazhdueshëm ndërmjet mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve/kujdestarëve për t'i diskutuar rezultatet e vlerësimit dhe për t'i identifikuar fushat ku mund të nevojitet mbështetje shtesë.

► Strategjia e vlerësimit e bazuar në kompetenca në nivel kombëtar dhe rajonal. Një strategji kombëtare për reformimin e vlerësimit mund të ketë për qëllim që të:

- Eksploroj përdorimin e sistemeve të vlerësimit të bazuara në kompetenca që fokusohen në rritjen dhe përparimin individual e jo në notimin/notimin tradicional të nxënësve.
- Aplikoni një sistem të moderimit të jashtëm për të siguruar besueshmërinë dhe vlefshmërinë e proceseve të vlerësimit nëpër shkolla të ndryshme.
- Realizoni auditime periodike për të vlerësuar efektivitetin dhe konsistencën e kornizës së vlerësimit, duke identifikuar fushat për përmirësim dhe duke zbatuar përshtatjet e nevojshme.
- Promovoni përdorimin e platformave digjitale ose portfoliove të nxënësve për t'u mundësuar nxënësve që ta përcjellin përparimin e tyre dhe promovoni arritjet e tyre.
- Rishqyrtoni provimet e diplomimit: Testi i arritshmërisë në përfundim të arsimit të obligueshëm dhe të provimit të Maturës, për t'i bërë ato më në harmoni me filozofinë e re të vlerësimit.
- ▶ Sigurimi i cilësisë së proceseve të vlerësimit. Duhet të krijohet një mekanizëm i sigurimit të cilësisë për të siguruar që procedurat e vlerësimit të jenë të përditësuara dhe konsistente në tërë sistemin arsimor. Kjo mund të ketë parasysh:
 - Promovoni nismat hulumtuese për të analizuar efektivitetin dhe ndikimin e kurrikulës së bazuar në kompetenca dhe praktikave të vlerësimit të saj.
 - Bashkëpunoni me institucionet arsimore hulumtuese dhe ekspertët për t'i vlerësuar rezultatet e kornizës së vlerësimit dhe për t'i identifikuar fushat për përmirësim të mëtejshëm.
 - Rishikoni dhe përditësoni rregullisht politikat dhe praktikën e vlerësimit bazuar në gjetjet e hulumtimit të bazuar në dëshmi dhe informatat kthyesë nga palët e interesit.

Në vend të një përfundimi të prerë, ky raport përfundon me një listë pyetjesh. Puna për rishikimin e teksteve shkollore filloi dhe mbeti me një listë tensionesh dhe kontradiktash, të cilat u shfaqën pak a shumë në mënyrë eksplicite gjatë procesit. Këto tensione dhe kontradikta mbeten ende dhe ftojnë për reflektim të thellë:

Prandaj, si mundemi ne si vendimmarrës, drejtues të arsimit, studiues, mësimdhënës...

- Ta zvogëlojmë tendencën e 'mësimdhënies dhe të nxënit përmendësh' e cila aktualisht pranohet si 'e paracaktuar'?
- Të krijohen mundësi për agjencinë koherente të nxënësve dhe mësimdhënësve në një sistem miratimi dhe vendimi të centralizuar, me disa lëvizje kaotike brenda?
- Të promovohet kreativiteti, të menduarit autonom dhe shkathtësitë tjera të shekullit 21 për nxënësit, nëse këto nuk promovohen për mësimdhënësit, të cilët janë të përzgjedhur nga struktura qendrore dhe paguhen në mënyrë uniforme?
- Të krijohen ato situata të të nxënit që plotësojnë përkufizimin e qasjes së bazuar në kompetenca, por që janë 'të padukshme' dhe të cilat nuk hasen kurrë në përgatitjen fillestare dhe gjatë shërbimit të mësimdhënësve, e as tek autorët e teksteve shkollore?
- Të mbështetet vlerësimi formativ si vlerësim që synon ta mbështesë përparimin e nxënësve në mësim dhe jo për ta bërë rangimin e nxënësve dhe për t'i gjurmuar gabimet e tyre?
- Të akomodohet nevoja për ndryshim kur ndryshimi përballet me kaq shumë pengesa konceptuale, mendore dhe praktike-institucionale?

Përmirësimi i Arsimit: Raport mbi Procesin e Rishikimit të Teksteve Shkollore për Arsimin e Obligueshëm (Faza 1)

SHTOJCA: Përmbledhje e grafikëve që pasqyrojnë të gjeturat kryesore të procesit të rishikimit për tekstet shkollore të gjuhës shqipe dhe matematikës që përdoren në vitet 2022-2023 në arsimin e obligueshëm.

Grafikët përshkruajnë nivelin e arritshmërisë së tekstit shkollor sipas pesë kriterëve për rishikimin e teksteve (përafrimi kurrikulës, saktësia e përmbajtjes, efektiviteti i strategjive të të nxënit, saktësia dhe qasja e gjuhës, cilësia e paraqitjes dhe dizajnit) dhe rezultatet përmbledhëse të raporteve të nivelit të arritshmërisë të 25 përshkruesve të përfshirë në kriteret.

Për të ofruar një pasqyrë të shkurtër të rezultateve, nivelet e arritjeve janë ndarë vetëm në dy kategori: në librat që kanë arritur të përmbushin kriterin **në masë të madhe**, ose niveli i arritshmërisë është i **pamjaftueshëm**. Të dhënat e hollësishme të rishimit të secilit tekst shkollor dhe rekomandimet për përmirësim mund të gjenden në çdo raport rishikimit të tekst shkollore veç e veç.


Grafikët janë zhvilluar bazuar në 38 raportet e rishikimit të prodhuara nga ekipet e recensentëve dhe pasqyrojnë pikëpamjet e recensentëve për tekstet shkollore të analizuar.

GJUHA SHQIPE SHK1

7 TEKSTE SHKOLLORE

1. BASHKËRENDIMI I KURRIKULËS

	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
E strukturuar në njësi mësimore të qarta dhe të balancuara	2	5
E fokusuar në zhvillimin e kompetencave	5	2
Mbulon njohuritë dhe aftësitë që kanë në themel kompetencat	6	1
I trajton qëndrimet dhe vlerat	1	6
Përfshin detyrat e vlerësimit në përputhje me kompetencat	2	5
	16	19




GJUHA SHQIPE SHK2

6 TEKSTE SHKOLLORE

1. BASHKËRËNDIMI I KURRIKULËS

	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
E strukturuar në njësi mësimore të qarta dhe të balancuara	4	2
E fokusuar në zhvillimin e kompetencave	6	0
Mbulon njohuritë dhe aftësitë që kanë në themel kompetencat	2	4
I trajton qëndrimet dhe vlerat	0	6
Përfshin detyrat e vlerësimit në përputhje me kompetencat	1	5
	13	17




GJUHA SHQIPE SHK3

4 TEKSTE SHKOLLORE

1. BASHKËRËNDIMI I KURRIKULËS

	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
E strukturuar në njësi mësimore të qarta dhe të balancuara	2	2
E fokusuar në zhvillimin e kompetencave	2	2
Mbulon njohuritë dhe aftësitë që kanë në thelmet kompetencat	2	2
I trajton qëndrimet dhe vlerat	1	3
Përfshin detyrat e vlerësimit në përputhje me kompetencat	2	2
	9	11




GJUHA SHQIPE SHK4

4 TEKSTE SHKOLLORE

1. BASHKËRENDIMI I KURRIKULËS

	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
E strukturuar në njësi mësimore të qarta dhe të balancuara	3	1
E fokusuar në zhvillimin e kompetencave	3	1
Mbulon njohuritë dhe aftësitë që kanë në themel kompetencat	3	1
I trajton qëndrimet dhe vlerat	4	
Përfshin detyrat e vlerësimit në përputhje me kompetencat	3	1
	16	4




MATEMATIKA SHK1

5 TEKSTE SHKOLLORE

1. BASHKËRËNDIMI I KURRIKULËS

	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
E strukturuar në njësi mësimore të qarta dhe të balancuara	1	4
E fokusuar në zhvillimin e kompetencave	1	4
Mbulon njohuritë dhe aftësitë që kanë në themel kompetencat	4	1
I trajton qëndrimet dhe vlerat	3	2
Përfshin detyrat e vlerësimit në përputhje me kompetencat	2	3
	11	14




MATEMATIKA SHK2

6 TEKSTE SHKOLLORE

1. BASHKËRËNDIMI I KURRIKULËS

	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
E strukturuar në njësi mësimore të qarta dhe të balancuara	4	2
E fokusuar në zhvillimin e kompetencave	5	1
Mbulon njohuritë dhe aftësitë që kanë në themel kompetencat	6	
I trajton qëndrimet dhe vlerat	5	1
Përfshin detyrat e vlerësimit në përputhje me kompetencat	6	
	26	4




MATEMATIKA SHK3

2 TEKSTE SHKOLLORE

1. BASHKËRËNDIMI I KURRIKULËS

	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
E strukturuar në njësi mësimore të qarta dhe të balancuara	1	1
E fokusuar në zhvillimin e kompetencave	0	2
Mbulon njohuritë dhe aftësitë që kanë në themel kompetencat	1	1
I trajton qëndrimet dhe vlerat	1	1
Përfshin detyrat e vlerësimit në përputhje me kompetencat	1	1
	4	6




MATEMATIKA SHK4

4 TEKSTE SHKOLLORE

1. BASHKËRËNDIMI I KURRIKULËS

	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
E strukturuar në njësi mësimore të qarta dhe të balancuara	4	0
E fokusuar në zhvillimin e kompetencave	2	2
Mbulon njohuritë dhe aftësitë që kanë në themel kompetencat	1	3
I trajton qëndrimet dhe vlerat	0	4
Përfshin detyrat e vlerësimit në përputhje me kompetencat	1	3
	8	12




GJUHA SHQIPE SHK 1

7 TEKSTE SHKOLLORE

2. SAKTËSIA E PËRMBAJTJES

	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
Pasqyron kulturën dhe traditat e Kosovës	4	3
Ka karakter etik, moral dhe jo-diskriminues	7	0
Bazohet në fakte dhe informacione të verifikuara	7	0
Është paraqitur në mënyrë koherente dhe logjike	7	0
Përmban temat e përcaktuara nga kurrikula	4	3
I përshatet grup moshës	5	2
Përfshin detyrat e vlerësimit tradicional dhe alternativ	5	2
	39	10




GJUHA SHQIPE SHK 2

6 TEKSTE SHKOLLORE

2. SAKTËSIA E PËRMBAJTJES

	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
Pasqyron kulturën dhe traditat e Kosovës	4	2
Ka karakter etik, moral dhe jo-diskriminues	6	0
Bazohet në fakte dhe informacione të verifikuara	6	0
Është paraqitur në mënyrë koherente dhe logjike	6	0
Përmban temat e përcaktuara nga kurrikula	1	5
I përshkruan grup moshës	4	2
Përfshin detyrat e vlerësimit tradicional dhe alternativ	6	
	33	9




GJUHA SHQIPE SHK 3

4 TEKSTE SHKOLLORE

2. SAKTËSIA E PËRMBAJTJES

	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
Pasqyron kulturën dhe traditat e Kosovës	3	1
Ka karakter etik, moral dhe jo-diskriminues	2	2
Bazohet në fakte dhe informacione të verifikuara	3	1
Është paraqitur në mënyrë koherente dhe logjike	1	3
Përmban temat e përcaktuara nga kurrikula	2	2
I përshkaton grup moshës		4
Përfshin detyrat e vlerësimit tradicional dhe alternativ	3	1
	14	14




GJUHA SHQIPE SHK 4

4 TEKSTE SHKOLLORE

2. SAKTËSIA E PËRMBAJTJES

	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
Pasqyron kulturën dhe traditat e Kosovës	4	0
Ka karakter etik, moral dhe jo-diskriminues	3	1
Bazohet në fakte dhe informacione të verifikuara	4	0
Është paraqitur në mënyrë koherente dhe logjike	4	0
Përmban temat e përcaktuara nga kurrikula	4	0
I përshtatet grup moshës	3	1
Përfshin detyrat e vlerësimit tradicional dhe alternativ	4	0
	26	2




MATEMATIKA SHK1

5 TEKSTE SHKOLLORE

2. SAKTËSIA E PËRMBAJTJES

	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
Pasqyron kulturën dhe traditat e Kosovës	1	4
Ka karakter etik, moral dhe jo-diskriminues	5	0
Bazohet në fakte dhe informacione të verifikuara	5	0
Është paraqitur në mënyrë koherente dhe logjike	3	2
Përban temat e përcaktuara nga kurrikula	2	3
I përshatet grup moshës	4	1
Përfshin detyrat e vlerësimit tradicional dhe alternativ	1	4
	21	14




MATEMATIKA SHK2

6 TEKSTE SHKOLLORE

2. SAKTËSIA E PËRMBAJTJES

	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
Pasqyron kulturën dhe traditat e Kosovës	3	3
Ka karakter etik, moral dhe jo-diskriminues	6	
Bazohet në fakte dhe informacione të verifikuara	5	1
Është paraqitur në mënyrë koherente dhe logjike	5	1
Përmban temat e përcaktuara nga kurrikula	3	3
I përshatet grup moshës	4	2
Përfshin detyrat e vlerësimit tradicional dhe alternativ	5	1
	31	11




MATEMATIKA SHK3

2 TEKSTE SHKOLLORE

2. SAKTËSIA E PËRMBAJTJES

	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
Pasqyron kulturën dhe traditat e Kosovës	0	2
Ka karakter etik, moral dhe jo-diskriminues	2	0
Bazohet në fakte dhe informacione të verifikuara	2	0
Është paraqitur në mënyrë koherente dhe logjike	1	1
Përmban temat e përcaktuara nga kurrikula	2	0
I përshatet grup moshës	2	0
Përfshin detyrat e vlerësimit tradicional dhe alternativ	0	2
	9	5




MATEMATIKA SHK4

4 TEKSTE SHKOLLORE

2. SAKTËSIA E PËRMBAJTJES

	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
Pasqyron kulturën dhe traditat e Kosovës	0	4
Ka karakter etik, moral dhe jo-diskriminues	4	0
Bazohet në fakte dhe informacione të verifikuara	4	0
Është paraqitur në mënyrë koherente dhe logjike	2	2
Përban temat e përcaktuara nga kurrikula	3	1
I përshatet grup moshës	4	0
Përfshin detyrat e vlerësimit tradicional dhe alternativ	1	3
	18	10




GJUHA SHQIPE SHK1

7 TEKSTE SHKOLLORE

3. EFEKTIVITETI I STRATEGJIVE TË TË NXËNIT

	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
Ka përparim nga e thjeshta në të ndërlikuarën	2	5
Përfshin ushtrime për zhvillimin e shkathhtësive themelore	5	2
Motivon të nxënëit dhe e stimulon kreativitetin	1	6
Stimulon të nxënëit aktiv dhe të bazuar në kërkim	2	5
Ka ndërlidhje me botën reale	7	
Promovon të nxënëit e diferencuar	1	6
Inkurajon të menduarit e nivelit më të lartë	2	5
Përfshin vlerësimin formativ dhe atë sumativ	1	6
Është inter-disiplinare	6	1




GJUHA SHQIPE SHK2

6 TEKSTE SHKOLLORE

3. EFEKTIVITETI I STRATEGJIVE TË TË NXËNIT

	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
Ka përparim nga e thjeshta në të ndërlikuarën	6	
Përfshin ushtrime për zhvillimin e shkathhtësive themelore	6	0
Motivon të nxënëit dhe e stimulon kreativitetin	6	0
Stimulon të nxënëit aktiv dhe të bazuar në kërkim	2	4
Ka ndërlidhje me botën reale	6	
Promovon të nxënëit e diferencuar	2	4
Inkurajon të menduarit e nivelit më të lartë	1	5
Përfshin vlerësimin formativ dhe atë sumativ	6	0
Është inter-disiplinare	6	
	41	13




GJUHA SHQIPE SHK3

4 TEKSTE SHKOLLORE

3. EFEKTIVITETI I STRATEGJIVE TË TË NXËNIT

	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
Ka përparim nga e thjeshta në të ndërlikuarën	1	3
Përfshin ushtrime për zhvillimin e shkathhtësive themelore	1	3
Motivon të nxënëit dhe e stimulon kreativitetin	1	3
Stimulon të nxënëit aktiv dhe të bazuar në kërkim	1	3
Ka ndërlidhje me botën reale	1	3
Promovon të nxënëit e diferencuar		4
Inkurajon të menduarit e nivelit më të lartë	1	3
Përfshin vlerësimin formativ dhe atë sumativ	2	2
Është inter-disiplinare	2	2
	10	26




GJUHA SHQIPE SHK4

4 TEKSTE SHKOLLORE

3. EFEKTIVITETI I STRATEGJIVE TË TË NXËNIT

	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
Ka përparim nga e thjeshta në të ndërlikuarën	3	1
Përfshin ushtrime për zhvillimin e shkathtësive themelore	3	1
Motivon të nxënëit dhe e stimulon kreativitetin	3	1
Stimulon të nxënëit aktiv dhe të bazuar në kërkim	2	2
Ka ndërlidhje me botën reale	3	1
Promovon të nxënëit e diferencuar	2	1
Inkurajon të menduarit e nivelit më të lartë	4	1
Përfshin vlerësimin formativ dhe atë sumativ	4	
Është inter-disiplinare	3	1
	27	9




MATEMATIKA SHK1

5 TEKSTE SHKOLLORE

3. EFEKTIVITETI I STRATEGJIVE TË TË NXËNIT

	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
Ka përparim nga e thjeshta në të ndërlikuarën	3	2
Përfshin ushtrime për zhvillimin e shkathhtësive themelore	4	1
Motivon të nxënëit dhe e stimulon kreativitetin	3	2
Stimulon të nxënëit aktiv dhe të bazuar në kërkim	4	1
Ka ndërlidhje me botën reale	5	0
Promovon të nxënëit e diferencuar	1	4
Inkurajon të menduarit e nivelit më të lartë	4	1
Përfshin vlerësimin formativ dhe atë sumativ	1	4
Është inter-disiplinare	5	0
	30	15




MATEMATIKA SHK2

6 TEKSTE SHKOLLORE

3. EFEKTIVITETI I STRATEGJIVE TË TË NXËNIT

	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
Ka përparim nga e thjeshta në të ndërlikuarën	5	1
Përfshin ushtrime për zhvillimin e shkathhtësive themelore	5	1
Motivon të nxënëit dhe e stimulon kreativitetin	4	2
Stimulon të nxënëit aktiv dhe të bazuar në kërkim	2	4
Ka ndërlidhje me botën reale	3	3
Promovon të nxënëit e diferencuar	5	1
Inkurajon të menduarit e nivelit më të lartë	6	0
Përfshin vlerësimin formativ dhe atë sumativ	5	1
Është inter-disiplinare	6	
	41	13




MATEMATIKA SHK3

2 TEKSTE SHKOLLORE

3. EFEKTIVITETI I STRATEGJIVE TË TË NXËNIT

	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
Ka përparim nga e thjeshta në të ndërlikuarën	1	1
Përfshin ushtrime për zhvillimin e shkathtësive themelore	2	0
Motivon të nxënëit dhe e stimulon kreativitetin	0	2
Stimulon të nxënëit aktiv dhe të bazuar në kërkim	0	2
Ka ndërlidhje me botën reale	0	2
Promovon të nxënëit e diferencuar	0	2
Inkurajon të menduarit e nivelit më të lartë	1	1
Përfshin vlerësimin formativ dhe atë sumativ	1	1
Është inter-disiplinare	0	2
	5	13




MATEMATIKA SHK4

4 TEKSTE SHKOLLORE

3. EFEKTIVITETI I STRATEGJIVE TË TË NXËNIT


	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
Ka përparim nga e thjeshta në të ndërlikuarën	4	0
Përfshin ushtrime për zhvillimin e shkathtësive themelore	1	3
Motivon të nxënëit dhe e stimulon kreativitetin	1	3
Stimulon të nxënëit aktiv dhe të bazuar në kërkim	1	3
Ka ndërlidhje me botën reale	2	2
Promovon të nxënëit e diferencuar	1	3
Inkurajon të menduarit e nivelit më të lartë	1	3
Përfshin vlerësimin formativ dhe atë sumativ	1	3
Është inter-disiplinare	2	2
	14	22



GJUHA SHQIPE SHK1
7 TEKSTE SHKOLLORE

4. SAKTËSIA DHE QASJA E GJUHËS

	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
Saktësia e gjuhës; pa gabime tipografike	4	3
E lexueshme	5	2
	9	5




GJUHA SHQIPE SHK2

6 TEKSTE SHKOLLORE

4. SAKTËSIA DHE QASJA E GJUHËS


	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
Saktësia e gjuhës; pa gabime tipografike	4	2
E lexueshme	3	3
	7	5



GJUHA SHQIPE SHK3
4 TEKSTE SHKOLLORE

4. SAKTËSIA DHE QASJA E GJUHËS


	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
Saktësia e gjuhës; pa gabime tipografike	1	3
E lexueshme	1	3
	2	6



GJUHA SHQIPE SHK4
4 TEKSTE SHKOLLORE

4. SAKTËSIA DHE QASJA E GJUHËS


	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
Saktësia e gjuhës; pa gabime tipografike	2	2
E lexueshme	3	1
	5	3



MATEMATIKA SHK1
5 TEKSTE SHKOLLORE

4. SAKTËSIA DHE QASJA E GJUHËS


	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
Saktësia e gjuhës; pa gabime tipografike	3	2
E lexueshme	2	3
	5	5



MATEMATIKA SHK2
6 TEKSTE SHKOLLORE

4. SAKTËSIA DHE QASJA E GJUHËS


		Shtirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
Saktësia e gjuhës; pa gabime tipografike		5	1
E lexueshme		2	4
		7	5



MATEMATIKA SHK3
2 TEKSTE SHKOLLORE


4. SAKTËSIA DHE QASJA E GJUHËS

	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
Saktësia e gjuhës; pa gabime tipografike	0	2
E lexueshme	1	1
	1	3



MATEMATIKA SHK4
4 TEKSTE SHKOLLORE
4. SAKTËSIA DHE QASJA E GJUHËS

	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
Saktësia e gjuhës; pa gabime tipografike	3	1
E lexueshme	2	2
	5	3




GJUHA SHQIPE SHK1

7 TEKSTE SHKOLLORE

5. CILËSIA E PARAQITJES DHE DIZAJNIT

	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
Cilësia e formatit dhe e dizajnit	2	5
Cilësia e grafikës dhe ilustrimeve	2	5
	4	10




GJUHA SHQIPE SHK2

6 TEKSTE SHKOLLORE

5. CILËSIA E PARAQITJES DHE DIZAJNIT

	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
Cilësia e formatit dhe e dizajnit	5	1
Cilësia e grafikës dhe ilustrimeve	3	3
	8	4




GJUHA SHQIPE SHK3

4 TEKSTE SHKOLLORE

5. CILËSIA E PARAQITJES DHE DIZAJNIT

	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
Cilësia e formatit dhe e dizajnit	1	3
Cilësia e grafikës dhe ilustrimeve	1	3
	2	6




GJUHA SHQIPE SHK4

4 TEKSTE SHKOLLORE

5. CILËSIA E PARAQITJES DHE DIZAJNIT

	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
Cilësia e formatit dhe e dizajnit	4	0
Cilësia e grafikës dhe ilustrimeve	2	2
	6	2




MATEMATIKA SHK1

5 TEKSTE SHKOLLORE

5. CILËSIA E PARAQITJES DHE DIZAJNIT

	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
Cilësia e formatit dhe e dizajnit	3	2
Cilësia e grafikës dhe ilustrimeve	2	3
	5	5




MATEMATIKA SHK2

6 TEKSTE SHKOLLORE

5. CILËSIA E PARAQITJES DHE DIZAJNIT

	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
Cilësia e formatit dhe e dizajnit	4	2
Cilësia e grafikës dhe ilustrimeve	3	3
	7	5




MATEMATIKA SHK3

2 TEKSTE SHKOLLORE

5. CILËSIA E PARAQITJES DHE DIZAJNIT

	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
Cilësia e formatit dhe e dizajnit	1	1
Cilësia e grafikës dhe ilustrimeve	0	2
	1	3




MATEMATIKA SHK4

4 TEKSTE SHKOLLORE

5. CILËSIA E PARAQITJES DHE DIZAJNIT

	Shtrirje e mjaftueshme	E pamjaftueshme
Cilësia e formatit dhe e dizajnit	3	1
Cilësia e grafikës dhe ilustrimeve	2	2
	5	3



Përmbledhje Ekzekutive
Përmirësimi i arsimit: Raport mbi
rishikimin e teksteve shkollore për
arsimin e obligueshëm (Faza 1)



Funded by
the European Union



KosEd

"Përkrahje për arsimin fillor dhe të mesëm të lartë"
"Support to basic and upper secondary education"

Përmbledhje Ekzekutive

Përmirësimi i arsimit: Raport mbi rishikimin e teksteve shkollore për arsimin e obligueshëm (Faza 1)

Hyrje

Tekstet shkollore shërbejnë si burime kryesore mësimi për nxënësit në të gjitha lëndët shkollore dhe nivelet e klasave dhe luajnë një rol kyç në pajisjen e nxënësve me njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet që janë të nevojshme për një karrierë të suksesshme.

Ky raport synon të ofrojë rekomandime të bazuara në dëshmi për politikë-bërësit, edukatorët dhe botuesit e teksteve shkollore për mënyrën se si mund të përmirësohen tekstet shkollore për t'i përmbushur më mirë këto nevoja në shkollat në Kosovë.

Çështja e teksteve shkollore është me interes të madh në Kosovë, krahasuar me shumë vende të tjera evropiane. Mësimdhënësit mbështeten në tekstet shkollore si një burim universal për mësim-nxënie dhe mësimdhënie dhe në hapësirën publike ekziston një shqetësim i vazhdueshëm lidhur me cilësinë e teksteve shkollore. Megjithatë, Edhe pse diskutimet joformale lidhur me cilësinë e këtyre teksteve shkollore janë të shpeshta, analizat profesionale janë relativisht të pakta.

Duke i marrë parasysh dëshmitë e mbledhura, duke përfshirë dëshmitë nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës (2015), nga KEEN (2018), Iniciativa e Rinisë për të Drejtat e Njeriut (2017), Qendra për Arsim e Kosovës (2021), Instituti Pedagogjik i Kosovës (2022), të cilat i raportuan të gjitha mangësitë e teksteve shkollore që janë në përdorim, MAHTI ka vendosur ta përdorë një mekanizëm vlerësimi të bazuar në kritere dhe përshkrues që do të mundësonte një analizë më profesionale dhe do të çonte në zgjidhje konkrete për përmirësimin e cilësisë së këtyre teksteve shkollore.

Procesi

Procesi i pilotimit ka konsistuar në një program për ngritjen e kapaciteteve për rishikimin e teksteve shkollore në fund të vitit shkollor 2022-23. Me mbështetjen e projektit KosEd, është zhvilluar ngritja e kapaciteteve të recensentëve të teksteve shkollore (Ekipet për rishikim). Ekipet e rishikimit kishin për detyrë ta realizonin një analizë profesionale të teksteve shkollore të bazuar në kritere. Faza e parë, faza pilot e këtij procesi synonte tekstet shkollore të gjuhës shqipe dhe matematikës për klasat 1 deri në 9.

Shpërndarja e numrit të teksteve për lëndë mësimore ishte si më poshtë: për gjuhën shqipe – 21 tekste dhe për matematikën – 17 tekste, ndërsa për shkallë kurrikulare shpërndarja ishte: ShK1 – 12, ShK2 – 12, ShK3 – 6, ShK4 – 8. Numri i teksteve shkollore për shtëpi botuese ishte si më poshtë: Albis – 11, Berati – 1, Dukagjini – 15, Dukagjini dhe Pegi -1, Libri shkollos – 3, Luarasi – 2, Magjia e librit – 1, Pegi – 5.

Tabela 1: Lista e teksteve shkollore të Gjuhës Shqipe të cilat janë rishikuar

ShK	ShK1		ShK2			ShK3		ShK4	
Notat	K1	K2	K3	K4	K5	K6	K7	K8	K9
Shtepia botuese									
Albas	1	1	1	1				1	1
Dukagjini	1	1	1	1	1	1	1		1
Dukagjini dhe Pegi (Abetare)	1								
Libri shkollor	1					1			
Magjia e librit	1								
Pegi			1			1			1
Totali	5	2	3	2	1	3	1	1	3
Totali per SHK	7		6			4		4	
Totali i përgjithshëm	21								

Tabela 2: Lista e teksteve shkollore të Matematikës të cilat janë rishikuar

ShK	ShK1		ShK2			ShK3		ShK4	
Notat	K1	K2	K3	K4	K5	K6	K7	K8	K9
Shtepia botuese									
Albas		1		1	1			1	
Berati				1					
Dukagjini	1	1		1	1	1	1	1	1
Libri shkollor		1							
Luarasi		1	1						
Pegi									1
Totali	1	4	1	3	2	1	1	2	2
Totali per ShK	5		6			2		4	
Totali i përgjithshëm	17								

Janë analizuar gjithsej 38 tekste shkollore. Për secilin tekst shkollor, ekipet e recensentëve kanë përpiluar raporte të detajuara me vëzhgime të bazuara në kritere dhe rekomandime për përmirësim. Për shkak të analizës së detajuar, raportet e rishikimit kanë më shumë se 600 faqe.

Të gjeturat dhe sugjerimet për përmirësim

Një prezantim sintetik i të gjeturave kryesore në raportet e rishikimit të teksteve shkollore është bërë nëpërmjet një varg grafikësh të përmbledhura në SHTOJCË: *Përmbledhje e grafikëve që pasqyrojnë të gjeturat kryesore të procesit të rishikimit të teksteve shkollore të gjuhës shqipe dhe matematikës që përdorën në vitet 2022-2023 në arsimin e obliqeshëm*. Grafikët e përshkruajnë nivelin e arritshmërisë së tekstit shkollor sipas pesë kritereve për rishikimin e teksteve (përafrimi me kurrikulë; saktësia e përmbajtjes; efektiviteti i strategjive të të nxëniet; saktësia dhe qasja e gjuhës; cilësia e prezantimit dhe dizajnit) dhe rezultatet përmbledhëse të raporteve të nivelit të arritshmërisë të 25 përshkruesve të përfshirë në kritere. Për të ofruar një pasqyrë të shkurtër të rezultateve, nivelet e arritshmërisë janë ndarë vetëm në dy kategori: në librat që kanë arritur ta përmbushin kriterin *në masë të madhe*, ose niveli i arritshmërisë është *i pamjaftueshëm*. Të dhënat e hollësishme të rishikimit të secilit tekst shkollor dhe rekomandimet për përmirësim mund të gjenden në çdo raport të rishikimit të teksteve shkollore veç e veç.

Në vijim, i gjeni të gjeturat kryesore të shoqëruara me propozime për përmirësim.

Konteksti ka rëndësi! Analiza e teksteve shkollore ka zbuluar se shumica e njësive mësimore ofrojnë mësim të de-kontekstualizuar dhe teorik. Megjithatë, të nxëniet kontekstual në tekstet shkollore u ndihmon nxënësve t'i kuptojnë konceptet komplekse duke i lidhur ato me situatat e tyre tashmë të eksperimentuara. Duke ofruar shembuj dhe raste studimi, tekstet shkollore ua lehtësojnë nxënësve që ta kuptojnë thelbin e lëndës. Duke e kontekstualizuar të nxëniet, tekstet shkollore mund të nxisin, po ashtu, zhvillimin e shkathtësive në disiplina të ndryshme dhe situata të botës reale, duke përfshirë të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve, komunikimin dhe bashkëpunimin.

Njësitë mësimore në një tekst shkollor duhet të fillojnë me shembuj ose situata problemore që nxënësit mund t'i hasin në mjedisin e tyre të ngushtë shoqëror/natyror, në mënyrë që të bëhet ndërlidhja ndërmjet lëndës dhe nivelit të të kuptuarit të nxënësve. Këta shembuj duhet ta nxisin zhvillimin e shkathtësive të nxënësve për zgjidhjen e problemeve në jetën e tyre të përditshme, si dhe të ndihmojnë në zhvillimin e të menduarit kritik dhe krijues dhe ta rrisin interesimin për ta mësuar lëndën.

Situatat e jetës reale duhet t'i përshkojnë tekstet shkollore. Shumë nga tekstet e analizuar nxjerrin në pah një pikëpamje akademike, abstrakte-teorike të lëndës. Kjo krijon refuzim tek nxënësit, të cilët mund të marrin informata nga burime tjera të ndryshme që pashmangshëm konkurrojnë me tekstet shkollore.

Situatat e jetës reale u ofrojnë nxënësve mundësinë për t'i zbatuar konceptet teorike në skenarë praktikë. Duke paraqitur shembuj dhe tregime autentike, tekstet shkollore e bëjnë të nxëniet relevant, të ndërlidhur dhe të zbatueshëm në botën reale. Kjo i inkurajon nxënësit të mendojnë në mënyrë kritike, t'i analizojnë problemet dhe t'i zhvillojnë shkathtësitë për zgjidhjen e problemeve. Gjithashtu, duke i ndërlidhur konceptet me jetën dhe përvojat e tyre, nxënësit kanë më shumë gjasa të qëndrojnë të angazhuar me materialin dhe të ndihen të motivuar për të mësuar. Situatat e jetës reale mund ta nxisin edhe kureshtjen dhe dëshirën për të hulumtuar më tutje, duke e nxitur të kuptuarit më të thellë të lëndës.

Kujtesa dhe memorizimi janë të rëndësishme për të nxënëit e qëndrueshëm, por ato duhet të shoqërohen dhe të balancohen nga zhvillimi i kreativitetit. Shumë nga tekstet shkollore fokusohen në mësimin përmendsh, memorizimin e procedurave dhe praktikimin e detyrave rutinore të de-kontekstualizuara. Të mësuarit përmendësh përfshin memorizimin e fakteve, koncepteve ose formulave pa i kuptuar domosdoshmërisht parimet themelore. Përderisa të mësuarit përmendësh mund të jetë i dobishëm në situata të caktuara, ai nuk është i mjaftueshëm për të kuptuar thellë dhe për të menduarit kritik.

Teksti shpjegues i shkruar duhet të jetë më i shkurtër, duhet të zvogëlohet edhe numri i detyrave rutinore që u paraqiten nxënësve për t'i zgjidhur, ndërsa në libra duhet të paraqiten më shumë detyra që kërkojnë arsyetimin, analizimin, interpretimin ose vlerësimin e nxënësit. Një tekst shkollor i suksesshëm tërheq vëmendjen dhe angazhon nxënësit në procesin e të nxënëit duke përfshirë aktivitete ndërvepruese, pyetje që nxisin mendimin dhe shembuj të jetës reale që mund ta ndezin kureshtjen, ta inkurajojnë të menduarit kritik dhe ta bëjnë përmbajtjen më të ndërlidhur dhe më kuptimplotë. Një tekst shkollor gjithëpërfshirës duhet të ofrojë shpjegime të koncepteve dhe procedurave (duke iu përgjigjur pyetjes “pse?”), shembuj të zbatimit në jetën reale dhe mundësi për nxënësit që ta zbatojnë të kuptuarit e tyre në skenarë praktikë ose përmes situatave të zgjidhjes së problemeve.

Shqisat vizuale dhe ato të të prekurit kontribuojnë shumë në të nxënëit efektiv. Shumë nga tekstet shkollore të analizuara shfaqin tekste të gjata me pak ilustrime, shpesh herë të parëndësishme për mesazhin që duan ta përcjellin.

Tekstet shkollore duhet të përfshijnë skema vizuale, tabela, lidhje me video edukative, etj. për ta përmirësuar kuptimin e konceptit. Për shembull, metoda e modelit të bllokut është një strategji vizuale e zhvilluar dhe e përdorur gjerësisht në tekstet shkollore dhe fletoret e lëndës së matematikës në Singapor. Kjo qasje ka ndikuar që nxënësit të kenë rezultate të shkëlqyeshme në testet e standardizuara ndërkombëtare si PISA ose TIMSS.

Detyrat praktike të përfshira në tekstet e gjuhës, siç janë vizita në një ekspozitë arti ose në tekstet e matematikës, siç janë ndërtimi i modeleve të formave 2D dhe 3D në gjeometri, mund ta përforcojnë të kuptuarit dhe të ndihmojnë në krijimin e lidhjeve ndërmjet teorisë dhe praktikës. Aktivitetet me të prekur, siç janë enigmat, fjalëkryqet, ndërtimi i blloqeve ose manipulorët, i inkurajojnë nxënësit të ndër-veprojnë fizikisht me materiale, duke e nxitur ndjenjën e kureshtjes dhe motivimit.

Përfshirja sociale është një vektor i zhvillimit në komunitetet bashkëkohore. Përfshirja sociale mund të theksohet në tekstet shkollore përmes ofrimit të burimeve për të nxënëit e diferencuar. Çështja e të nxënëit të diferencuar trajtohet rrallë në tekstet e analizuara në këtë drejtim; në rastet më të mira, tekstet e matematikës ofrojnë detyra të niveleve të ndryshme të vështirësisë, por zakonisht, këto detyra fokusohen në aftësimin për performancë në matematikë, e më pak në sigurimin, për shembull, të të nxënëit përmirësues.

Tekstet shkollore luajnë një rol thelbësor në formësimin e mendjeve të nxënësve dhe mund të ofrojnë mundësi për t'i bërë ata të mësojnë për dinamikën sociale, diversitetin dhe rëndësinë e të qenit gjithëpërfshirës. Duke e integruar përfshirjen sociale në tekstet shkollore, ne mund ta promovojmë vetëdijësimin, empatinë dhe pranimin në mesin e nxënësve.

Vlerat dhe qëndrimet pozitive janë thelbësore në ndërtimin e një kombi. Çuditërisht, referencat për kulturën dhe traditat vendore janë relativisht të pakta në tekstet e analizuara.

Tekstet shkollore të gjuhës dhe të matematikës duhet të përmbajnë elemente të kulturës dhe traditave të Kosovës për të kontribuar më mirë në synimet e arsimit parauniversitar dhe kërkesat e kurrikulës. Megjithatë, kjo duhet bërë me kujdes për ta shmangur indoktrinimin duke përfshirë kulturën dhe traditat vendore në një tekst shkollor dhe duke i zhvilluar vlerat dhe qëndrimet e qytetarisë. Në këtë drejtim mund të merren parasysh disa sugjerime. Tekstet shkollore mund të ofrojnë këndvështrime të balancuara dhe të larmishme mbi ngjarjet historike, praktikat kulturore dhe vlerat, duke u mundësuar nxënësve të formojnë opinionet e tyre bazuar në të kuptuarit dhe arsyeshmërinë. Po ashtu, shembujt dhe situatat e paraqitura në libra duhet ta theksojnë rëndësinë e respektimit të kulturave, traditave dhe perspektivave të ndryshme dhe ta inkurajojnë multi-kulturalizmin. Është po ashtu me rëndësi që të ofrohen perspektiva të shumta, si p.sh. përfshirja e tregimeve dhe historive nga sfonte të ndryshme kulturore.

Teknologjia është pjesë e jetës sonë sot. Teknologjia është përfshirë shumë rrallë në tekstet e analizuara. Megjithatë, ajo përfaqëson një dimension thelbësor të jetës sonë sot.

Një nga rezultatet e të nxënësve që promovohet në kurrikulat bërthamë është përdorimi i TIK-ut. Është e nevojshme që të promovohet përdorimi i teknologjisë për zgjidhjen e situatave matematikore, por edhe të aspekteve të tjera që ndërlidhen me gjuhët dhe jetën e njeriut në përgjithësi. Për të ndodhë kjo, është e dobishme që të demonstron se si teknologjia i lidh konceptet e teksteve shkollore me skenarët, industrinë ose profesionet e jetës reale. Kjo mund t'u ndihmojë nxënësve që ta kuptojnë rëndësinë praktike dhe t'i motivojnë ata që t'i hulumtojnë ato lidhje më tej duke e përdorur teknologjinë. Po ashtu, duke e inkurajuar përdorimin e teknologjisë për të krijuar grupe ose komunitete ku nxënësit mund të bashkëpunojnë në detyra, t'i ndajnë shënimet dhe të diskutojnë tema nga teksti shkollor, do të mund të stimulohej pjesëmarrja aktive dhe angazhimi.

Vlerësimi dhe vetë-vlerësimi janë mjetet kyçe për përparimin e të nxënësve. Një nga veçoritë e teksteve të analizuara është mungesa e vlerësimit ose përdorimi jo i duhur i metodave për vlerësimin aktual të nxënësve. Rekomandohet që të përfshihen, në çdo kapitull (ose njësi), detyra e vlerësimit të tipit tradicional (testi, kuizi, etj.) dhe të tipit alternativ (projektet, hulumtimi i vetë-vlerësimit, etj.) për t'i identifikuar fushat ku nxënësit shkëlqejnë dhe fushat ku mund të kenë nevojë për mbështetje shtesë.

Meqenëse rezultatet e të nxënësve jepen për secilën temë, testet e shkurtra që jepen në fund të një njësie mësimore mund të verifikojnë nëse ato rezultate janë arritur apo jo. Nëpërmjet këtij vlerësimi të vazhdueshëm, do të ofrohet mundësia e diferencimit të niveleve të arritjeve për nxënësit me aftësi dhe mundësi të ndryshme, duke e mundësuar mbështetjen e duhur përpara se humbja e të nxënësve të grumbullohet në atë nivel që është vështirë të rikupërohet.

Korrektësia e gjuhës dhe saktësia shkencore ofrojnë një bazë solide. Një kritikë e përgjithshme lidhur me shumicën e teksteve të analizuara është se janë vërejtur gabimet drejtshkrimore, përkufizime konfuze dhe mungesë qartësie në ritmin e të nxënësve.

Për të paraqitur informata të sakta dhe të përditësuara, autorët e teksteve shkollore duhet t'i marrin ato nga burime të besueshme siç janë revistat akademike, librat shkencorë, ueb-faqet me reputacion dhe mendimet e ekspertëve. Citimi i duhur i burimeve dhe autorëve është e rëndësishme për ta ruajtur integritetin akademik.

Gjuha duhet të jetë e qartë, koncize dhe e qasshme për t'u kuptuar nga nxënësit. Formatimi i tekstit, siç është përdorimi i fonteve të lexueshme dhe hapësira e përshtatshme, kontribuojnë po ashtu në qasje të tekstit. Një korrektor gjuhësor duhet ta kontrollojë drejtshkrimin në bashkëpunim të ngushtë me autorët e teksteve shkollore për të siguruar shprehje të unifikuara gjuhësore në të gjithë tekstin. Ne e konsiderojmë po ashtu të nevojshme, kur një ekip i përzier autorësh nga Shqipëria dhe Kosova bashkëpunojnë (që është një gjë shumë e mirë) t'i kushtohet vëmendje unifikimit të terminologjisë që autorët e të dy vendeve e përdorin në tekst.

Motivimi e ndërton të ardhmen. Shumë pak nga tekstet e analizuara mund të konsiderohen si motivues për nxënësit që ata të avancojnë në të nxëniet e tyre. Megjithatë, motivimi është në thelb të çdo përpjekjeje njerëzore dhe ai duhet të promovohet në tekstet shkollore.

Për të zhvilluar një tekst motivues, mund të zhvillohen disa strategji si ato të paraqitura në vijim. Është me rëndësi që të përdoret një gjuhë koncize dhe e lehtë për t'u kuptuar. Prandaj, konceptet komplekse duhet të zërthehen në pjesë më të thjeshta me shpjegime të qarta; shembuj, analogji dhe pamje që mund ta bëjnë përmbajtjen më të qartë dhe interesante për lexuesin. Përfshirja e diagrameve, skicave, grafikëve dhe mjeteve të tjera vizuale mund të ndihmojë në ilustrimin e koncepteve komplekse dhe ta bëjë përmbajtjen më tërheqëse dhe të qasshme nga ana vizuale. Një zgjidhje tjetër e mirë është të ndahet teksti me nëntituj, pika të radhitura dhe citate përkatëse për ta bërë atë tërheqës në aspektin vizual dhe më të lehtë për të naviguar dhe ruajtur interesimin. Seksionet ose shembujt që tregojnë se si konceptet e mësuara në tekst janë të rëndësishme dhe të zbatueshme në situata të botës reale, mund t'u ndihmojnë nxënësve që ta shohin vlerën praktike të asaj që e mësojnë dhe mund t'i motivojnë ata të angazhohen më shumë me tekstin. Kurdoherë që është e mundur, ndërlidhja e përmbajtjes së tekstit shkollor me interesimet, hobit ose pasionet personale të nxënësve kanë më shumë gjasa ta rrisin motivimin për të mësuar dhe për t'i mbajtur në mend informatat. Duke përfshirë kuizet ose pyetjet e vetë-vlerësimit përgjatë tekstit shkollor, nxënësit mund të motivohen gjithashtu kur e shohin se njohuritë dhe shkathtësitë e tyre përmirësohen.

Rekomandimet për mekanizmin e rishikimit dhe recensimit të teksteve shkollore në të ardhmen

- MASHTI duhet ta krijojë një proces për rishikimin dhe recensimin e vazhdueshëm të teksteve shkollore. Ky do të shërbejë si një mekanizëm konsistent dhe i qëndrueshëm për të marrë të dhëna autentike nga përdoruesit e teksteve shkollore, duke u fokusuar në përmirësimin e vazhdueshëm të teksteve shkollore. Ky proces dhe mekanizmat përkatës kërkojnë një bazë të qartë ligjore në mënyrë që qasja ndaj rishikimit dhe recensimit të vazhdueshëm të njihet dhe të mbështetet nga MASHTI.
- Faza pilot e rishikimit të teksteve shkollore duhet të përsëritet në vitet e ardhshme për lëndët tjera. Në një periudhë afatgjate, metodologjia e iniciuar në kuadër të këtij procesi duhet të shërbejë si bërthamë për programin e ngritjes së kapaciteteve të ekipeve të recensentëve të cilët do ta vlerësojnë cilësinë e gjeneratave të reja të teksteve shkollore në fushat tjera kurrikulare dhe në secilën komunë të Kosovës.

- Programi për krye-trajnerë të ekipeve të reja të recensentëve të teksteve aktuale dhe lëndëve tjera duhet të zhvillohet dhe akreditohet nga MASHTI. Programi për krye-trajnerë duhet t'i mbulojë aspekte siç janë: si të përzgjidhet një tekst shkollor i përshtatshëm për nevojat e nxënësve; si të bëhet zbatimi përkatës i kurrikulës së bazuar në kompetenca; si të zhvillohen burime për ta plotësuar përmbajtjen që mungon në një tekst të caktuar shkollor.
- Programi i ngritjes së kapaciteteve për ekipet e rishikimit duhet të bëhet trajnimi bazë për ekipet e ardhshme të recensentëve që do ta vlerësojnë cilësinë e gjeneratave të reja të teksteve shkollore pas miratimit të ligjit për tekstet shkollore. Programi ka një fokus të dyfishtë, në ndërtimin e kompetencave funksionale të pjesëmarrësve për rishikimin e teksteve shkollore, si dhe rritjen e motivimit dhe angazhimit të tyre për të bërë një punë cilësore.
- Duke e pasur parasysh risinë dhe kompleksitetin e përmbajtjes së programit dhe rezultatet e mira që janë arritur, MASHTI dhe Fakulteti i Edukimit duhet ta konsiderojnë integrimin e tij në programin Master si temë për hulumtime dhe analiza të vazhdueshme. Kështu, qasjet ndaj rishikimit dhe recensimit të teksteve shkollore do të bëheshin fusha me interes për studentët aktualë dhe studentët e rinj të programit Master.
- Ekipi kryesor prej 30 ekspertëve të aftësuar vendorë përbën një burim shumë të rëndësishëm njerëzor kosovar për përmirësimin dhe zhvillimin e teksteve shkollore. Puna e ardhshme e këtij ekipi duhet të mbështetet në vazhdimësi nga MASHTI, dhe puna e tyre profesionale do të mund të menaxhohej nga një institucion qendror, siç është Instituti Pedagogjik i Kosovës. Duke pasur parasysh se janë rreth 200 kurrikula lëndore dhe të paktën 600 tituj librash, do të nevojiten të identifikohen dhe trajnohen të paktën 200 recensentë në vit për t'i adresuar kërkesat e ligjit të ri për tekstet shkollore. Recensentët e aftësuar do të përfaqësojnë një burim njerëzor thelbësor për proceset e qëndrueshme që lidhen me zhvillimin dhe rishikimin e teksteve shkollore.
- Nevojitet një grup mësuesish dhe edukatorësh të trajnuar, që mbulojnë shtatë rajonet dhe DKA-të përkatëse. Ky trajnim do të kontribuojë në krijimin e ekipeve komunale për rishikim dhe recensim, të cilët vazhdimisht kontribuojnë në përmirësimin e teksteve duke ofruar të dhëna dhe informata kthyes nga niveli i shkollës. Mësimdhënësit dhe edukatorët e trajnuar duhet të ndjekin programin e trajnimit të zhvilluar nga KosEd dhe Instituti Pedagogjik i Kosovës dhe të miratuar nga MASHTI.
- MASHTI duhet ta krijojë një mekanizëm efektiv të komunikimit me autorët dhe botuesit për të siguruar që raportet e rishikimit nga ekipet e trajnuara, në nivel të DKA-ve dhe atë rajonal të ndahen vazhdimisht. Një kalendar vjetor për rishikimin dhe recensimin e teksteve shkollore, i përgatitur nga MASHTI dhe i ndarë me të gjitha palët e interesit, mund të jetë një mjet efektiv i komunikimit.
- Të gjeturat nga rishikimi dhe recensimi i teksteve shkollore mund të nënkuptojnë ndryshime të kurrikulës në përgjithësi dhe rishikime të kurrikulës lëndore në veçanti. Pra, MASHTI duhet ta krijojë një mekanizëm të qartë për t'i analizuar të dhënat nga rishikimi dhe ndryshimet e propozuara të kurrikulës/lëndëve. Udhëzimet (manualët) për përmirësimet e vazhdueshme të kurrikulës dhe fushës lëndore, të zhvilluara nga MASHTI, mund të jenë një qasje për përmirësim dhe avancim efektiv.